

PREÇ ZOGAJ:

POEZIA, NJË LUFTË E HERSHME E TË RESË ME TË VJETRËN PA SHANSE QE TË FITOJË NJËRA E TË HUMBASË TJETRA

Bisedoi *Andreas Dushi*

Mikut tim, poetit
Aliriza Gashi (1945-1997)

**“S’MUND TA MOHOSH
POPULLIN TIM!”**

Nga *Agim Vinca* (fq. 10)

SHËNIME MBI LIBRAT

Mbi romanin “Bora dhe unë”, *Ballsor Hoxha*

**“KRISJA” SI BEKIM
BALLKANIK**

Nga *Argëzon Sulejmani* (fq. 8)

Libri “Malet e gjigantëve” i *Carleton S. Coon*

Një përkthim mjeshtëror
në stil dhe në qasje gjuhësore
nga *Mal Berisha*

Nga *Ndrek Gjini*

MA, University of Galway, Ireland (fq. 9)

Libri me tregime “Shtegu i të verbërve”
i shkrimtarit *Ndue Ukaj*

Pasqyrë e marrëdhënieve
me autoritarizmin


Nga *Gjergj Anton Filipaj* (fq. 11)

“Albumi i thashethemeve”
të *Stefan Çapalikut*

Nga *Anxhela Pashaj* (fq. 17)

Libri “Porosia e Kullës” i
autorit *Pashko R. Camaj* u
promovua në *Harvard*

Nga *Sokol Paja* (fq. 4)



Rreth romanit të *Nasir Lerës* “Ngjallja e diktatorit”

**Rrëfim mjeshtëror për
pasoja të ligësisë së njeriut për
ta sunduar tjetrin**


Nga *Anton Nikë Berisha*

Veprën “Ngjallja e diktatorit” *Nasir Lera* nuk e hartoi si roman historik, ku pandërmjetësisht do të bënte fjalë për diktatorin konkret, për pushtetin diktatorial, për ngjarje e për pasoja të shumta që në Shqipëri u përligjën për rreth 50 vjet; nuk i gjurmoi shkaqet e lindjes dhe mënyrat e gjallimit të diktaturës dhe mënyrat e dhunës të përdorura nga diktatori dhe nga përkrahësit e tij...

**ADONIS,
POETI SIRIAN NË PARIS
DHE STUDENTI SHQIPTAR
ME EMRIN ATJON...**

Nga *Visar Zhiti* (fq. 15)

STEPHEN KING
E kam dashur “Perëndinë
e mizave”, si fëmijët e
sotëm “Harry Poterin”



(fq. 23)

BIBLIOTEKË

— *Abdurrahim Myftiu* (fq. 12)

Emini

— *Mark Simoni* (fq. 14)

Qyteti i natës misterioze

— *Rei F. Hodo* (fq. 16)

Vargjet e një moti

— *Rexhep Polisi* (fq. 13)

Klithmë pulëbardhash

— *Mihail Bulgakov* (fq. 23)

Në Kafene (Përktheu *Kosta Nake*)

— *Arben Velo* (fq. 18)

Ftesë për koncertin Jaz të zotit

— *Vangjush Saro* (fq. 19)

Pa celular

— *Arben Meksi* (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

**At Ambroz Marlaskaj...
përtej dijeve tona për të**

Nga *Franco Kulli*

Nuk ndodh shpesh, që në sipërmarrjen për të bërë jetëshkrimin (monografinë) e një personazhi historik me të cilin ke lidhje gjaku, sidomos kur ai është me një rëndësi të posaçme publike, të mos biesh në “kurthin” e përjetimeve... (fq. 7)

A.D.: Preç, së fundmi keni botuar përbledhjen tuaj të plotë poetike “Në çdo pasqyrë na sheh mëkati”. Natyrshëm, është e pashmangshme pyetja: Pse pikërisht tani?

P.Z.: Sepse pikërisht këtë vit botuesi i UET Press, Henri Çili, nisi kolanën e botimeve poetike “Plejad”. Me përbledhjen “Në çdo pasqyrë na sheh mëkati” mua më ra nderi të isha autori që e përuroi këtë kolanë, e cila do të vijojë në kreshendo me poetë të tjerë të afirmuar.

Kolana në fjalë senderton ndërkaq një zakon të botuesëve në mbarë botën, në mirëkuptim dhe me bashkëpunimin e autorëve. Poeti italian Salvatore Quasimodo, përshembull, ka botur gjatë jetës tre përbledhje me poezi të zgjedhura, para se vepra e tij të botohej e plotë pas vdekjes. Janë të shumtë poetët që e bejnë këtë më shumë se njëherë. Është një menyrë për të bartur poezitë më të mira të vëllimeve veç e veç në një liber të vetëm, në librin e librave. E gjithë kjo edhe për efekt të komunikimit me lexuesit e rinj. Me studiuesit e poezisë gjithashtu. Në fund të fundit, poeti shkruan vetën një libër, thoshte Borhes. Pavarësisht se krijimtaria e tij “kalenderizohet” nga koha në kohë me tituj të veçantë.

A.D.: Ky proces përzgjedhjeje mes gjithë krijimtarisë suaj thuhet gjysëmshkullorë, si është realizuar dhe lënia jashtë e disa poezive ka qenë një përvojë e dhimbshme për ju?

P.Z.: Unë kam bërë përzgjedhjen e parë nga dyëmbëdhjetë vëllimet e botuara nga viti 1985 deri në vitin 2021. Këtë përzgjedhje ia kam dërguar Gëzim Bashës, autorit të parathënies, një njohës i thellë i letërsisë shqipe dhe i poezisë sime gjithashtu, i cili jep lëndën e Shkrimit Akademik në Universitetin e Ëiskonsin në SHBA dhe është i angazhuar edhe në Departamentin e Kërkimeve të këtij Universiteti. Gëzimi ka bërë sugjerimet e tij, duke iu përmbajtur me rreptësi kriterit estetik, duke respektuar sakaq kronologjinë e botimit të vëllimeve. A ndjej keqardhje për të hequrat? Nganjëherë po. Më bëhet sikur nuk i kam marrë në varkë. Madje në një emision televiziv për Top Channel me gazetaren Monika Stafa më ndodhi të recitoja vargjet e një poezie të hershme për Lezhën, ku them ndër të tjera “jam nga ku vend i pashok në Veriperendim/ku zukthi qahet nga vapa dhe era e kripur e detit/ku pishat e Veles karshi filtrojnë ajrin e bjeshkës/ku mbrëmjet e lehta peshojnë mbi kalinj të ndezur si zjarre/Zgjas një dorë prapa dhe prek det/zgjas tjetrën prapa dhe prek male”... Befas u kujtova se këtë poezi nuk e kam përshtirë në përbledhje. Dhe i thashë me të qeshur Monikës se në një të ardhme do të mendoj të botoj, me shpenzimet e mia kësaj radhe, një përbledhje me poezitë e hequra.

A.D.: Mendoni se njohja masive në publik si analist ju ka dëmtuar apo ndihmuar në raportin tuaj prej poeti me lexuesin?

P.Z.: Do doja shumë ta dija. Por nuk kam si ta di. Mund të përgjigjem “po” pa gabuar. Sikurse “jo”, apo “ndoshta” sërish pa gabuar. Pasioni i jetës sime ka qenë dhe mbetet poezia. E dëshmon perodiciteti i botimeve të mia gjatë gjithë këtyre viteve, pavarësisht se me se jam marrë në jetën e përditshme. Puna e poetit është në pritje. Kur më ka thirrur poezia, kam lënë gjithçka dhe jam përgjigjur. Për fat më ka thirrur vijueshëm dhe kjo ka bërë që të cilësohem një poet sistematik. Them për fat, sepse poezia nuk vjen kurrë as me thirje, as me truke, as me magji. Ajo vjen kur të dojë vetë, aq sa nganjëherë, kur kalojnë javë apo edhe muaj pa një shenjë prej saj, fillon e mendon me vete se kaq e pat, nuk kthehet më. Dha sa shumë lumturohesh kur krejt papritur

PREÇ ZOGAJ:

Poezia, një luftë e hershme e të resë me të vjetrën pa shanse që të fitojë njëra e të humbasë tjetra

Bisedoi Andreas Dushi



Vizatim nga Anastas Kostandini - Taso

motivi i ri bëhet gjallë dhe shkrep ku nuk ta pret mendja. Për tu kthyer te pyetja nga e nisem, duhet të them se kam bërë gjithnjë një punë për të jetuar, për të mbajtur familjen. Kjo u ndodh gjithë shkrimtarëve këtu, besoj. Tregu ynë është i tillë që me të ardhurat nga librat nuk e lejon të jetuarit me dinjitetin që vesh figurën e poetit. Megjithatë, do doja shumë ta dija se si do të kishte qenë poezia ime nëse do të kisha patur mundësi t'i kushtohesha vetëm asaj. Nuk do ta di kurrë.

A.D.: Besoni se sot, në këtë kohë krejt të ndryshme nga vitet kur u përdor si term, vlen të përmendet akoma koncepti i shkollave letrare respektive të qyteteve të ndryshme?

P.Z.: Jo, nuk vlen. Nuk vlen sepse nuk ka.

Shkollat Letrare janë një dukuri e rrallë në historinë e letërsisë. Ato, zakonisht, kanë kanonet apo manifestet e tyre të alaburuara, siç është përshembull manifesti i futurizmit i Marinetit që u përhap dhe u përshat nga poetë francezë, rusë e plot të tjerë. E plot të tjera.

E kuptoj se pyetja juaj ka parasysh disa rrethe letrare që spikatën në qytete të vogla, si Lezha, Tepelena, Bajram Curri, Lushnja, Kukësi e ndonjë tjetër përgjatë viteve tetëdhjetë-nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. Këto rrethe apo grupe letrare dalloheshin për mënyrat dhe tonet e tyre të dallueshme të të shkruarit. Mes tyre kishte poetë vërtetë të talentuar. Po kufizohem të përmend veç disa syresh që nuk jetojnë më, si Ndoc Gjetja (Lezhë), Petrit Ruka (Tepelenë), Agim Spahiu (Kukës), Hamit

Alia (Tropojë). Por nuk mund të flitej për “shkolla” në një rend politik totalitar. Nëse flasim për Lezhën, duke qenë se Lezha përmendet më shpesh për “shkollën e saj të poezisë” deshëroj të sqaroj dy gjera. E para, as Ndoc Gjetja, as Rudolf Marku, dy poetët e shquar lezhjanë të atyre viteve, nuk kanë pretenduar ndonjëherë të kenë krijuar një shkollë letrare. Kjo shprehje është thënë fillimisht me përcmim dhe sens paralajmëruar nga një zyrtar i lartë i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës që merrej me lëtersinë dhe artet. Zyrtari e kishte me një lloj poezie diverse që po shkruhej në Lezhë, sidomos nga Rudolfi, i cili duke përdorur me mençuri mjetet shprehese të poezisë, ekperimentonte dykuptimësinë, poezinë mes rreshtave, nëntekstet. Ai njihej gjeresisht si një poet i ri i kulturuar, bartës i jehonave dhe koncepteve të poezisë bashkohore europiane me të cilat kishte mundur të vihej në kontakt në kushte jo legale. Ndoci, megjithese më i madh në moshë, duke ruajtur stilin e tij, u ndikua nga Rudolfi. Pak më vonë edhe unë dhe të tjerë më të rinj. Kjo bëri që Lezha të shndërrohej papritur në një pikë reference dhe adresë “pelegrinazhi” për shumë poetë të rretheve të tjera, të etur për dimensione lirie në poezi. Ky është momenti kur cerberet e metodës zyrtare lëshuan anatemen e veshur me përcmim për “shkollën e Lezhës”. Më vonë, në liri, breza poetësh e kanë vlerësuar ndikimin e fortë të arealit poetik që krijua në Lezhë, duke i dhënë qytetari, për lehtësi komunikimi, togfjalëshit “shkolla e Lezhës”, kësaj radhe në sensin pozitiv. Që siç e thashë ka qenë një mënyrë novatore të shkruarit, por jo një shkollë në kuptimin klasik të fjalës.

Gjithë diskutimit për shkollat letrare mendoj se i vë pikën maksimale e famshme “vargu i mirë e humb shkollën”. Poezia është vërtetë një luftë e hershme e të resë me të vjetrën pa shanse që të fitojë njëra e të humbasë tjetra.

A.D.: Sipas jush, sa e kanë ndikuar poezinë dinamikat e jetës tuaj? Përgjithësisht, a e mban jeta e poetit rolin kryesor në krijimtarinë e tij?

P.Z.: Pjesa më e mdhe e poezisë botërore është shkruar në veten e parë, thotë Ezra Pound. Vetë “Kënga e Këngëve” në Bibël është thurur në pjesën e vet më të mrekullueshme si një dialog, pra në vetën e parë, mes burrit dhe gruas. “Soliloquy (monologu i unit lirik) është syri dhe mendja që bëhen skena ku zhvillohet gjithçka”, shkruan Gëzim Basha. Poeti është ndërkaq kurdoherë më shumë se vetvetja, është shumë e leximeve të asimiluara, që treten në stilin dhe zërin e tij unik. Ai flet në vetën e parë dhe në vetën e tretë njëkohësisht. Dhe anasjelltas, kur shkruan në vetën e tretë ai është duke artikuluar në veten e parë gjithashtu. Për



t'u kthyer të pyetja juaj e drejtpërdrejtë, përgjigja ime është : Po, jeta e poeti mban rolin kryesor në krijimtarinë e tij.

A.D.: Angazhimin publik, artisti mendoni se duhet ta ketë edhe brenda artit të tij apo të mëvetshëm? Pra, një art a duhet të jetë disi i angazhuar ose të mbartë ndonjë mision shoqëror apo këtë detyrë, kur zgjidhet prej tij, artisti mund ta kryejë përtej artit, në forume të tjera?

P.Z.: Vetë arti është një formë e angazhimit publik për sa kohë i jepet publikut. Madje është forma më e lartë sepse i adresohet jo vetëm një brezi të caktuar, jo vetëm bashkohësve por mbarë njerëzimit kur kemi të bëjmë me kryevepra. Arti si i tillë mban jetën në rrjedhë të shpirtërores. Ky është angazhimi i vetvetishëm, i pakërkuar i artistit, poetit.

Kam përshtypjen se edhe angazhimi i kërkuar vjen vetvetiu. Pra nuk është i kërkuar në kuptimin voluntarist të fjalës. Ky lloj angazhimi ndodh dhe përligjet në funksionin e drejtpërdrejtë utilitar të poezisë në rrethana të caktuara, të përligjura. Ka plot shembuj ku poezia e angazhuar si e tillë nuk e ka tradhëtuar natyrën e llojit. Kjo ka ndodhur kur autorët kanë shmangur bartjen e qëllimit në shprehje që fqinjërojmë me gjuhën e politikës, publicistikës, didaktikës, agjitacionit.

A.D.: Krijimtaria juaj është kryesisht në poezi, por nuk mungon proza, si për shembull romani "Nata". Sikundër edhe kritika ka vërejtur, proza juaj e ka poezinë të ndërkalur; megjithkëtë, dua të di se çfarë plotnie gjeni në prozë që s'juaj jep dot poezia?

P.Z.: Që prej fillimeve të mia kam shkruar paralelisht poezi dhe prozë, herë duke i alternuar, herë njëkohësisht. E gjithë kjo më ka ardhur vetvetiu. Nuk jam as i pari, as i fundit. Besoj nuk është nevoja të sjell shembuj që janë pa fund. Libri im me novela me titullin "Shëtitorja", botuar në vitin 1990, citohet shpesh në forume online nga lexues dhe autorë të asaj kohe. I vetmi libër imi në italisht është një roman i shkurtër me titullin "Gruaja e të gjithëve", të cilin e kam botuar në vitin 1987. Pas vitit 1990 kam botuar disa romane si "Kufiri", "Gjyshi i tmerrshëm", "Anjeza nuk u zgjua", "Bija e vjetër e nënës së re" dhe "Nata". Edhe kolana e librave të mi publicistikë për ngjarjet e tranzicionit, gjithësejt nëntë tituj, është shkruar me një stil kryesisht letrar, madje dy prej tyre, si "Vera e përjetshme" (1996), Lufta Jocivile (1997) mund t'i quaj romane me personazhe realë, ndërsa "Në kërkim të zgjedhjeve të humbura" (2012) një përmbledhje me katër novela.

Kam berë më shumë emër, le të themi, si poet. Ndoshta më të drejtë. Ndoshta se jam promovuar nga kritika dhe media si i tillë.

Poezia dhe proza janë komplementare në korsi të respektive. Që nuk janë drejtëza që nuk takohen. Përkundrazi. Në poezi ka kurdoherë elementë të kursyer të tregimit e përshkrimit. Dhe anasjelltas, proza e ka poezinë në zemër të saj siç ka minerali xehorët, arin. Unë shkruaj prozë për të treguar ngjarje, subjekte, personazhe; shkruaj për t'u thelluar në brëndi të fateve njerëzore dhe ndërthurjes së tyre në paradigma që lexojnë dilema apo drama individuale apo shoqërore në rrethana konkrete. Shkruaj prozë për të komunikuar më me shumë lexues. Unë e besoj bindjen kolderixhiane se, duke dalluar nga mjetet dhe menyrat e shprehjes, nuk ka diferencë mes gjuhës së prozës dhe asaj të vargjeve.

A.D.: Sipas jush - nisur nga titulli i një prej librave të botuar sëfundmi "In Love" besoj se vështrimi që keni për këtë çështje është me interes - poezia shqipe a ja ka dalë, ka dështuar apo është në



proces të përmbushjes së një mungese domethënëse të lirikës së dashurisë apo poezisë sentimentale e cila ka gjurmët e saj në traditën tonë letrare, por u lëvrua përnjëmend vetëm pas viteve '90?

P.Z.: Siç e cekni dhe ju, tema e dashurisë, temë identitare e poezisë që në gjenezë të saj, nuk ka qenë asnjëherë tabu në traditën e vjershërimit në shqip. Ajo është dominuese në folklorin tonë, ku vetedija estetike popullore ka krijuar perla me plot kuptimin e fjalës. Është e vetmja që gëzoi një farë lirie edhe gjatë periudhës së komunizmit, ideologjia e të cilit formalisht predikonte dashurinë e lirë. Kur kaloj para syve të mendjes gjithë këtë trajektore që lëviz nga format kontemplative-adhuresive e të shprehurit te ajo metaforike ndervepruese, nga një traditë e vjershërimit me elementë të bukolicës dhe afër folklorikës, te lirika dhe ekloget urbane, më vjen të jap këtë përgjigje për pyetjen tuaj: Ia ka dalë. Por të mos harrojmë se kjo përmbushje nuk mbaron sa të jetë jeta. "Ndjeshmëria ndryshon nga gjenerata në gjeneratë, e duam apo jo, por të shprehurit e saj ndryshon nga një gjeni", thotë Tomas Eliot. Edhe në traditën tonë, në çdo etapë të saj, ka ardhur gjithmonë poeti që i ka dhënë shprehje sensibilitet të gjeneratës. Dhe do të vijë. Tema e dashurisë është temë qëndrore në poezinë time. Poezitë e vëllimit "In love" mëtojnë të shprehin sensibilitetin e gjeneratës së cilës i përkas, duke e venë në lidhje vazhdimësie me sensibilitetin e brezave të mëparshëm dhe ndoshta edhe të brezave që do vinë. Për ketë arsye, ato, në përgjithësi, bëjnë gjestin e Ode-s, thotë për to Gëzim Basha. Pra, po sipas tij, "kanë ton të theksuar adhurimi, diksion elokuent dhe përdorim të ndërjegjshëm të efekteve poetike".

Shpresoj të jenë një gjuhe që këndon nepër kohë.

A.D.: A e kanë poezitë, ato të dashurisë kryesisht po ndoshta edhe të tjerat, një adresë kujt i drejtohen...? Ose nxitja për t'i shkruar, e ka një adresë se nga niset për të arritur tek ju?

P.Z.: Poezitë e dashurisë janë në vetvete letra dashurie që mund të kenë ose jo një adresim konkret. Por u drejtohen të gjitha grave që mishërojnë të bukurën si kategori estetike. Njëherë më ndaloi në rrugë një burrë i mbajtur, të cilin e njihja. Punonte në një institucion shtetëror. Mu drejtua me

edukatë, pa e fshehur një shprehje të lehtë përçmimi : "Ime shoqe po më mburrej...", u gëlltit një çast sa për të ngrënë ndajfoljen *pacipërisht* "se ti i ke kushtuar një poezi që kishe botuar këtë të dielë në gazetë".

Me kaq ndaloi në pritje të përgjigjes sime, të cilën, siç e mendova në çast, e dëshëronte mohuese. Në fakt nuk kisha nevojë ta gënjeja. Nuk e njoh gruan tuaj, i thashë. Nuk e kam parë kurrë. "Pse jeni kaq i sigurt se nuk e keni parë kurrë"? ma ktheu ai. Sepse e di kush janë burrat e grave të martuara që njoh. Dhe ju nuk jeni një prej tyre.

Ai bëri një grimasë të pacilësueshme, tundi paksa kokën me një shprehje ndjesë-mëdyshje-keqardhje dhe u largua.

Në fakt sa herë pyetem (dhe pyetëm gjithmonë) se kujt i kushtohen poezitë e mia të dashurisë, më vjen ndërmend ajo gruaja e panjohur dhe them me vete: çdo gruaja që i perjeton si ti ishin kushtuar asaj.

A.D.: Te Vaji i bylbylit, Mjeda ka dy vargje: Vet bukurija, o i shkreti./ Kenka për ju një kob. Nisur edhe nga një frymë e përgjithshme e krijimtarisë suaj, a është bukuria një kob? E nëse po, a ja vlen bartja ose pranimi i këtij kobi për hir të bukurisë? Për ta vijuar pak më tutje, më duket se Hemingway ose Dostojevski thotë "Më jep një dhimbje të të jap një kryevepër!" Sërish, ja vlen të durohet dhimbja për hir të kryeveprës?

P.Z.: Bukuria është tronditëse, e tillë që të shpërbëje lidhje të shenja, siç thuhet. Përveçse të Mjeda, njësimin figurativ të bukurisë me kobin e ka edhe Migjeni në vargun " o grua që u njohëm në ditën e fatkubit tonë", në një prej poezive më të bukura të letërsisë shqipe.

A ia vlen apo jo bartja e këtij kobi për hir të bukurisë? Duhet të mbajmë parasysh se ky lloj shkëmbimi, le ta quajmë kështu, nuk është racional si në shkëmbimet e tjera ku njeriu zgjedh. Pra nuk është zgjedhje. Autori nuk e zgjedh dhimbjen. Nëse niset ta zgjedhë, ka gjasa të bëhet një sadomazokist qesharak. Dhimbja është pasojë. Dhe nuk është vetëm ajo që e shkakton poezinë, artin. Është edhe lumturia. Por nëse duan ta trajtojmë si të vullnetshme dhimbjen, unë them ia vlen ta durojmë për hir të një kryevepre. Aq më shumë po të mbajmë parasysh se njeriu përjeton plot dhimbje te tjera të pashpagueshme me tekste letrare.

A.D.: Duke qenë se ky vëllim është tejet voluminoz, nuk ka kuptim të ndalemi në vargje apo poezi të caktuara përveç ndonjë rasti specifik, prandaj gjithë kjo bisedë ka synuar, uroj t'ja ketë dalë, të paraqesë gjerësisht personalitetin e poetit dhe nëpërmjet kësaj paraqitjeje, të ofrojë poezinë e tij. Ndoshta në gjithë tematikat e prekura teri tani, mungon ajo e fëmijërisë. Ju Preç keni lindur në Manati, fshat të cilin e njoh mirë dhe keni qenë qysh fëmijë mik me piktorin e njohur e të dashur, Pashk Përvathi. Prandaj, kur ju shkruani për fëmijërinë, më duket sikur shih ndonjë tablo të Pashkut ku paraqitet Manatia. Vendlindja, çfarë peshe ka te arti, në secilën formë me të cilën ai shprehet?

P.Z.: Më vjen mirë që poezitë e mija për fëmijërinë zgjojnë te ju imazhet e tablove të Pashk Përvathit, që duhet ta themi janë shumë të bukura. Aq më shumë duke patur parasysh faktin se gjyshërit, babai, axhat dhe hallat e tua kanë jetuar për shumë vite në Manati, në respektin dhe dashurinë e ndërjellte me vendasit.

Si shokë të jetës, të liundur e të rritur as njëqind metra larg njëri tjetrit, kemi menduar disa herë me Pashkun të botojmë një libër të përbashkët me pikurat e tij dhe poezitë e mija për Manatinë dhe Lezhën. Të shohim kur do ta realizojmë. Duhet ta realizojmë. Kam shumë poezi për vendlindjen, për shokët e klasës, njerezit me të cilët u rrita, burrat dhe gratë e fëmijërisë, shumica prej të cilëve kanë vdekur. E gjej shumë të saktë një shprehje të Robert Frost që ka thënë se poezia është në thelbin e vet mënyrë për të mbajtur mend ato sende, ngjarje, imazhe dhe tinguj, harresa e të cilave do të na varfëronte pa masë.

"Ishullin tim të kujtimeve mitike" siç e cilësohet vendlindja për shumicën e poetëve, e zbulova pasi qeshë larguar nga Manatia, pasi pashë botë dhe zbulova barazlartësinë e çdo pike të planetit nga dielli dhe afërsinë mendore e shpirtërore të vendeve në dukje të largëta. Në një prej poezive që kam shkruar duke ecur në fushat e Manatisë më vonë kam një varg që thotë "E Parisi është aty të supi im". Ka qenë një vizion i vërtetë që ilustronte këtë lloj marredhenie me universin ku perimetri është askund dhe qendra gjithkund.

Dhe jeta ngjan të jetë rrethore. Mbyllet aty ku fillon.

Boston, 14 Dhjetor 2024 - Federata Pan-Shqiptare e Amerikës Vatra, dega Boston së bashku me Programin e Studimeve të Gjuhës Shqipe pranë Universitetit të Harvardit dhe Shtëpisë Botuese "Onufri" promovuan veprën "Porosia e Kullës" nga Dr. Pashko R. Camaj. Nën prezantimin mjeshtror të Jorid Çelaj, kryetari i Vatrës në Boston z.Mentor Maksutaj vlerësoi librin e Dr. Camaj mbi emigracionin dhe theksoi veprimtarinë e Vatrës në Boston në shërbim të kulturës kombëtare, gjuhës shqipe dhe komunitetit shqiptar në Boston. Prof. Faton Limani ligjërues i gjuhës shqipe në Harvard u shpreh se "Porosia e Kullës" është një thesar i rrallë, jo vetëm për shqiptarët në diasporë, por edhe për çdo emigrant që ndjen peshën dhe sfidën e integritetit në një botë të re, duke ruajtur rrënjët dhe identitetin e tij. Themeluesi i shtëpisë botuese "Onufri" z.Bujar Hudhri në fjalën e tij theksoi se "Porosia e Kullës" është libër i çmuar dhe i veçantë në letrat shqipe me kulturën e lartë të të shkruarit, ndjenjat e fuqishme njerëzore që përshkruan dhe mesazhe të fuqishme që jep për lexuesin. Libri i Dr.Pashko Camaj nuk ka mburrje por dashuri e dhembshuri për vendlindjen dhe atdheun. Dr. Pashko Camaj është model suksesi dhe personalitet i mërgatës shqiptare në Amerikë, tha ndër të tjera z.Bujar Hudhri.

Prof. Thanas Gjika në fjalën e tij u fokusua në një analizë letrare dhe stilistike të librit "Porosia e Kullës" dhe pasazheve meditative filozofike e shpirtërore në roman ku skaliten personazhet jetësore të dilemave dhe historisë së "Kullës" si institucion familjar dhe patriotik. Editori i Diellit u shpreh se Dr.Pashko Camaj ka meritë

Libri "Porosia e Kullës" i autorit Pashko R. Camaj u promovua në Harvard

Nga Sokol Paja

pasi rrëfen modestisht, përshkruan detaje deri në imagjinatë, melankolik në dhimbje e vuajtje, dramatik e ankthioz në labirintet e së panjohurës por gjithmonë shpresëplotë siç i thoshte babai: "Zoti na e bëjë mirë për ne Çoço". Në rrëfimet e Pashko Camajt nuk ka mburrje, nu ka hiperbola, nuk ka folklorizëm bajate por ka jetë reale, personazhe reale dhe rrëfime autentike të një kohë të vështirë jo vetëm për personazhin kryesor e familjen e tij por për mbarë shqiptarët të mbetur jashtë kufijve shtetërorë shqiptarë. Rrëfimet e Dr.Pashko Camajt, me një stil e gjuhë shumë të pasur, kanë dritë dhe optimizëm, forcë dhe krenari, thjeshtësi dhe mirënjohje. Gazetari Fatmir Konja u shpreh se ashtu si kulla në malësi, me gjithë magjinë e energjisë elektrike mbeti e pandryshuar, ashtu edhe kulla shpirtërore e Pashko Camajt, megjithë magjinë amerikane, ka mbetur e pandryshuar.

Ish-drejtori i VOA-s z.Frank Shkreli në fjalën e lexuar nga gazetari Fatmir Konja shprehet se "Porosia e Kullës" na bën të shikojmë thellë brenda vetes, ndoshta me mundësinë dhe dëshirën për të gjetur veten në një botë të huaj

dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve se ku ishim, ku jemi dhe ku po shkojmë – brezi ynë dhe ata që vinë pas nesh. A është një bekim, apo një mallkim, ndoshta, braktisja e Kullës dhe e trojeve tona? Ato kulla që ndër shekuj kanë ruajtur brez pas brezi identitetin shqiptar, traditat, vlerat dhe zakonet e mira të malësorëve, të cilët shpesh e kanë ndier veten si të huaj në kullat dhe në trojet e veta shekullore.

Prof. Besim Muhadri në kumtesën e tij u fokusua te trashëgimia e brezave, elementi krijues e rikrijues letrar dhe simbolika e Kullës si institucion vlerash, qendrese, mbijetese e krenarie kombëtare me përshkrime artistike e rrëfime estetike dhe shumë besnike.

Prozatori Mëhill Velaj u shpreh se "Porosia e Kullës" është libër memorial i jetës dhe metafora e përkryer e kujtesës e qendresës i këtij rrugëtimi të brendshëm e memorizues, ku dimensionin shpirtëror ngadhënjën edhe me lart se përmasa e jashtme, domethënë rrethi social, shtrëngesat e gerçet që Pashko R. Camaj ka përjetuar gjithmonë duke kërkuar për të njohur veten, tjetrin dhe subkulturën që të ofron shteti më demokratik në



botë, SHBA - ja. Shkrimtari Kastriot Fetahu u shpreh se Dr. Pashko Camaj provon në këtë roman, përmes një kohe më të shkurtër se francezi Henri Charrière, luajtur nga Steve McQueen në filmin Papillon, se rruga drejt lirisë dhe prosperitetit kalon gjithmonë në ngushticën midis Shilës dhe Karibdës. Në këtë rrugë, Odiseu arriti Itakën, ndërsa Camaj – Amerikën. Thuhet se letërsia ushqen iluzionet, por autori i romanit Porosia e Kullës, Pashko Camaj, provon se doli nga kështjella e Ifit pa ndihmën e Abatit Faria – vetëm përmes vendosmërisë së tij të pathyeshme shqiptare, në kërkim të lirisë, duke ndjekur gjurmët e Edmond Dantesit të ri. Poeti Namik Selmani vlerësoi librin dhe u ndal gjithashtu te vlerat e shtëpisë botuese "Onufri". Në fund të promovimit Dr. Pashko Camaj zhvilloi një bashkëbisedim me pjesëmarrësit dhe shpjegoi për të pranishmit pikënisjen e shkrimit të librit "Porosia e Kullës" dhe episode që lënë gjumë te pasardhësit dhe lexuesit për të ruajtur rrënjët, trungun dhe trashëgiminë e shkëlqyer të vlerave kombëtare.

(Marrë nga gazeta "Dielli")



Tiranitë, diktaturat dhe arti i fjalës

Qysh në kohët më të lashta në veprat letrare u bënë objekt vështrimi poetik dukuri të ndryshme që lidhen me sistemet tiranike, me diktaturat, me diktatorët dhe me mënyrat e ndryshme të ndëshkimeve që pësoi njeriu në rrjedhë të moteve. Krijuesit – shkrimtarët i bënë objekt të vështrimit poetik këto dukuri për arsye se domin të ndriçonin botën e brendshme, edhe të atyre që ishin nxitës dhe i shkaktonin ato, të atyre që u ndihmonin, po edhe të atyre që i pësonin dhe i vuanin. Ato ishin pjesë e jetës dhe si të tilla meritonin të përjetësoheshin në artin e fjalës.

Këtë e përligjin mirëfilli llojet e ndryshme të letërsisë gojore, në poezi dhe në prozë, të cilat njeriu i krijoi dhe ato u bënë pjesë e jetës të thuash nga koha kur ai u bë i vetëdijshëm për vete dhe për veprimet që bënte. Mirëpo, e dëshmojnë dhe veprat e letërsisë së shkruar që na kanë mbërritur nga lashtësia. E gjejmë edhe në veprën letrare sumere babilonase, mbi katërmijë vjet të vjetër, më të plotën të zbuluar deri më sot, *Epi i Gilgameshit*¹. Edhe pse në qenësinë e sistemit kuptimor dhe shprehës epi i kushtohet tmerrit të vdekjes dhe fatit tragjik të njeriut², përkatësisht përpjekjeve për t'u bërë i pavdekshëm³, në të autori e bën objekt vështrimi poetik edhe tiraninë e Gilgameshit, mbret i Urukut (ai i ka dy të tretat të hyjnive dhe një të tretën të njeriut) ndaj banorëve të qytetit. Pra, mbreti Gilgamesh ushtron një sundim tiranik ndaj banorëve të qytetit dhe ata janë të pakënaqur. Rënkimet e tyre arrijnë deri në qiell, te hyjnitë (sidomos rënkimet e të rinjve të dashuruar). Kërkesa e tyre është: krijimi (nga ana e perëndive) i një qenieje që do t'i kundërvihet dhe do të ngadhënjë mbi Gilgameshin në mënyrë që (pastaj) qyteti të ketë qetësi⁴.

Janë dhe një varg kryeveprash dhe veprash të letërsisë së përbotshme që kanë bërë objekt vështrimi poetik ndëshkimet e njerëzve, diktaturat dhe mënyrat e tjera të pësimeve. Kjo dëshmohet edhe në kryeveprën e letërsisë së lashtë greke, "Iliadën" e Homerit (kujtojmë, fjala vjen, kryekomandanti, Agamenoni, ia rrëmben Akilit të dashurën, Grizejdën "vashën përrë që e solli nga Lyrnesi")⁵, për të mos i përmendur rastet e tjera.

Shqiptim poetik i një realiteti tronditës shqiptar

Veprën "Ngjallja e diktatorit" Nasi Lera nuk e hartoi si roman historik, ku pandërmjetësisht do të bënte fjalë për diktatorin konkret, për pushtetin diktatorial, për ngjarje e për pasoja të shumta që në Shqipëri u përligjën për rreth 50 vjet; nuk i gjurmoi shkaqet e lindjes dhe mënyrat e gjallimit të diktaturës dhe mënyrat e dhunës të përdorura nga diktatori dhe nga përkrahësit e tij; nuk u mbështet as në dokumente ose në të dhëna konkrete, që i cilësojnë romanet e llojit si "Doni i qetë" i Shollohovit, "Lumi i

¹ Shih *Epi i Gilgameshit*. E përkthet nga gjermanishtja dhe e plotësoi me shënime Anton Nikë Berisha. Botimi i tretë. Argeta – LMG, Tiranë 2008. Botimi i parë "Rilindja", Prishtinë 1984.

² N. K. Sandras thekson "Edhe pse Gilgameshi nuk është heroi i parë njerëzor, ai është heroi i parë tragjik, për të cilin dihet diçka. Shih, *L'epopeja di Gilgameš*. A cura di N. K. Sandars. Fabbri Editori, Milano 1977, f. 11.

³ Shih më gjerësisht për këtë ep në parathënie time: "Vepër që i kushtohet tmerrit të vdekjes dhe qëndresës së njeriut". Në *Epi i Gilgameshit*. E përkthet nga gjermanishtja dhe e plotësoi me shënime Anton Nikë Berisha. Botimi i tretë. Argeta – LMG, Tiranë 2008, f. 5 – 29.

⁴ Hyji, Anuji, pranon kërkesën e tyre dhe urdhëron Arunë që ta krijojë një qenie (Enkidujin), që do t'i kundërvihet mbretit të Urukut, Gilgameshit.

⁵ Shih më gjerësisht Dr. Labinot Berisha, *Këngët kreshnike shqiptare dhe epet e lashta*. Tiranë, Argeta-LMG, 2013.

Rreth romanit të Nasi Lerës "Ngjallja e diktatorit"

Rrëfim mjeshtëror për pasojat e ligësisë së njeriut për ta sunduar tjetrin

Nga Anton Nikë Berisha

Mos harro natyrën e dobët të njeriut për të qenë në qendër të vëmendjes të të gjithëve dhe për t'i pasur të gjithë nën vete.

(Nga romani "Ngjallja e diktatorit"

vdekur" i Xoxës, "Rrathët" e Martin Camaj etj., po merret me pasojat dhe traumat që la diktatura dhe diktatori në mendjen dhe në shpirtin e shqiptarëve, përkatësisht merret me synimet e disave që gjithë ajo që kishte ndodhur në diktaturë, të përsëritet, të kthehet, prandaj shpallin ngjalljen e diktator Hidrit: "Emri i diktatorit ishte kudo si një pëshpërimë që vërtitej mbi hidhërimin e vdekjes" (f. 172).

Diktatori u shpall i ngjallur, para së gjithash, për t'u hakmarrë dhe për të shfryrë mllëfin e grumbulluar për gjithë kohën që kishte munguar ndaj mospërfillësve dhe kundërshtarëve të konceptit të tij diktatorial dhe diktaturës që zbatoi. Nëse do të përdorej fjalori i romanit të Gogolit "Shpirtra të vdekur", bota e shpirtave të gjallë dhe bota e shpirtave të vdekur në romanin e Nasi Lerës "Ngjallja e diktatorit" përafrohen dhe bëjnë një botë që në njëmendësinë (realitetin) e përditshëm nuk mund të jetë. Pra, përmes rrëfimit dhe tekstit që e përfton, Lera e ndërton një realitet të mëvetësishëm, poetik, që bëhet realiteti i romanit, i cili të përkujton mendimin e Ernesto Sabato: "Mes romanit dhe jetës ekziston dallimi i njëjtë sikur mes gjumit dhe zgjimit"⁶.

Megjithatë, do theksuar se gjithë ajo që shprehet në këtë roman ka një mbështetje të fuqishme në realitetin konkret, në atë që ka ndodhur në diktaturë, të cilin shkrimtari Lera e ka përjetuar thellë në mendjen dhe në shpirtin e tij, bashkë me shkrimtarë, disa nga të cilët u burgosën, ndërsa disa e paguan dhe me jetë⁷. Në jetë bëhet fjalë veçmas për atë që ndodhi pas vdekjes së diktatorit⁸.

Të shpallurit se ishte ngjallur një i vdekur, përkatësisht diktatorit Hidër pas 20 vjetësh, nuk ishte gjë e rastit, por diçka e menduar dhe e qëllimtë. Nxitësit – vepruesit ishin të bindur dhe

⁶ Ernesto Sabato, *Heterodoksia*. Përkthet Fatbardha Statovci. Shtëpia botuese Pena, Prishtinë 2019, f. 23.

⁷ Duke folur për letërsinë në kohën e diktaturës shkrimtari, Agron Tufa, shkruan: *Librat e shkruar pa dhembjen dhe frymëzimin, në të mirë të konjunkturës, partisë dhe shokut Enver, edhe nëse shpërndaheshin në shoqëri, në thelb ato mbeteshin jashtë sinorëve të artit. U shkëputën prerazi lidhjet me modelet amtare të parakomunizmit dhe me letërsinë e mëdha të botës. Ndërkaq procesi letrar u përqësua edhe më shumë nga pesha e ndikimit të formës komando-administrative të normës shoqërore, e cila me një agresivitet të rrallë dhe egërsi ndëshkuese lante hesapet me cilindo shkrimtar që dilte jashtë modeleve të diktuara.*

Duke u mbështetur në artikullin e Leninit "Organizata e partisë dhe letërsia e partisë (partishmëria)", realizmi socialist operonte me një kodeks rekomandimesh, se si duhej të shkruante një anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve sovjetë, çka u kopjua dhe shpie deri në absurd në përvojën e komunistëve shqiptarë.

Nocioni estetik "realizëm" lidhej me përcaktimin "socialist", çka solli në praktikë nënshkrimin e letërsisë dhe arteve ndaj principeve të ideologjisë dhe politikës.

⁸ Ronald Regan thoshte "Supozohet se politika është profesioni i dytë më i vjetër pas prostitucionit. Unë kam kuptuar që ai ka shumë ngjashmëri me profesionin e parë më të vjetër".



të vetëdijshëm se shpallja e ngjalljes së diktatorit do të shkaktonte frikë dhe ankth: "Ben Kitës iu duk sikur të gjithë kishin në fytyrë shprehjen e një kotësie që nuk e kishin pasur në netët e tjera" (f. 156) dhe në këtë mënyrë ata (diktatorët e rinj) përmes mashtrimit dhe maskimit, do t'ia dilnin qëllimit dhe do ta merrnin më lehtë pushtetin për të sunduar mbi të tjerët, siç kishte vepruar edhe vetë diktatori për rreth 50 vjet. Pra, shpallja e ngjalljes së diktatorit ishte bërë nga të gjallët e jo nga të vdekurit nga se "[...] ata ishin (që ndodheshin nëpër kutitë metalike) më të rrezikshëm dhe më të pamëshirshëm kur ringjallehin sesa kur ishin gjallë" (f. 159).

Shpalesje dhe shqiptim poetik në dy rrafshë

Shpallja se na qenkësh ngjallur diktatori bëhet shkas vetvetiu që Nasi Lera t'i kthehet kohës kur njerëzit tanë jetuan në diktaturë dhe t'i ndriçojë pasojat e atij sistemi në dy rrafshë të rëndësishme.

I pari: Koha kur fjala e diktatorit Hidër gjatë sundimit konkret (diktatori dhe diktatura janë të pandarë) përcaktonte çdo gjë, jo vetëm në rrafshin e përgjithshëm, po dhe në atë individual: "[...] sikur kishte qenë një kohë ku njerëzit nuk mund të jetonin po të mos shtireshin" (f. 159) ose "Njerëzve, në atë kohë, u dukej sikur të vërtetën e tyre e dinin më mira ata që ishin jashtë vendit sesa ata që i kishin pranë, por që nuk po shkudeshin dot nga topitja që kishte shkakuar dhuna e gjatë e diktatorit Hidër" (f. 202). Pra, shenjzohet zinxhiri i ligësisë, përkatësisht zezona që ishte përligjur në rrafshë të ndryshme të jetës në diktaturë, sidomos në atë shpirtëror. Gjithë kjo dëshmohet nga ajo që ndodh nga çasti kur shpallet ngjallja e diktatorit Hidër (pas njëzet vjetësh): "Pak nga pak zëri i diktatorit po e fuste në vitet kur ishte gjallë dhe me gjetet e tij ndizte turmën e verbuar" (f. 204) ose "Njeriu i shkretë nuk e di çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të dojë në këtë jetë. Mua më vjen keq që nuk i kam dashur përrallat, sepse më duket

sikur nuk kam dashur asgjë. Të paktën të kisha dashur përrallat" (f. 215).

I dyti: Koha prej çastit kur fillon dhe përhapet fjala për ngjalljen e diktatorit Hidër në mënyrë që ajo të ngjallë sa më shumë tmerr (f. 140) dhe deri në çastin kur vritet hetuesi, Ben Kita, dhe zbulohet se gjithë ajo ishte punë e paramenduar dhe e përgatitur mirëfilli nga ithtarët dhe përkrahësit e diktatorit dhe të diktaturës, përkatësisht ishin diktatorët e rinj që përdornin një strategji të fshehtë, të maskuar dhe tejet të rrezikshme.

Pra, Nasi Lera me mjeshtëri të madhe e ka përqendruar rrëfimin e vet në periudhën kur zë e flitet dhe shpallet se diktatori Hidri ishte ngjallur, edhe pse që nga fillimi kishte lindur dyshimi: "Kishte vdekur ose ishte fshehur për t'u mbushur me urrejtje" (f. 230), që pandërmjetësisht lidhet me dukuritë që e cilësuan diktaturën.

Ajo që flitej për ngjalljen e diktatorit dhe përhapjen pa ndërprerë, ishte, siç u tha, strategji dhe veprim i fshehtë i diktatorëve të mundshëm, të rinj: "Në qoftë se e thonë të gjithë, kjo tregon se po e kërkojnë dhe ai do të vijë patjetër" (f. 236).

Natyrisht, shpallja e ngjalljes së diktatorit shkakton një hutim dhe një pështjellim të pazakonshëm, që ishte dhe qëllimi i vetë atyre që e kishin nxitur; trazimi dhe frika duhet të bënin punën e vet, duke shkakuar ethet rrënuese të dukurisë së pritjes: çka do të ndodhë me ngjalljen – kthimin e diktaturës: "Mes njerëzve që harruan teatrin, kinemanë, romanet, koncertet por vetëm përpinin nga mëngjesi deri në mesnatë gazetat, u fut pritja e asaj që do të ndodhte. Sepse patjetër do të ndodhte diçka. Nga qytetet e periferisë vinin lajme shqetësuese për grupe të vogla, kryesisht të rinjsh, që turbullonin qetësinë provinciale me grindjet, përleshjet dhe me shkëmbime të shtënash në mes të natës. Edhe në rrugët nacionale nuk ishte më qetësia që kishte qenë. Udhëtimet natën u rralluan nga frika e ndonjë plaçkitjeje të befasishme. Para ambasadave të huaja shihje radhë të gjata të njerëzve që kërkonin vizë dhe në pikat kufitare ata që hynin ishin fare të pakët në krahasim me ata që dilnin. Mes kryetarëve të partive ishte zbutur gjuha e ashpër dhe e rëndomtë që ishte përdorur deri atëherë dhe tani i shihje së bashku në kafenetë kryesore të qytetit, duke biseduar me zë të ulët. Edhe mes tyre vihej re një hije hutimi. Asnjëri prej tyre nuk kuptonte ç'po gatuhej dhe kundër kujt duhej të hidheshin. Kishte prej atyre që për të vranë kohën zhyteshin në përsiatje filozofike, thërrisnin në ndihmë historinë, por nuk gjenin asnjë episod ku një i vdekur ishte ngjallur pas njëzet vjetësh" (f. 253).

Arsyet e shpalljes së ngjalljes së diktatorit duhet lidhur me kushtet dhe rrjedhën e jetës konkrete, me gjendjen e rëndë - pasojë e sistemit që kishte mbretëruar me dhjetëra vite; pakënaqësinë, zhgënjimin dhe mërzitjen ("Njerëzit u mërzitën nga bota ku jetojnë"), mbase edhe nevoja që njerëzit të shkëputen nga jeta që bënin ose me etjen (për disa) për ta vazhduar atë sistem dhe për të sunduar.

Etja – ndjenja për diktaturë dhe për diktator

Shpallja e ngjalljes së diktatorit e nxitur nga të gjallët, nga një strategji djallëzore, e konceptuar deri në imtësi nga disa si dhe pësimet dhe tragjika që ndodhin në vijimësi, përligjen nga fjalët e shefit të policisë që me shërbimin e tij bënte çmos që ta zbulonte të vërtetën: t'i zbulonte bartësit e gjithë këtij veprimi. Pra, "Nga kjo ngjet edhe përsëritja tragjike e historisë dhe lind papritur në mendjen e dikujt

ideja e marrë e pushtetit mbi njerëzit duke ngjallur një diktator të vdekur si ngjallën diktatorin Hidër, prandaj më vjen të ulërij kur kujtoj hutimin e përgjithshëm që shkaktoi nxjerrja e të përbetuarve para gjyqit. Njerëzit nuk u besonin syve të tyre. Ndonjëri ende beson se nuk ishin ata që ngjallën diktatorin Hidër. E vetmja gjë që mund të bëj për t'ua mbushur mendjen është t'u tregoj për Ben Kitën, të cilin e shtyva me vetëdije drejt vdekjes për të ndërprerë vargun e vrasjeve të tjera, por përsëri kam frikë se vallë do më kuptojnë" (f. 317).

Gjendja e rëndë që krijohet pas shpalljes së ngjalljes së diktatorit shprehet mirëfilli me këtë të dhënë: "E kam thënë që në fillim se po ecim të verbuar drejt absurdit" (f. 254), po dhe me atë që thotë poeti, i cili i kishte kushtuar një poemë diktatorit: "Ishte gjashtëdhjetë e katër vjeç dhe për herë të parë po kuptonte se kishte jetuar kot" (f. 200).

Realiteti i tillë i rëndë dëshmohej në mënyrë të ndërmjetme, sidomos përmes pësimeve: "- Mua më duket sikur endemi në një kohë kotësie, ku është e vështirë të duash diçka të përcaktuar".

Për ta bërë sa më të ngatërruar çështjen e shpalljes së ngjalljes së diktatorit (Ai ngjallet duke e përhapur vetëm zërin e tij, f. 141), pëshpërtejt e flitej se do të shkaktojë hakmarrje të tmerrshme; ishte fshehur për t'u kthyer kur ta shihnte më të arsyeshme dhe, i mbushur me urrejtje, të hakmerrej në mënyrë më të ashpër, jo vetë, po përmes të gjallëve: "Erdhi koha të hakmerrem, por nuk do hakmerrem vetë, por nëpërmjet atyre që do të këmbëngulin se kam vdekur, kur e dinë më mirë se kushdo se nuk kam vdekur, se jam gjallë në sajë të tyre" (f. 197). Gjithë kjo a nuk mund të lidhet me atë që thoshte shkrimtari Ernesto Sabato: "Nga thellësitë më të errëta të trupit ngjitet drejt shpirtit një neveri instiktive për kaosin dhe ankthi fizik shndërrohet në ankth metafizik".

Gërmime në thellësitë e botës shpirtërore përmes artit

Romani "Ngjallja e diktatorit" në qenësinë e vet është një gërmim në synimet dhe në veprimet e pasardhësve të diktaturës dhe të diktatorit, pasojë e vetë diktaturës dhe rrënimet shpirtërore dhe mendore që kishte shkaktuar. Koha e pasdiktaturës cilësohet me tundime shpirtërore të mëdha, me pësime e tragjika të shumta. Pra, përmes tekstit poetik Lera ka gërmuar në shpirtin e njeriut tonë dhe në kundërthëniet që u dëshmuar në kohën paskomuniste. Këtë e qartëson mirëfilli edhe drejtori i gazetës *Mëngjesi i kombit*: "- E ç'rëndësi ka në ka vdekur apo jo zoti Hidër. Këtu nuk bëhet fjalë për një njeri konkret, por për një koncept që vdes dhe ngjallet si mikrobi i kolerës. E di që më akuzoni se duke botuar reportazhin që lexuat, do ndihmoj në përhapjen sa më të shpejtë të këtij mikrobi, por kjo nuk është një akuzë që qëndron, sepse si më bëhet mua mund t'i bëhet kujtdo" (f. 242).

Pra, koha e pas diktaturës është rrjedhojë e pandërmjetme e asaj që ka ndodhur në diktaturë, prandaj me një qetësi dhe me tundime tronditëse, fshehtësi dhe dukuri të dhimbshme bëhen edhe vrasje, që kishin "[...] për qëllim të ngjallin frikë te njerëzit dhe pas tyre revoltën e tyre që kjo gjendje të ndryshojë" (f. 297).

Në këtë rrjedhë duhet parë flijimi i hetuesit, Ben Kitës, që përpiqet të zbulojë nxitësit konkretë që kishin shpallur ngjalljen e diktatorit edhe se edhe brenda

tij (gjatë hulumtimit) kishte filluar të ngjallet një i vdekur.

Dalëngadalë, e vërteta sa shkon e qartësohet nga se "Të gjitha vdekjet kanë lindur nga një tru i ftohtë" (f. 297) dhe se "Për herë të parë atë ditë u përdor termi i ri *forca të errëta*. Tërë krimet ishin kryer prej tyre. Ata kishin dalë nga kushedi çfarë skutash dhe duke qenë të pakapshëm, po ktheheshin në qenie gjysmë mitike. Gjëja më e vështirë ishte t'u jepje një fytyrë njerëzore. Duke qenë kaq të papërcaktuara ato futeshin kudo fare lehtë (atë ditë u shitën të gjitha bravat e mbetura dyqaneve të humbura dhe dritareve të kateve të poshtme iu vunë hekura) edhe nga një e çarë sado e vogël në derë. Çdo zhurmë ishte e dyshimtë" (f. 299).

Shpallja e ngjalljes së diktatorit shkaktonte që brenda njerëzve të fillojë të jetojë diktatori dhe të përligjen tundime të egra dhe ligësitë që të sundohet tjetri: "Është e kotë të kërkojmë brenda vetes ato forca që e mbajtën gjallë njëzet vjet të vdekur, zotin Hidër. Ai ka të drejtë të nxehtë me ne. Nuk kemi mbërritur ende atje ku duhej të kishim mbërritur. Ende ka njerëz që dashurohen. E kuptoni ç'sfidë na bëjnë njerëzit që dashurohen në këtë kohë? Ne duhet të futemi mes dashurisë së tyre që puthja t'u ngrijë në buzë. Fëmijët e tyre duhet të jenë pjellë e dëshpërimit. Kështu më tha mbrëmë zoti Hidër. Ai kishte dalë për të parë si silleshin njerëzit dhe i ishte prishur gjaku, ai gjak që nuk ia prishi dot as vdekja. Më mirë të mos kisha dalë, më tha. Shumë çifte që putheshin si të mos e kishin marrë vesh kthimin tim. Shpresoja se do i kishit hedhur të gjithë kundër të gjithëve, shpresoja që njerëzit së bashku me ajrin të thithnin pasigurinë, shpresoja të shihja se vdekja ime kishte marrë fund, por pashë se ajo vazhonte" (f. 263).

Rrënimi i përmendores së diktatorit ishte një akt jashtësor për arsye se "përmendoret" e diktatorit ishin njerëzit e gjallë: "Në një artikull të shkruar kur pa rrëzimin e përmendores theksonte (autori) se po nuk u rrëzuan përmendoret e gjalla, ato që janë ngritur brenda nesh, diktatorët kanë për t'u shfaqur pa zhurmë dhe kur t'i kuptojmë kush janë do jetë vonë, tepër vonë" (f. 203).

Njeriu e ka pjesë të shpirtit që ta fshehë



maskën e vet; ajo mbetet një e fshehur e pazbuluar gjate gjithë jetës, mbetet një mister: "Edhe kur vdes njeriu nuk e krijon dot maskën e tij të vërtetë?" (f. 235). As përmes allçisë. Kjo dëshmohej nga sjelljet e parëndomta në rrjedhën e veprimit të përditshëm nga se ndodhin paradokse të çuditshme: "Vendi ku ishin rrëzuar përmendoret u bë vend ku shkonin të dashuruarit, vend pelegrinazhi, si një vend i shenjtë ku flijohej virgjëria (f.167).

Urrejtja që i ngarkohet diktatorit të gjallë ose atij që shpallet së është ngjallur së vdekuri, është, në të vërtetë, e vetë atyre që synojnë ta kthejnë kohën e diktaturës, përkatësisht të bëhen vetë diktatorë, pa marrë parasysh vuajtjet dhe pësime të njerëzve: "Ai është mbushur me aq shumë urrejtje këto njëzet vjet sa nuk do t'i mjaftojë as edhe një shekull për të kënaqur urrejtjen e tij" (f. 302).

Kjo dëshmohej nga ajo që thotë në një rast kryeredaktori i gazetës *Mëngjesi i kombit*: "Sigurisht, mbasi dinamiti që iu vu shtëpisë sime e përforcoi edhe më tepër bindjen tonë se pas emrit të diktatorit Hidër fshihen diktatorë të rinj, që kanë ambicie për ta tejkaluar atë" (f. 303).

Gjithë ajo që ndodhi në kohën e diktaturës, sidomos pas saj, që është objekt poetik i romanit "Ngjallja e diktatorit" të kujton pashmangshmërisht mendimin e Faik Konicës: "Në qoftë se Shqipëria do të vdiste ndonjëherë, atëherë në epitafin e saj duhet të shkruhet: "Lindi nga Zoti, shpëtoi nga rastësia, vdiq nga politikanët"

Rëndësia e magjisë së artit të fjalës

Edhe në këtë roman, siç ndodh dhe në romanet e tij "Nata e premierës", "Kishim një ëndërr" "Ana Zh", Të gjallë dhe të vdekur", "Të gjithë premtojnë Parisin" e të tjerë, Nasi Lera dëshmohej mjeshtër i madh i shtjellimit të krijesës tërësore shprehëse poetike dhe komunikuese, i ndërtimit me përkushtim të tekstit poetik. Tek e fundit, vetëm të shprehurit poetik e bën një vepër letrare, në rastin konkret, romanin, krijesë të mirëfilltë arti, pikërisht ashtu siç thoshte shkrimtari i shquar, Jorge Luis Borges: "Magjia e fjalës, siç thotë Stevenson, është një ndër

cilësitë themelore që duhet të zotërojë një shkrimtar"¹⁰ ose atë që theksonte Ernesto Sabato: "Do të pëlqej më shumë një stil që jep ndjesinë se frymon sikur qenie e gjallë"¹¹.

Nasi Lera njëmend e zotëron këtë mjeshtri dhe kjo e përcakton vlerën kryesore të kësaj veprë të tij e jo tematika dhe aktualiteti i saj. Pikërisht teksti poetik kushtëzon shumësinë kuptimore¹², komunikimin e veçantë dhe ndikimin estetik¹³ në mënyrë më të plotë.

Po sjell vetëm disa shembuj për arsye se të tillë janë të shumtë në roman.

Sytë e saj të tmerruar ishin aq të pafajshëm në gjëmën që kishte përjetuar sa edhe retë që pasqyroheshin aty, iu dukën sikur pikonin gjak. Vajza kishte qenë e virgjër, gjaku ishte mpiksuar mes kofshëve ende të paformuara mirë.

Shkoi dorën mbi mjekër dhe si të kishte prekur dhimbjen që nuk ia kuptonte njeri (as Alma Broja) ndjeu se ashtu si me duhanin edhe me jetën, kishte mashtruar veten.

Të dy kishin ngrënë me nxitim darkën dhe ishin ngjitur në dhomë të shtyrë nga i njëjti padurim dhe e njëjta befasi e ëmbël dhe e frikshme, që dergjej mbi shtrat së bashku me dritën e zbehtë që hynte nga rruga [...] U zhveshën me nxitim dhe sa u shtrinë nata humbi përtej shiut dhe shkrepimave të shpeshta që verbonin detin.

Vetëm flokët e verdhë i dalloheshin, si të derdhej mbi ta drita e një hënë të sëmurë. Ishte e vetmuar dhe kur ai iu afrua ajo u drodh nga frika. Asnjë femër nuk i ishte trembur ashtu. U hutua më shumë se ajo. Ai e dinte, pa e pyetur, ç'priste aty, megjithatë për të mos heshtur e pyeti. Ajo i tha se ishte strukur nën bredhat se kishte frikë. Ajo duhej t'i ishte fshehur dikujt. Atij i erdhi keq sepse ajo ishte aq e bukur, por më tepër e preku vetmia e syve të saj. Atë e kishin prekur gjithmonë njerëzit e vetmuar. Ata i ngjallnin një mërzi të përzierë me dhimbje. Ndofta kjo ndodhte nga që ishte nga një qytet i vogël provincë, ku njerëzit e mbanin në shpinë vetminë si një guall i zbratur breshke. I tha të mos trembej prej tij. Ai e përcolli për në shtëpi dhe kur po ndaheshin ajo e puthi. Tërë natën u përpëliti, sepse i dukej sikur mbi fytyrë i derdhej një dritë e verdhë që kishte butësinë [...].

Ëndrrat ishin tretur brenda pafajësisë së tyre si brenda një arkivoli të tejdukshëm.

Dera u mbyll pa u përplasur. Hapat ushtuan në korridorin e heshtur duke tërhequr pas, si një karrocë të lashtë, dritën e sëmurë të asaj të diele dhjetori.

Në jetën e tij emrat e shumtë që kishte njohur ishin rralluar dhe mungesa e tyre ishte e rëndë si një shkëmb që gërryhej gjithmonë nga dallgët e kripura dhe të hidhura. Sa herë ishte zgjuar me një zbrazëti në gjoks nga ëndrrat ku i kishte takuar në gjumë, si të mos kishin vdekur. Shefi pa se edhe jashtë ishte e njëjta dritë e bardhë nën

¹⁰ Jorge Luis Borges, Ligjërata. Përktheu nga frëngjishtja Feride Papeka, Pika pa sipërfaqe. Tiranë 2013, f. 10.

¹¹ Ernesto Sabato, Heterodoksia, vep. e përm., f. 37.

¹² Shih veprën e përbashkët ne Labinot Berishën Ligjërime rreth tekstit letrar poetik (Me Labinot Berishën). "Faik Konica", Prishtinë 2017.

¹³ Shih veprën e përbashkët ne Labinot Berishën Estetika dhe estetika e letërsisë. Tekst për studentë. "Faik Konica" 2018

të cilën i shihte, ata që nuk ishin më. Ai nuk e shpjegonte përse do ndodhej gjithmonë nën të njëjtën dritë si në gjumë ashtu edhe zgjuar.

Sa shpejt, tha kur pa vilat e shpërndara mes agrumeve. Ato nuk janë zgjuar ende. Atë e trishtonin dyert dhe grilat e mbyllura të vilave në dimër. I dukej sikur brenda tyre njerëzit kishin lënë, pa e kuptuar gjethet e zverdhura të kujtimeve [...] Ndofta nga magjia e diellit dhe detit. Ky dimër hyri i zyrtë dhe po vazhdon i tillë. Në breg nuk shihej asnjë njeri. Edhe ishujt mezi dalloheshin. Si dy dhimbje të ngurtësuar.

Ajo një çerek ore kaloi mes një heshtje varri, si të ishin varrosur të gjithë së bashku me kufomën, fytyra e së cilës nuk ishte gjë tjetër veçse një maskë e bardhë allçie, që po ngrinte dhe po përjetësonte tiparet e fundit, të cilat pas dy ditësh do humbnin përgjithmonë.

Alma Brojës i erdhi për të qarë sa dëgjoi zhurmën e shiut. U përpoq ta kapërcente atë gjendje vetëm duke u munduar të flinte, por e qara i vërtitej në gjoks. Ishte nga të dielat e rralla me shi që zgjohej aq e ligështuar. Nuk ishte zgjuar as nga ndonjë ëndërr e keqe që të ndjente atë trishtim të papërbalueshëm dhe atë vetmi dimërore sa i erdhi për të qarë. Në dhomë ishte errësirë. Drita e mëngjesit lëngonte përtej dritares si një refugjat.

Dhe ishte shtangur para kërcënimit që rridhte së bashku me shiun e ftohtë të atij dimri. Vrasjet ishin si një qiell i pagojë.

Dhe nuk ishte më deti që ushtonte. Ishte gjaku ynë që më në fund po çlirohej nga ngërçi. Dhe nuk e mbaj mend sa vazhdoi vuajtja jonë e ëmbël...

Sa mendoi kështu iu duk sikur po udhëtonte mes një bregu të shkretë me duna, ku bari i rrallë përkulej nga era si në një vajtim.


[...] përtej nuk është askush tjetër veçse qenia jote që edhe ajo thërret drejt teje. Njeriu gjendet gjithmonë përballë vetes. Kjo është për mua vetmia më e madhe. Dhe vuajtja më e madhe.

Po e mbyll këtë punim për romanin e Nasi Lerës "Ngjallja e diktatorit", përmes të cilit autori e shqipton me mjeshtëri dhe përmes artit tmerrin e jetës dhe ligësinë e njeriut për ta sunduar tjetrin në kohën e pas diktaturës në botën tonë shqiptare, pasojë e gjithë asaj që kishte ndodhur në diktaturë me mendimin e shkrimtarit të shquar argjentinas, Jorge Luis Borges: "Tashmë unë e kisha vënë re se vargjet, sidomos vargjet e mëdha të Dantes, janë më shumë se sa ajo që shprehin"¹⁴. Teksti poetik i këtij romani të Lerës është, njëmend, më shumë se sa ajo që shprehet – se fitohet përshtypja që shprehet. Këtë dukuri, natyrisht, e kushtëzon para së gjithash gjuha poetika dhe mënyra si shprehen e shtjellohen çështjet dhe mendimet në tekst po dhe natyrshmëria e të rrëfyerit.

Prishtinë, fillim dhjetori 2024

AT AMBROZ MARLASKAJ... PËRTEJ DIJEVE TONA PËR TË

Nga Frano Kulli



Nuk ndodh shpesh, që në sipërmarrjen për të bërë jetëshkrimin (monografinë) e një personazhi historik me të cilin ke lidhje gjaku, sidomos kur ai është me një rëndësi të posaçme publike, të mos biesh në "kurthin" e përjetimeve ndiesore që ka organikisht kjo lidhje e për pasojë të mos biesh në njëanësi qëndrimi e përshkrimi përreth tij. Autori i librit për të, Ndoc Frroku, stërnip i At Ambroz Marlaskajt e ka tejkalluar mrekullisht këtë kurth.

Ai ka shkruar një libër arkiv; libri i tij është dokumente, është epistolar i pasur sa s'ka. Libri nuk është aspak empati për njeriun e fisit e qëndisí (qëndisje) me lule e lajle, siç na ndodh shpesh e masandej të na krijohen mite të rrejshme. E atëherë mëkati historik bëhet edhe më i madh kur marrim përsipër të jetëshkruajmë për personat e njimentë të trashëgimisë sonë më të mirë. Do të ishte mëkat edhe me i madh, gjithashtu të ndodhte kjo për njërin prej kombformuesve të Shqipërisë, siç ishte At Marlaskaj. Po jo e jo, kjo nuk ka ndodhë.

Libri është vetë Marlaskaj. Frat, mësues i sprovuar i të gjitha cikleve shkollore në Shqipëri e profesor i Universitetit Antonian në Romë, gjuhëtar e përkthyes, publicist e veprimtar publik, deputet asambleist i zgjedhur me plebshin (dhjetor 1923-qershor 1924). I emërtuar me përkëdhelí si "gozhdë e Parlamentit", prej kolegëve elitë për shkak të opozitarizmit të thekur. Me një formim juridik, që e përtejson njohjen e thellë të së drejtës kanonike, me zemër të madhe në shërbesë vetëm të së drejtës e të dobishmes, që nuk e shet shpirtin asnjë grimë, për asnjë rrethanë. Me dyzinën e letrave e halleve të njerëzve të popullit, që përfaqëson, të cilën e shpraz në asamble e në qeveri, me ngulmimin që të ofrojë zgjidhjen për ta.

Pader Ambrozi është mirditor i që përtej Republikës së Mirditës, shumë

përtej saj hedh të pamin (vizionin) e vet te Republika e Shqiptarisë. Madje e qorton si të damshme fort atë krijesë, me forcën e pashembullt të arsyes e me arsyen e pashembullt të forcës morale e shpirtnore. Sikundërse gjindet në krah të opozitës e "lobit shkodran" siç pagëzonte grupin e madh asamblist opozitar një shkruer i "Diellit" të Bostonit (Ledio Xhoxhi), përkundër "klikës" konservatore të udhëheqësisë së kohës. Sepse te e para, ku qenë rreshtuar vërsnikët e tij, ajka e mendimit dhe shërbesës kombëtare, Gurakuqi, Fishta, Mjedja, Hilë Mosi, Xhemal Bushati e Halid Rroji, po edhe Avni Rrustemi që printe shoqinë "Bashkimi", dallon prosperitetin e dheut të vet, Shqipnisë, drejt oksidentalizmit e jo në ndalesën e prapambetjen e atavizmave të perandorisë së vjetër otomaniste. Sikurse qe gjëndur më heret, qysh në shtatorin e 1916-ës në këtë krah me njerëzit më të iluminuar të Shqipërisë, si Luigj Gurakuqi, At Gjergj Fishta, Sotir Peci, Dom Ndre Mjedja, Mati Logoreci, në themelimin e Komisionit Letrar të Shkodrës dhe më pas me pjesëmarrës dhe të ftuar të tjerë, po kështu të shquar si dr. Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Anton Paluca, Hafiz Ali Korça, Aleksandër Xhuvani, Maksimilian Lamberci, Rajko Nahtigal, Emzot Vinçens Prenushi, Sali Nivica, Josif Haxhimima dhe Luigj Naraçi.


Gjithsa më sipër e shumçka më përtej, vjen përmes gjuhës së ftohtë të fakteve e dokumenteve të bollëshme. Për të shërbyer përkushtimin e tij autori ka përzgjedhë tjetër mënyrë; atë të të rrëfymit nëpërmjet gjuhës së ftohtë e të pa emocion të fakteve, të dokumenteve, të letrave. Për autorin sentenca e vjetër e latinëve: "Verba volant, scripta manent", (fjala fluturon e shkruara mbetet) si duket, ka qenë busulla e saktë që e ka orientuar prej fjalës së parë e deri tek

fjala e fundit e librit të tij. Për të, që librin e vet e çmon qysh në krye të herës si mision, misioni fillon te gjurmimi e hulumtimi i dokumenteve, si e vërteta më e pranueshme. Dhe misioni faktmbledhës zgjat shumë më shumë sesa vetë shkrimi, masandej i librit. Kështu besoj unë. Ndaj e gjithë përpjekja e tij më e peshueshme ka qenë mbledhja e sistemimi i fakteve e dokumenteve, në radhë të parë; në Tiranë, a në Romë, kudo ku ato janë gjindur. Vetëm nga letërshtëmbimi i Marlaskajt, autori ka hulumtuar e i kalon në laboratorin e vet krijues rreth 300 prej tyre, qysh prej kohës së tij studentore në Salsburg-Austri e deri sa mbyll sytë në Itali me 1939. Letra me popullin e zgjedhësit e vet, me mësues anë e kand nga Shkodra në Lushnje, me sivëllezërit françeskanë, me Anton Harapin e me Fishten, me Justin Rroten për nevojë gjuhësore e me shumë e shumë të tjerë personazhe qytetëse të dijes, të politikës e atdhetarisë. I bindur se gjuha e tyre do të ishte më e besueshme se gjuha e rrëfimeve të të afërmeve të tij apo edhe e rrethit më përtej të bashkëvllazëve e vërsnikëve të tij. Krejt ndryshe prej ravijëzimit të portretit të Marlaskajt që na vjen prej librit "Françeskanët e mëdhaj", bie fjala, të një mjeshtri "par excellence" të rrëfimitarisë si At Zef Pllumi, ku portreti ndërtohet me metafora e simbolika të epërme e krahasime nga eposi i vjetër "me Gjergj Elez Alinë që ndeshet në fushë të bejlegut me Harapin e Zi"...

Edhe kur i duhet me lidhë dokumentet gjithnduershe e të bollëshme me fillin e interpretimeve të veta, autori ruan të njëjtën mardhënie ndërmjet gjendjes emotive dhe racionale, duke vënë në rend të parë, gjithherë racionalen e duke konkluduar sipas asaj, për të vjelë të vërtetën më të besueshme e të pranueshme. E bën këtë deri në detajet më të imta të narrativës së vet, qoftë edhe me fakte të ndëvarura që i synon me këmbëngulje për më të bindshmen e saj. Bie fjala, sjell edhe autopsinë e mjekëve në vrasjen e Avni Rrustemit, për të zgaqë (zbuluar) prej më së afri ngjarjet e rrafshit të politikës e saktësisht ato të parlamentit, mis (antar) i të cilit ishte Marlaskaj. Por sjell në libër, gjithashtu edhe fjalët e përkundërta të shkruara të Eqrem Bej Vlorës, nipit të Esat pashë Toptanit për vrasësin e njeriut të tij. I bindur se mënyra më e mirë për korrektësinë historike është përballja e dokumenteve.

Ose, në rastin e formimit të qeverisë së Nolit, sillet në libër ky kumt i shkruar i At Marlaskajt, dëshmitar okular e aktiv i asaj ngjarjeje: "... u shenjuen si kandidata per Kryeministri: Noli, Gurakuqi, Koculi, Delvina. Nder këta të kater u qit short e, si diehet duel Noli". I panjohur ky fak a më saktë i pashënuar në asnjë cep të historiografisë shqiptare të deritashme. Megjithatë autori, me paanësinë e ftohtë të zgjedhur si metodë analitike qysh në krye të herës, e shumta dërgon një ftesë për nxitjen e autoriteve shkencore për të hedhur më shumë dritë mbi këtë moment.

E momente si ky ka shumë e shumë në libër, edhe në të tjera fusha të dijes e atdhetarisë, ku shkëlqen Marlaskaj ynë që mund të bënin vargun e shembujve e prej ku na vjen më i plotë se gjithëherë më parë, njëra prej figurave-shtylla të rëndësishme të ngrehinës së kombit tonë e të palcës së tij, At Ambroz Marlaskaj.



¹⁴ Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, vep. e përm., f. 10.

Që të shkruash nevojitet të jetosh me iluzione, credo quia absurdum est. Kështu e përfundon një pasazh kuptimplotë mbi letërsinë dhe impaktin e saj në përgjithësi, shkrimtari kroat Danillo Kish.

Pikërisht mes iluzionesh dhe absurdit hapë trasenë e vet romani i sapobotuar i shkrimtarit dhe publicistit prishtinas Ballsor Hoxha. "Bora dhe unë" - nuk përputhet me asgjë me çka mund t'u asocojë vetëm nga titulli ky roman. Prandaj, duhet lexuar dhe rilexuar disa herë për të gjetur Borën dhe mëpastaj për të kuptuar se ku gjendet Uni. Me "Uni" do të mund t'i referohem herëpashere personazhit kryesor për efekt shtjellimi por jo vetëm. Autori jo pa qëllim duhet ta ketë vënë këtë titull që lehtas e zgjon kërshërinë dhe që nuk pompon pretendime të mëdha. Më duhet ta theksoj që në krye të herës që me romanin në fjalë u miqësua shpejt sepse është nga ata botime ku vërehet me nisje që autori nuk shkruan apriori për kritikën as për lexuesin masovik por pikë së pari për veten - për veten në këto role. Do pajtohet, e besoj, secili me këtë konstatim sepse në lexim e sipër aq thellë trazohen e mëdyshen vetat sa në fund fare vetë personazhet shastisat e dyzohen aq shumë sa lexuesit mund të sikletosen me pyetjen se ku fillon njëri e ku mbaron tjetri; në një takim të mundshëm me autorin s'do mend që lexuesi mund të frymëzohet dhe për atë pyetjen kryesore: ku fillon e mbaron vetë autori të "Bora dhe unë"? Një roman për transin dhe tranzicionin që bën mirë ta lexojë secili që i dyshon këto koncepte, për më tepër çdonjëri që i beson.

Do përipiqem që shënimin që po lë ta bëj sa më të afërt për lexuesin duke mos pretenduar që të bëj punën e ndonjë kritiku letrar por megjithatë të gjejë pika të afërta mes lexuesve dhe autorit.

Romani në fjalë është një shtrirje rrëfimi në rreth dyqind faqe ku pothuajse takohen të shumëtat ndjesi sublimë njerëzore: dashuria, empatia, paragjykimi, prindërimi, kohërimi, morbidja etj. Storja hapet me një tip prologu, me një hyrje që sipas ngjeshjes lë të kuptohet që autori e ka përpunuar gjatë dhe kujdesshëm deri pak orë para dorëzimit. Duhet thënë, kjo është veti e autorëve të kalitur dhe të mirëpërgatitur çka duhet theksuar dhe në këtë rast. Më tej, romani shtrihet në dymbëdhjetë kapituj, ku kapitulli i dhjetë mund të merret si sprovë epilogu. Vijimi edhe i dy kapitujve të tjerë tej këtyre verzionëve epiloge i jep rol bashkëautorësie secilit lexues i cili gërryen me forcat e veta drejt gjetjes së dritës në fund të një tuneli sabatoian.

Në pamje të parë, boshtin e romanit e përbëjnë një baba dhe bija e tij. Babai ka një krisje shpirtërore që përipiqet ta shërojë dhe sëmbojë me të bijën (dhe me atë pak shoqëri që ia lejon memorja). E bija, është elementi perspektiv i një brezi që po rritet dhe që i duhet rikujtuar herë pas here që tej ingranazheve të tekno-shekullit egzistojnë do korda që na përshkojnë e ingrananojnë - janë shpirti dhe e kaluara. Brezat gjithsesi e gjejnë gjuhën e përbashkët kur komunikojnë. Kjo ngjanë dhe në këtë rast, biles falë kësaj hera-herës rrëfimi anëmbanë nga e bija (bijtë) si heroinë e njohjes së realiteteve. Prandaj, autori e ka vënë të parën atë - Borën, dhe pastaj veten e vetat e tjera.

Por, kjo përbën vetëm kalimin e shpejtë të storjes. E vërteta qëndron pak më bukurthellë se kaq.

Pista e rrëfimit është Prishtina. Pista mbetet unike kurse kohët dhe perspektivat lëvizin si avionët në ato aeroportet fluksshumëta. Në fillim të herës e pata shënuar se ky roman më jep një përshtypje të veçantë për faktin se ngjarja nisë dhe bitisë në mikrozonën ku unë kam kaluar pjesën më esenciale të jetës, bëhet fjalë për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Nga oborret e kësaj ngrehine, gjegjësisht

Mbi romanin "Bora dhe unë", Ballsor Hoxha

"KRISJA" SI BEKIM BALLKANIK

Nga Argëzon Sulejmani

nga korridoret e Klinikës psikiatrike, autori nisë ngjizjen dhe ngjeshjen e këtij romani. "Bora dhe unë" ngërthen shumë Prishtinë prindërisht: atë të prindërve tanë por dhe atë të prindërve të fëmijëve tanë. Është në fakt një stol brezash ku duhet të ulet secili që për sado pak nuk fluturon.

Bambuset dhe xhinset 501 bashkë me aty-këtu slangun prishtinas të viteve të nëntëdhjeta janë sekuenca që zgjojnë nga humbëtira memorjen kolektive të një qyteti që kohës duket se i ka shitur shpirtin dhe qenjen. Bipolariteti i personazhit kryesor lidhet ngushtë me cilësimin e njëjtë përkundruall urbanes dhe kolektives së këtij qyteti. Polet e personazhit që rrëfehet në veten e parë si dhe të Prishtinës që rrëfehet në veten e tretë puqen në korridoret spitalore. Si njëri si tjetra përipiqen të gjejnë vetveten pa dashur të besojnë që "nuk mundemi dot të lahemi dy herë në një lumë". Për më keq, sikurse tragjikja me Vëllushen e Prishtinës: mbase nuk do të mund të lahemi

asnjëherë më në atë lumë. Në raport me kohën, po kjo insinuatë tragjike na mëson se ëndrrat zgjasin pak por marrin gjithë kohën e jetës, ashtu si ëndrra për ta bërë Prishtinën si Londra është më së paku një dremtje, një ekstazë e assesi një krisje që ka nevojë për një doktor. Ka nevojë për sa më shumë jetë dhe rrëfime, dhe... vetëm kaq. Credo quia absurdum est.

Personazhi tjetër, në fakt titullori i parë sipas autorit është Bora. Bora, para se të hymë në palcën e rrëfimit, do duhej të simbolizonte bardhësinë përpara vetë personazhit në titull e rrëfim. Bardhësia galaktike, bardhësia e dërrasave, bardhësia e memorjes, bardhësia shpirtërore janë cilësi parapersonazhe që kanë një rol dominant në të gjithë historinë. Kontrasti që, guxoj të them, mund ta ketë tentuar autori me Unin është evident. Një variant titulli në këtë rast mund të kishte qenë: "Bardhë e zi" ose "Bora dhe Skëterra". Në secilin rast, determinanta është amullia,



verbimi, rrjedhimisht përzgimi i shqisave më të thella, le të themi emergjente.

Kur kam nisur leximin e "Bora dhe unë", ndër të parat bindje që më kanë shkuar nëpër mend ka qenë që të njëjtin një ditë do doja ta lexoja së bashku me fëmijët e mi. Uni, e bija, koha dhe patria. Drenusha është e bija e kryepersonazhit. Drenusha sapo ka nisur decenien e dytë të jetës dhe barra që i vie nga prindi hera-herës është tejet e rëndë për vertebrat e saja të njoma. Gjithsesi, Drenusha, që prapë mendoj që është një gjetje tej emrit dhe e cila ka të bëjë me vetitë atletike dhe mistike të së njëjtes si kapërcimi, çarja, aura, luan rolin kyç në vijimësinë e jetës së kryepersonazhit. Po Bora? Kush është Bora? Është vërtetë ajo një mike e Drenushës apo vetëm veta e dytë e saj? Bora dhe Drenusha mund të jenë dyzimi mbi të njëjtin personazh në variantin më të parë, por këtë ia lëmë në dorë lexuesit dhe autorit si dhe lidhjeve te shkurtëra që do të mund të mëtojnë t'i krijojnë ata.

Romani priret nga pak personazhe dhe shumë historira. Bici, Dafina, Jehona, Fati, Malësori. Që të gjithë pjesë të etablosë së një kohe që personazhit kryesor "i ka mbetë pikë" në jetë. Thënë me motive kadareane për "krisjen" si fenomen masovik dhe gjuhësor shqiptar, janë këta personazhe që përbëjnë "pykën" në korteksin e personazhit kryesor. Meqenëse vetë autori e lë të dyshimtë kategorizimin e këtij fenomeni, atëherë dhe ne e kemi të vështirë ta ndajmë në këtë rast bekimin nga mallkimi lidhur për të njëjtin. "Krisja" si bekim ballkanik!

Parapëlqej ta bëj të qartë thelbin e rrëfimit në respekt dhe kureshtje të secilit bashkëlexues. Loja e këtyre personazheve e ka fillin në Prishtinën e viteve të nëntëdhjeta, por që tentakulat i lëvizë mjeshtërisht dhe nëpër periudha të tjera kohore. Është pikërisht kjo kohë dhe disa ngjarje të saj opsioni që mund t'i faturohet çrregullimit psikik të personazhit kryesor, përkatësisht diagnostikimit më afër mendsh të tij. Nëse në shumë raste jeni thirrur në përsëritjen si nëna e të nxënës, në këtë rast është e krejt e kundërta: përsëritja si patria e harresës. Opsioni repetitiv është i thjeshtë: Bici dhe Dafina janë çifti që i japin ngjyra amnezisë së kryepersonazhit: ata kanë migruar në vendin e ëndrrave të asaj kohe, në Londër. Jehona është mikesha e përbashkët e çiftit dhe njëherit simpatia dominante e kryepersonazhit. Ajo vazhdon të vijë në shumë variante tek Uni dhe mbetet po ajo e idesë fillestare - e qasshmja dhe e paarrishmja. Sikurse te rasti i Borës ku mendoj që autori ka luajtur mjeshtërisht me ambiguitetin, thuhet njëjtë ndaj bindjen dhe për Jehonën. Jehona, sikurse mund të bëhet e qartë pas disa leximesh, mund të jetë një qenie pa frymë, një rezonim pa fund e krye, një jehonë nga thellësia e galaktikave ku kryepersonazhi gjenë prehje dhe qetësi të përkohshme. Personazhi tjetër, Fati ose Stalkerit sipas dominancave filmike të kohës, mund të jetë personazhi i vetëm i



pa të dytë i cili ka jetuar por nuk jeton më - gjithçka tjetër insinuan në jetesë pa vetë jetën përbrenda. Fatin dhe kryepersonazhin i lidhë bashkë e bardha bojë dhe i bardhi "mall". Bëhet fjalë për heroinën, e cila të lartpërmendurit i ka kushtuar dhe marrë jetën. Fati, si feniks vie dhe rri kaq shumë në jetën e vetë kryepersonazhit dhe në fund të krijohet bindja që e dominon atë sikurse mbarë logjikën ballkanike se, vetëm të vdekurit i kemi miq fund më fund. Ose, vetëm e vdekura jonë përbën melankoliken dhe përkrenaren e jetës sonë. Dhe këtu autori e vë në sprovë disocimin e kryepersonazhit dhe me këtë vetë botën e lexuesit.

Zeza dhe Patria përbëjnë urën lidhëse në mes bestytisë dhe filozofisë në vështrimin tim. Se sa mund të jetë reale kjo urë në Ballkanin e plasjeve të urave, kjo është temë më vete. Parapëlqej mos të zgjatem shumë në këtë drejtim me arsyetimin se kjo mund ta lodhë dhe stepë lexuesin. Por, në të njëjtën kohë ta motivojë dhe nxisë në lexim më të thellë se sa thjeshtë një ngjarje çarjeje personaliteti. Zeza është macja e zezë e cila me vetë ngjyrën dhe botërinë e saj mund të ndjellë ankthin, mortin apo shumësinë e vetave apo jetëve. Kur po lexoja macen në sytë e njerëzve, në mendje më erdhi së paku autori japonez Nacume Soseki me novelën "Unë jam maçok" ku në fakt flitet për jetën njerëzore në sytë e maceve. Ajo që e dominon atë rrëfim është bindja e maceve mbi abuzimin njerëzor me shumëçka, kurse definitivisht me kohën.

Në anën tjetër Patria mund të ndriçojë një fokus të ri për lidhjen ndërmjet atit dhe dheut, më pastaj në mes asaj që pretendojmë dhe asaj që jemi të deleguar të jemi pikë së pari. Këtu mund të hapet një opus interesant, "a cul de sac", në mes të vetave të personazhit pro dhe kundër filozofisë Heideggeriane. Cila, në fund të fundit, është e vërteta? Ajo që iu rri më gjatë në kokë do të thojë unë. Ajo që do ta grithnit mbi dërrasat e bardha, do të mund t'u thonte kryepersonazhi. Ai me pa të dytë do shënonte me shkronja të mëdha filozofinë e jetës së vet: "i lumtur" në "palumturinë" time! Nga valët që përçon vetë romani dhe nga tallazet që i vijnë Unit nga bregdeti i Durrësit, parapëlqej që sidomos këtë mozaik ta shoqëroj me sekuenca muzikore që si sfont u rrinë shumë vetave dhe situatave në rrëfim. Çkado që të jetë - kryesisht nga Beat Generation, Lou Reed a Dylan, që në vazhimesi i referon autori. Në këtë rast, do të kisha thënë që, referencat muzikore hera-herës ma sfumonin rrëfimin meqenëse muzika është nga artet që lë impakt kohëgjatë dhe mjaftojnë pak nota të dëgjua pavarësisht në mëngjes për ta ritmuar asisoj pothuajse tërë ditën.

Verzionet e autorit aka daljet emergjente si dhe vetë rrëfimi në tërësi e bën romanin një rebus që bashkë me përgjigjet ngre pikëpyetje vazhdimisht. Megjithatë, romani priret nga një gjuhë e rrjedhshme dhe e pasur, me gjetje te kapshme dhe figuracione të pangarkuara, gjë që përbën ftesë për lexim për secilin që kërkon ta trazojë pak veten me lexim, me jetë dhe letërsi. Biles, ndaj bindjen që autori, që njihet për publicistikën eksplicite dhe referenciale, në këtë rast ka bërë një pakt me lexuesin duke i sjellë atij një roman ku të gjitha vetat mund të ndjehen si në shtëpinë e vet. Sigurisht, boshti është pak më i thellë dhe kërkon disa rilexime për të kuptuar kush është kush në rrëfimin ku vetë Uni pranon të jetë askush. Mbetet në dorën e secilit lexues të veçojë dyzimet dhe përngjeshjet e shumëta të personazheve, por, tej kësaj, ndaj bindjen që secili prej tyre do të gjejë pak nga vetja dhe mbi të gjitha do gjejë një autor që ia vlen të ndiqet në rrugëtimin e tij artistik.

Ulqin, dhjetor 2024.

Libri "Malet e gjigantëve" i Carleton S. Coon

Një përkthim mjeshtror në stil dhe në qasje gjuhësore nga Mal Berisha

Nga **Ndrek Gjini**
MA, University of Galway, Ireland

"Malet e Gjigantëve", me autor Carleton S. Coon, është një nga veprat më të veçanta dhe më të vlefshme për studimin e Gegëve të Malësive të Veriut të Shqipërisë.

Ky libër, i cili është një studim i thelluar racor dhe kulturor, u botua fillimisht në anglisht në vitin 1950 si pjesë e serive të Peabody Museum të Universitetit të Harvardit, por iu mohua padrejtsisht publikut shqiptar për më se 70 vjet.

Me përkushtim dhe me një standart të lartë përkthimi, Ambasador Mal Berisha e ka sjellë këtë vepër në gjuhën shqipe, duke ruajtur thelbin, strukturën dhe autenticitetin shkencor të këtij libri.

Dhe unë e ndiej veten me fat që Ambasador Mal Berisha më ftoi të bëhëm pjesë e këtij projekti me kaq vlerë, duke më besuar rolin e redaktorit të këtij libri.

Përmbajtja dhe Vlerat Shkencore të Librit

Libri përfshin studime të thelluara mbi strukturat shoqërore, organizimin familjar, sistemet e martesave dhe ritet tradicionale të Gegëve të Malësive të

Veriut. Carleton Coon ka ofruar një analizë të hollë antropometrike, duke përfshirë matje trupore të mbi 1,000 individëve dhe duke i lidhur ato me mjedisin natyror, zakonet dhe ndikimet kulturore.

Një nga temat kryesore të librit është fenotipi unik i Gegëve të Malësisë, i karakterizuar nga elemente që reflektojnë vazhdimësinë ilire dhe dinarike. Ai analizon ndikimet gjenetike dhe kulturore që kanë ndihmuar në ruajtjen e këtyre tipareve përmes shekujve, pavarësisht izolimit gjeografik dhe sfidave historike.

Përkthimi mjeshtror i Mal Berishës

Përkthimi mjeshtror nga Ambasador Mal Berisha është një vepër në vetvete. Si një bir i Malësive të Gjakovës, ai ka punuar me një pasion dhe kërkim të thellë shkencor në interpretimin dhe përshkrimin e materialit origjinal. Berisha ka ruajtur jo vetëm thelbin shkencor të librit, por edhe ndjeshmërinë kulturore dhe gjuhësore që përmban kjo vepër.

Përkthimi i tij është i pasur në detaje, duke siguruar që termat dhe konceptet antropologjike të jenë të kuptueshme për lexuesit shqiptarë. Një element i veçantë



është fakti që tabelat dhe ilustrimet origjinale janë përfshirë në botimin shqip, duke i dhënë studiuesve një mundësi të rrallë për të shqyrtuar burimet e plota të këtij studimi.

Në parathënien e tij, Berisha ndan motivet e tij personale që e shtynjë atë të angazhohej në këtë përkthim. Ai thekson rolin e tij si një avokat i kulturës dhe traditës shqiptare, duke i dhënë lexuesve shqiptarë një dritare për të kuptuar dhe vlerësuar trashëgiminë e tyre.

Kontributi Historik dhe Kulturor i Coon dhe Berisha

Dr. Carleton S. Coon ishte antropologu i parë që zhvilloi një studim kaq të gjerë dhe të thelluar mbi Gegët e Shqipërisë së Veriut. Ai kaloi muaj të tërë në terren në vitet 1929-1930, duke studiuar jetën e përditshme të Gegëve, matjet trupore dhe traditat e tyre.

Nga ana tjetër, Mal Berisha e ka ringjallur këtë vepër për lexuesin shqiptar në një kohë kur nevoja për vlerësimin dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë kombëtare është më e madhe se kurrë. Puna e tij kontribuon në fuqizimin e identitetit kulturor shqiptar dhe në promovimin e tij në arenën ndërkombëtare.

Stili dhe Qasja Gjuhësore

Një nga pikat e forta të përkthimit është qartësia dhe rrjedhshmëria e gjuhës shqipe që përdor Berisha. Ai ka arritur të balancojë terminologjinë teknike me një stil të kuptueshëm, duke i bërë konceptet e ndërlikuara shkencore të arritshme për një publik më të gjerë.

Përveç kësaj, Berisha ka ruajtur një ton të respektueshëm ndaj popullit shqiptar dhe kulturës së tij, duke nënvizuar vlerat unike që Coon zbuloi dhe dokumentoi në këtë studim. Ai gjithashtu ka shtuar shënime të detajuara që ndihmojnë lexuesin shqiptar të kuptojë kontekstin e veprës origjinale.

Një Trashëgimi Që Duhet Vlerësuar

"Malet e Gjigantëve" është më shumë se një libër shkencor; është një dokument që përshkruan thelbin e kulturës shqiptare në një periudhë të veçantë historike. Ky botim që erdhi në shqip, falë punës së palodhur të Mal Berishës, është një pasuri e vyer për të gjithë ata që dëshirojnë të kuptojnë më thellë rrënjët e identitetit tonë kombëtar.

Ky libër është një urë mes së kaluarës dhe së ardhmes, mes traditave të ruajtura dhe botës moderne. Falë Coon dhe Berishës, "Malet e Gjigantëve" mbetet një testament i fuqishëm i pasurisë së trashëgimisë sonë kulturore dhe një shembull i shkëlqyer në studimin shkencor të kulturës shqiptare dhe prejardhjes Iliro-Dardane të Gegnisë shqiptare.



Lajmi për vdekjen e poetit Aliriza Gashi (një njoftim familjar në "Kohën ditore"), më pikëlloi pa masë, ashtu siç mund ta pikëllojë njeriun vdekja e një miku të dashur, por edhe e një krijuesi të cilin rrethanat jetësore e kanë çrrënjësuar nga trualli i vet etnik, gjuhësor e kulturor për ta vendosur përgjithmonë në një mjedis tjetër.

Aliriza Gashi lindi në Cazin (Bosnjë e Hercegovinë) më 28 mars 1945, pak para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vdiq këto ditë pas një sëmundjeje të rëndë në Sarajevë, ku jetoi e punoi deri në fund të jetës. Ishte vijues pothuajse i rregullt i Seminarit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare që mbahej në Prishtinë deri në vitin 1991, kur, për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë, pushoi së mbajturi.


Edhe pse shqiptar me origjinë (babai i tij, i cili u vra në luftë kur i biri ishte foshnjë, ishte nga Peja) Alirizai nuk shkruante shqip, por në gjuhën serbokroate, përkatësisht boshnjake. Ishte njëri nga krijuesit e çmuar të brezit të vet në mjedisin ku jetonte dhe krijonte. Botoi përmbledhjet me poezi: *Përballë erës* (1971), *Kuq e zi* (1973), *Nga këndi im i vdekur* (1982) etj., por edhe një varg shkrimesh kritike, publicistike, polemike etj.

Në Prishtinë, në botim të "Rilindjes", në vitin 1984, iu botua zgjedhja e poezive me titull *Dashuria e dytë*, shqipëruar nga poeti dhe përkthyesi ynë i mirënjohur Esad Mekuli. Aliriza Gashin e kam njohur së pari si poet, kryesisht përmes këtij libri, ndërsa kontaktet e para me të i kam pasur në vitin 1985, kur në Sarajevë, në kuadër të manifestimit letrar ndërkombëtar, "Ditët poetike të Sarajevës", u prezantua poezia shqipe. Organizatori i këtij manifestimi të njohur letrar ma pati besuar mua zgjedhjen e poezisë. Me kryetarin e këshillit organizues, poetin e njohur Husein Tahmishçiç, qemë marrë vesh që prezantimi të bëhej sipas çelësit gjuhësor e jo sipas atij regional, që për arsye politike praktikohesh në atë kohë. Kërkesës sime që të bëhej një zgjedhje e poezisë shqipe në ish-Jugosllavi (sipas kriterit gjuhësor) e jo e poezisë së Kosovës (sipas kriterit krahinor), kolegët nga Sarajeva i qenë përgjigjur pozitivisht. Fryt i këtij bashkëpunimi korrekt nga të dy palët, qe libri me titull *Iz savremene albanske poezije u Jugoslaviji (Nga poezia bashkëkohore shqipe në Jugosllavi)*, i cili doli serbokroatisht si botim i manifestimit "Ditët poetike të Sarajevës" (1985). Zgjedhjen e poezive, parathënien dhe shënimet biobibliografike për autorët i pata bërë unë, kurse vargjet i përkthyen poetët dhe përkthyesit tanë të njohur Esad Mekuli, Enver Gjerqeku, Mirko Gashi etj. Ndonëse vëllimisht nuk ishte shumë i gjerë, kurse numri i poetëve të përfshirë në të mund të ishte më i madh, libri u prit mirë nga qarqet letrare në Sarajevë dhe më gjerë, kurse mbrëmja e poezisë shqipe (në të cilën mori pjesë edhe aktori ynë i mirënjohur Bekim Fehmiu), u vlerësua si një ngjarje e vërtetë kulturore. Prezantimit të poezisë shqipe iu dha publiciteti i madh në

Mikut tim, poetit Aliriza Gashi (1945-1997)

"S" MUND TA MOHOSH POPULLIN TIM!"

Nga Agim Vinca



shtyp, në radio dhe në televizionin e atjeshëm.

Njëri nga ata që iu gëzua më së shumti këtij prezantimi ishte pa dyshim poeti Aliriza Gashi, jo vetëm pse ishte njëri nga recensentët e librit, por edhe pse përmes tij flisnin vëllezërit e tij poetë të një gjaku. Mirëpo, në atë kohë kërkohej që prezantimet letrare të bëheshin sipas çelësit regional (pra poezia e Kosovës, ku pos poetëve shqiptarë, duhej futur edhe serbë, malazet, turq etj.). Këso "antologjish" të poezisë shqipe (me Darinkën, Zllatanoviçin e Kostiqin brenda) patën hartuar edhe disa "dinjitarë" tanë të sotëm.¹ *Scripta manent...* Kështu qe prezantuar poezia shqipe në Mbrëmjet e Poezisë në Strugë dhe në Takimet poetike të Pivës në Mal të Zi, sikundër edhe në shumë manifestime të tjera letrare anembanë Jugosllavisë së atëhershme. Mu për këtë, pa kaluar shumë kohë, lidhur me prezantimin e poezisë shqipe në Sarajevë, pati edhe reagime negative, ndërsa për librin u zhvillua një polemikë e rreptë në shtyp. Ishte koha kur, pas ardhjes së Millosheviçit në krye të KQ të LK të Serbisë, pati shkallëzuar fushata e tërbuar antishqiptare; kur në Kosovë qe kurdisur e ashtuquajtura "afëra Martinoviç",² kurse 40 letrarë serbë e malazet nga Kosova (në mesin e tyre edhe ndonjë mysliman), të dirigjuar nga Beogradi e "Francuska 7"³, patën dalë para opinionit jugosllav me një letër në të cilën derdhnin lotë krokodili për "diskriminimin" e tyre nga shqiptarët. Në takimin e kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë, që u mbajt ato ditë në Lubjanë, disa nga nënshkruesit e kësaj letre (Petar Sariq, Darinka Jevriq etj.), në mesin

¹ "Dinjitarët" që kanë bërë antologji të përziera: Vehap Shita, Hasan Mekuli, Ibrahim Rugova.

² "Afera Martinoviç", një pederast serb nga Gjilani, që lëndoi veten me shishe në arë dhe tha se këtë ia kishin bërë shqiptarët (akuzë e rëndë). E vërteta doli në sheh, por serbët e morën në Beograd dhe e shpallën "shenj".

³ Në rrugën "Francuska 7" në Beograd gjendej selia e Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë.

iu përgjigjur vërejtjes së oponentit të tij se ai i quan shqiptarët në Jugosllavi *popull* (narod) e jo *kombësi* (narodnost), në replikën e tij të dytë, me titull "Kolonelit ka kush t'i shkruajë" ("Svijet", 25. IV. 1986), Gashi, me guximin e krenarinë që e karakterizonte, shkruante: "Ta mohosh popullin tim nuk mundesh. I dobët je. Edhe moralisht, edhe intelektualisht. Tekefundit, ti s'je tjetër pos pasqyrë e padronëve të tu. A nuk e sheh sa ka ardhur koha t'i ndërrosh?".

I tillë ishte Aliriza Gashi. Letërsinë e kulturën shqiptare, por edhe popullin shqiptar, ai e merrte në mbrojtje midis Sarajevës prej albanofobëve që u pengonte çdo gjë shqiptare. Si redaktor i Radio Sarajevës (programi kulturor), Alirizai kujdesej vazhdimisht për afirmimin e letërsisë shqipe. Lëshonte poezi të poetëve të njohur, bënte intervista me shkrimtarë etj. Në vitin 1988, kur marrëdhëniet kulturore midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishin plotësisht të ngrira, ai emetoi një cikël të gjerë poezish nga Moikom Zeqo (rreth njëzet sosh), të përkthyer në gjuhën boshnjake nga autori i këtyre radhëve.

Kur Bosnjën e përfshiu lufta e tmerrshme, Aliriza Gashi nuk u largua nga Sarajeva (si shumë të tjerë), por qëndroi aty. Në krye të detyrës. Kam dëgjuar se gjatë luftës është graduar si ushtarak (Gashi ishte luftarak), por nuk e di a është e vërtetë.

Diku në pranverë të vitit 1992, një të diel, më mori në telefon nga Sarajeva. Kjo qe hera e fundit që u dëgjuam bashkë. Kur e pyeta se nga fliste: nga shtëpia apo nga puna, ai m'u përgjigj: "Çfarë shtëpie! Në banesën time kanë hyrë çetnikët! Unë fle në radio. Djali më është plagosur pak, por shpëtoi (kishte vetëm një djalë - ndërhyrja ime, A. V.). Tani ata bëjnë qejf atje. Në apartamentin tim. Më së shumti më vjen keq për librat!" - më pati thënë miku im poet. Zëri i tij më vinte i largët. Si nga Hadi.

Me atë rast, miku im Aliriza më dha edhe një porosi, që s'do ta harroj kurrë, sa të jem gjallë: "Nëse kris te ju, i dashur Agim, të lutem largoji fëmijët!".

Pastaj ndodhi ajo që ndodhi. Lidhjet me Sarajevën u ndërpre në krejtësisht dhe kurrë më s'u pamë, as s'u dëgjuam.

Dy ditë para se ta merrja lajmin për vdekjen e mikut tim të shtrenjtë, poetit Aliriza Gashi, te dyert e Teatrit të Kombësive në Shkup takova aktorin dhe poetin Selman Jusufi. Më tha se të nesërmen do të niseshin për në Sarajevë me trupën e Teatrit, ku do të jepnin "Mbretin Lir" të Shekspirit. E porosita që të interesohej për Aliriza Gashin, që mundësisht edhe të takohej me të dhe t'ia përcillte të falat e mia. Më premtoi se po dhe e di se Selmani e mban fjalën.

Kur u ktheva në Prishtinë pashë në gazetë lajmin për vdekjen e tij. "Aliriza (Ali) Gashi vdiq më 17.10.1997 në Sarajevë. Familja Gashi nga Prishtina, Peja dhe Beogradi". Ç't'i thuash kësaj: parandjenjë apo rastësi? E tillë është jeta. Tragjike. Dramatike. Cinike. Ironike. Groteske. Si në teatrin e Shekspirit.

Libri me tregime “Shtegu i të Verbërve” nuk është thjesht një përmbledhje tregimesh interesante, por një dimension i thellë i letërsisë shqiptare bashkëkohore. Ndue Ukaj sjell një kombinim të shqetësimeve sociale, narracionit filozofik dhe simbolikës ekzistenciale, duke ofruar një perspektivë unike mbi individin që përballet me sfidat morale dhe strukturat shtypëse të pushtetit. Kjo vepër shpalos një botë ku humnerat e mjegullta të ndjenjave njerëzore, të shoqëruara nga dilemat ekzistenciale, e sfidojnë lexuesin të ndalet dhe të reflektojë mbi pozitën e tij në shoqëri.

Kur një vepër letrare arrin të reflektojë jo vetëm të kaluarën dhe të tashmen, por edhe të ardhmen, ajo shndërrohet në një pasqyrë ku analizohen marrëdhëniet midis individit dhe turmës, pushtetit, autoritarizmit dhe elementëve të tjerë që përbëjnë shtypjen shoqërore. Libri me tregime “Shtegu i të verbërve” i autorit Ndue Ukaj është një pasqyrë e tillë ku ilustron marrëdhënien e njeriut me autoritarizmin, pushtetin, gjithnjë duke e ruajtur distancën e mendimit të pavarur. Tema si mjegulla, dhuna, turmat dhe lidhja e individit me pushtetin trajtohen në mënyrë universale, duke bërë këtë libër një kontribut të çmuar në letërsinë moderne shqiptare.

Ndue Ukaj ka arritur të krijojë një mozaik të fuqishëm tregimesh, ku proza ndërthuret mjeshtërisht midis simbolikës dhe narrativës, duke e pasuruar atë me thellësi filozofike dhe emocionale. Përmes errësirës që mbizotëron në tregimet e tij, Ukaj rrëfen se shpresa mbetet gjithmonë një fije delikate që nuk këputet kurrë. “Shtegu i të verbërve” e fton lexuesin ta shqyrtojë kuptimin e verbërisë, jo vetëm si një paaftësi fizike, por si gjendje mendore dhe shpirtërore që flen në një krevat me frikën, manipulimin, dhe mungesën e guximit për të parë drejt të vërtetën.

Në tregimin “Shtegu i të verbërve” që e mban titullin e librit, mjegulla përdoret si metaforë e paqartësisë dhe amullisë së një shoqërie të paralizuar nga frika dhe e pavërteta. Përmes përshkrimeve të një qyteti të murme, ku banorët jetojnë të izoluar dhe të paafte për të dalluar drejtimin e duhur, Ukaj e paraqet dilemën e natyrës njerëzore, atë të përballet së individit me të vërtetën dhe përgjegjësinë e tij personale. Mjegulla te ky tregim nuk është vetëm një pengesë fizike, por simbol i ikjes nga përgjegjësia dhe veprimi. Turma, e portretizuar si një masë e verbër që ndjek një prijës pa ditur cakun e udhëtimit, nxjerr në pah sesi njeriu është i prirë të sakrifktojë individualitetin për një iluzion sigurie kolektive. Ky tension midis turmës dhe individit përbën shpirtin filozofik të librit.

Një nga aspektet më të fuqishme të tregimeve të Ukajt është trajtimi i marrëdhënies midis individit dhe pushtetit. Prijësi, që simbolizon një figurë tiranike dhe të vetëkënaqur, nga Ukaj është portretizuar si një qenie e konsumuar nga lavdia e vet. Autori e përshkruan me mjeshtëri rrugëtimin e liderit nga një njeri i zakonshëm, i ndjekur nga ambicia, në një figurë të konsumuar nga lavdia mashtruese. Në tregimet e Ukajt prijësi nuk është vetëm një tiran, por edhe një viktimë e strukturës që ka krijuar vetë. Ai është një shembull i fuqisë që humbet kuptimin kur e pren fijen që e

Mendime mbi librin me tregime “Shtegu i të verbërve”
të shkrimtarit Ndue Ukaj

Pasqyrë e marrëdhënies me autoritarizmin

Nga Gjergj Anton Filipaj

mban lidhjen me humanizmin dhe arsyen. Ukaj po ashtu e ndërton një tension të vazhdueshëm midis ndjekësve dhe liderit, duke theksuar kotësinë e ndjekjes verbale dhe humbjen e identitetit individual brenda masës. Pyetja “Ku po shkojmë?” e shtuar disa herë në tregim, e nxjerr në pah një nga temat kyçe të veprës, atë që autori e shikon si paaftësi të pushtetit për të ndaluar forcën e rrjedhës që ka krijuar vetë.

Errësira, një element i përsëritur në tregimet e Ukajt, nuk është vetëm përshkrim i atmosferës, por po ashtu e përfaqëson mungesën e qartësisë, frikën dhe shtypjen që mbizotëron jo vetëm mbi individin, por mbi shoqërinë. Por Ukaj nuk e lë lexuesin të humbasë në errësirë. Përkundrazi, ai ofron momente dritë, duke treguar se edhe në kohët më të errëta, ekziston mundësia për zgjim, këndellje, dhe ndryshim.

Tregimi “Njeriu që fjeti me dritë të

ndezur” është një portret i dhimbshëm i personit të thyer nga dhuna, që mbart plagët e përjetshme të një kohe represioni. Përmes jetës së Tanush Lekës, autori Ukaj lexuesin e dërgon në një botë ku drita dhe errësira ndërthuren si simbole të shpresës dhe traumës. Errësira, dikur pjesë natyrale e jetës, bëhet për Tanushin një kujtesë e gjallë e dhunës dhe poshtëritimit. Në këtë errësirë, ai përjeton izolimin dhe humbjen e kontrollit, duke u ndarë dhunshëm nga bota njerëzore. Vendimi për të fjetur me dritë të ndezur nuk është thjesht një përpjekje për të sfiduar terrin, por një përkujtim i vazhdueshëm i dritës si mburojë ndaj kujtimeve që e ndjekin Tanushin. Ky tregim i Ukajt e përshkruan rezistencën e heshtur të një individi që i përkushtohet artit për të përballuar një realitet të dhunshëm. Plot melankoli, fati i Tanushit e përçon zërin e një kohe plot dhunë që nuk shuhet kurrë nga kujtesa.

Tregimi “Mundimet e Martirëve të



Karadaku” është një rrëfim i një kohe të humbur, ku burrat dhe gratë e Stubllës luftonin për të ruajtur identitetin e tyre në një botë që kërkonte t’i zhdukte ata. Nën hijen e Maleve të Sharrit, ata jetonin një jetë të dyfishtë: ditën si myslimanë, natën si katolikë, një ekzistencë e fshehtë laramane që i gërryente nga brenda. Kur dëgjuan për një ferman që u premtonte liri fetare, shpresa u kthye si një rreze drite në terrin e tyre të përherëshëm. Me guxim të jashtëzakonshëm, ata i shpallën beut të Gjilanit vendosmërinë e tyre për të jetuar si shqiptarë katolikë. Por për këtë akt, ata përballuan tortura, internime dhe një udhëtim të pafund drejt fushave të Anadollit, ku u përpoqën t’i nënshtroheshin një jete të re. Megjithatë, ëndrra për t’u kthyer në atdhe mbeti e pushuar. Pas dy vitesh vuajtjeje, ata u kthyen në Stubëll, duke përfaqësuar lirinë dhe ringjallur shpresën në një vend të mbushur me dhimbje, por edhe me dritë të pafundme.

Përmes një gjuhe të fuqishme dhe të narrativit të ndërtuar me saktësi, Ukaj krijon një botë ku çdo detaj ka rëndësi dhe ku lexuesi nuk mund të qëndrojë indiferent.

Libri me 15 tregime “Shtegu i të verbërve” është një reflektim mbi marrëdhëniet njerëzore me pushtetin, frikën dhe përgjegjësinë. Ndue Ukaj ka krijuar një vepër që sfidon lexuesin të mendojë përtej të zakonshmes dhe të shqyrtojë pyetjet e mëdha të ekzistencës. Duke kombinuar elemente simbolike dhe narrative me thellësi filozofike, libri përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në letërsinë shqiptare dhe e sfidon lexuesin të njohë dhe të sfidojë verbërinë, si atë individuale, ashtu edhe atë kolektive. Proza poetike dhe përshkrimet e gjalla të Ndue Ukajt krijojnë një atmosferë të ngjeshur me emocion dhe tension, ku edhe pse mbizotëron errësira, gjithmonë ekziston një mundësi për dritë dhe zgjim. “Shtegu i të verbërve” është një vepër që nuk lexohet thjesht për kënaqësi, por që përjetohet si udhëtim brenda vetes, dhe një reflektim mbi shoqërinë tonë. Është një libër që qëndron gjatë në mendje, duke ftuar lexuesin në një dialog të vazhdueshëm me veten dhe botën që e rrethon.

BOX1: Tregimet e Ndue Ukajt janë një ftesë për të reflektuar mbi gjendjen njerëzore, për të analizuar strukturat që e rrethojnë individin, për të eksploruar dimensionet e fshehura të shpirtit. Këto tregime tregojnë se letërsia, përveçse një akt krijues, është edhe një formë rezistence, hapësirë ku njeriu mund të kërkojë lirinë dhe të vërtetën.

BOX2: Proza poetike dhe përshkrimet e gjalla te libri me tregime “Shtegu i të verbërve” krijojnë një atmosferë të ngjeshur me emocion dhe tension, ku edhe pse mbizotëron errësira, gjithmonë ekziston një mundësi për dritë dhe zgjim.



Eminin, nga Damasku i Sirisë, e njihnin fare mirë të gjithë studentët banorë të konviktit, djem e vajza. I ndihmonte të gjithë. Me çfarë, do të thoni ju. Në fund të korridorit të çdo kati, ndodheshin dy qoshka: njëri për gatim, me një furnellë elektrike, ku studentët mund të gatuanin ndonjë gjë vetjake; tjetri për hekurosje, me hekurin mbi tavolinë. Bash në këtë qoshkë të dytë e njohëm Eminin qysh në ditët e para. Besoj se e merrni me mend: ai i ndihmonte të gjithë për hekurosjen – ishte mjeshtër. E kishte rrahur zanatin me kohë në një lavanderi të kryeqytetit të tij, tani kishte kapur të njëzet e pesat dhe kishte ardhur këtu në Sofie të ndiqte studimet e larta për financë. Natyrisht, me bursë, të siguruar nga ndonjë organizatë a institucion, nuk e mbaj mend mirë.

Që edhe sot e kësaj dite unë i hekuros vetë këmishat dhe pantallonat, duke mos e lodhur gruan, ia di për nder Eminin, "kursit" që kreu pranë tij. Por me të nuk më afro vetëm ky "kurs".

- Emin, - i thashë në një nga ditët e para të vitit akademik. - A e di që ti ke marrë emrin e nënës sime Eminé?

Më vështroni pak çaste me sy pyetës dhe pastaj vuri buzën në gaz:

- E paskemi një lidhje të fortë. E kam për nder.

Në qytetën nga kisha ardhur, njerëzit përdornin frazën "Bëj jemin!", kur donin të thoshin "Ma jep fjalën!", për t'u bindur për gjësendi. Nuk e di, "Emin" mbase në shqip don të thotë "Premtim".

Më pas u miqësova me të edhe pse, ndonëse në institut nuk ndiqnim të njëjtin specialitet, na bashkonte kursi i bullgarishtes tri herë në javë pasdrekeve në Universitetin e Sofies dhe rrinim të dy në të njëjtën bankë. Ishte më seriozi nga të gjithë ne të tjerët. Jo aq pse qe pesë-gjashtë vjet më i rritur në moshë, po edhe nga natyra. Mua më dukej përherë i menduar, i shqetësuar për diçka, deri në cakun e enigmës. Kur ia pata cekur një herë rrotull e rrotull se çfarë e mundonte, për shembull nëse e merrte malli për njerëzit e vet, më dha një përgjigje të thatë e të padeshifrueshme:

- Nuk kam njeri atje, jam jetim. Po kryesorja është se jetojmë në botë të ndryshme.

Ma preu shkurt dhe unë nuk e ngava më. Pata ndjesinë se bota e tij qe e ndryshme, jo vetëm nga ajo e vendësve këtu, por edhe nga bota e të tjerëve të kursit të gjuhës – për shembull, nga bota e Halinës polake fjalëpake, që studionte për agronomi; apo e vietnamezes Zung, e cila qe martuar me një mjek bullgar gjatë qëndrimit të tij me punë në një spital në Vietnam, e së cilës pedagogia e gjuhës gjithmonë i drejtohej me "Húbava Zung" – "Bukuroshja Zung," sepse vërtet ashtu qe, përrí, dhe ne të gjithë ashtu i drejtoheshim. Ndryshe qe puna me sudanezin Gallaballá, me të cilin rrinte shpesh dhe flisnin në frengjisht.

Eminin ishte sirian i veçantë për mua edhe sepse e krahasoja me një tjetër sirian – me Muhamedin, që e kisha në kursin tim. Ky ishte djali i gjatë, më ezmer e shumë më i hijshëm se Eminin. Ndiqte studimet për herë të tretë në të njëjtin vit – vitin e parë, sepse nuk i merrte provimet. Muhamedin e gjuanin gjermankat bjonde të Akademisë së Mjekësisë, sepse aso kohe nga Gjermania Lindore vinin në Sofie shumë studentë për të ndjekur lëndët e përgjithshme e për t'u specializuar më pas në vendin e tyre. Asokohe Gjermania Lindore kishte nevoja të ngutshme për mjekë, sepse i iknin në Gjermaninë Perëndimore. Muhamedi edhe pushimet e verës, sikundër na thoshte vetë, i kishte kaluar në Gjermaninë Lindore, me të dashurën e vet. Për të flitej se qe nipi i një njeriu me pozitë në Siri.

Ndërkaq, Muhamedin e hijshëm të kursit tim dhe Eminin serioz të financës kurrë nuk i pata parë të qëndronin bashkë, sikundër shpesh mblidheshin studentët sirianë me njëri-tjetrin.

Eminin m'u duk tepër i veçantë sidomos një ditë nëntori.

Qemë ulur të gjithë në ndenjësjet tona dhe prisnim të hynte pedagogia e bullgarishtes. Gjithmonë e prisnim me kënaqësi, sepse qe e qeshur dhe mbahej

Abdurrahim Myftiu

Eminin Tregim



shumë bukur, si mesogrua që qe: gjithmonë fytyrë-zbukuar me shije, e veshur hijshëm, gjithmonë tërheqëse për të gjithë. E zonja si pedagoge – po e po.

U vonua. Nuk kishte ndodhur ndonjëherë tjetër gjatë atyre dy muajve, qysh nga fillimi i tetorit.

Dhe kur hyri, hyri me sytë rrëmbushur lotësh.

La çantën mbi tavolinë, u ul si me përtesë, vuri bërrylat dhe zuri fytyrën e hijshme me duar.

Polakja Halina dhe e bukura Zung u ngritën dhe i vajtën pranë për ta pyetur mos kërkonte ndihmë. U kthen menjëherë në vend sapo pedagogia lëshoi duart poshtë dhe na u drejtua të gjithëve me lot në sy:

- Nuk e keni marrë vesh? Sot vdiq Zherar Filipi. Në punë e sipër.

Tha këto dhe u mundua të terte lotët me cepin e shamisë e të kalonte atë çast të rëndë për të.

Ne vështruam njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme. Doemos na erdhi keq. Mit i kinemasë së viteve '50. Edhe unë kisha parë "Fanfan Tulipanin" e tij apo "Aventurat e Til Ulenshpigelit." Por nuk u përplotëm si gruaja e hijshme para nesh.

- A mos është franceze kjo, - më pyeti në vesh me zë të pakët Eminin.

- Nuk e besoj. Po qan për një artist në kulmin e karrierës. I ri në moshë.

Moshën nuk ia dija. Vazhduam mësimin me vëmendje të shpërqendruar. Çka mund ta them me siguri për veten e për Eminin. Mua ma shpërqendronte vëmendjen Zherar Filipi i gjorë, nëpërmjet skenave nga filmat e tij, që i kisha parë disa herë. Eminin – nuk e di, por edhe ai se ç'pati, sepse mezi e dëgjoi nja dy herë pedagogen, kur iu drejtua me pyetjen e radhës. Kthente kryet mbrapa dhe këmbente vështrime me sudanezin.

Po edhe të tjerët qenë si të çakërdisur. - Me sa shoh, ju paska prekur lajmi që ju dhashë. E mora vesh pak përpara se të nisesha nga shtëpia për këtu. Artist i madh. 37 vjeç!

Lotët ia njomën faqet e lyera rozë përsëri dhe përsëri qiti nga çanta shaminë e dorës.

- Edhe mua më vjen keq, - më tha me zë të ulët Eminin, pas këtij komenti të pedagoges. - Mirëpo kësaj, me këtë lumë lotësh, sikur i ka vdekur fëmija i vet.

Në majë të gjuhës mbajta fjalët: "Zemër gruajë".

- Mbase duhet ta mirëkuptojmë pedagogen, - i thashë me zë të ulët. - Më fal, sepse duket sikur po të bëj moral...

- Unë e mirëkuptoj atë dhe shumë të tjerë, or mik. Jetojmë në botë të ndryshme... Megjithatë, - shtoi pas pak, - të gjithë në një varkë jemi... Gadishulli arabik, nga vij unë, është shumë larg nga disa kontinente, edhe nga Europa. Por nuk është edhe aq larg nga Ballkani...

- Afër jemi, - e ndërpreva.

- Jo, jo. Nuk e kisha fjalën te gjeografia. Arabia dhe Ballkani, të dy kanë bërë pjesë në perandori të fuqishme. Ballkani nën Perandorinë Osmane, edhe Arabia nën

të Siria qe qenë vilajet qysh në shekullin XVI. Pas Luftës së Parë Botërore e deri sa u shpall pavarësia më 1941 kemi qenë nën perandori të tjera, francezët dhe britanikët...

- Tashmë... - desha ta kundërshtoj.

- Kolonitë nuk janë më, por kanë lënë pas diktatorë, - më ndërpreu, duke më vështruar thellë në sy.

Dhe priti nga unë që të vazhdoja. Me sa duket, kishte dëshirë të zbrazej.

Por e lashë me aq. Sepse Eminin ishte shumë më i përgatitur se unë në biseda të tilla, po edhe sepse pedagogia po na vështronte me sy qortues.

Ndonëse orët e mësimin, që nga fillimi, nuk po shkonin me rregullsinë e zakonshme.

Ishin orë mësimi nën shenjën e vdekjes në moshë të re të një aktori të madh.

Dhe lajmin e keq na e kishte dhënë ajo vetë. Ishte e vetëdijshme për këtë.

Kaloi muaji dhe para Vitit të Ri patëm mësimin e fundit me pedagogen. Por jo takimin e fundit.

Takimin e fundit do ta kishim më 2 janar – na kishte ftuar për drekë në shtëpinë e saj. Do ta festonim Vitin e Ri së bashku.

- Çfarë do t'i shpiem, - më pyeti Eminin disa ditë para Vitit të Ri.

- Nuk e di, mbase një tufë me lule, - e shpika aty për aty.

- Unë, atëhere, po i blej një lule në vazo. Se shumica, besoj, lule kanë për t'i dhuruar.

Dhe ashtu ndodhi vërtet. Kur qemë ulur të gjithë rreth tryezës së drekës, i numërova, bëheshim rreth njëzet e tre veta, dy kurse të saj bashkë. Shumica e kursit tjetër qenë arabë e afrikanë, ndryshe nga yni, ku arab kishim vetëm Eminin. Plot tufa me lule. Unë vetë pata ndërruar mendim. Në vend të luleve, i solla një album me fotografi të një gjermanolindori, që kishte qenë në Shqipëri. Albumi qe shtypur bukur në vendin e tij dhe ia vlene si kujtim për pedagogen. Mora me vete edhe një trastë të vogël me portokaj Shqipërie dhe një shishe konjak. Atë muaj dhjetori, në Sofje bëhej një veprimtari sportive ballkanike dhe Tushi, përgjegjësi i dikurshëm i librarisë, ku pata punuar si shitës, kishte gjetur një të njohur dhe i kishte bërë havalë për mua një trastë plot: ullinj, një shishe vaj ulliri, dy shishe konjak Korçe, tre kilogramë portokaj. E dinte miku i hershëm se këto nuk bëheshin në Bullgari.

Shtëpia e pedagoges sonë qe në një rrugë me emrin e një gjenerali rus të periudhës cariste, në një pallat të ri. Apartament i bollshëm, ndonëse, për të vendosur tavolinat për aq veta sa ishim ne, i ishte dashur të hapte dyert prej xhami nga kalohej për në dhomën tjetër.

Na priti vetë.

- Burrat e shtëpisë nuk i kam sot. Bashkëshorti ka vajtur në një drekë me kolegët, kurse djalin e pres të vijë, e kam ushtar.

Aq më mirë për ne, mendova. Ata nuk i njihnim, kurse me zonjën e shtëpisë tashmë qemë mësuar dhe mund të bisedonim pa teklif.

Tryezën e kishte përgatitur të bollshme. Raki, verë e birra dhe meze të ftohta. Më bënë përshtypje dy gjëra: nuk mungonte llukanka, sallami i shtrenjtë i cilësisë së parë, që atëherë kushtonte 23 leva kilogrami e mezi gjendej. Me 23 leva mund të haje disa ditë mëngjes, drekë e darkë. Nuk mungonin as portokajtë, por qenë me këtë – vetëm nja pesë-gjashtë kokrra.

Për fat, edhe mua më patën mbetur nja pesë a gjashtë kokrra. Dy shokët e dhomës, bullgarë, kishin vajtur nëpër shtëpitë e tyre jashtë Sofies.

- Ku i paske gjetur, - më pyeti pedagogia, sapo i pa.

- Kismetit juaj. M'i prunë nga Shqipëria. Ajo deshi t'i vinte në tryezë, pranë frutierës me portokajt e saj.

- Jo, këto janë për familjen, - e kundërshtova, - kanë bërë rrugë të gjatë deri këtu. Dhe ia rrëfeva sesi.

Gjatë drekës, sa herë që ngrihej dollia, ajo ia përmendte dhuratën që i kishte sjellë studentin në fjalë dhe e falënderonte. Mua më përmendi edhe albumin, edhe portokajt. Eminin i përmendi vazon, si dhuratë të veçantë, lulet e së cilës rrojnë më gjatë se ato të një buqete të zakonshme.

Po e kalonim për bukuri. Gruaja e shtëpisë na pyeste të gjithëve si i kremtonim festat në vendet tona. Jo vetëm për Vitin e Ri, por edhe për festat fetare e të tjera tradicionale. Dhe tamam kur Gallaballai po rrefente diçka për Sudanin, ra zilja e derës. Pas pak në dhomë hyri ushtari, djali i shtëpisë. Na dha dorën të gjithëve dhe pastaj kaloi në dhomën e tij. Për t'u ndërruar, mendova, e pastaj për t'u ulur bashkë me ne.

Mirëpo ai, pasi kishte bërë dush e qe ndërruar rrobash, thirri të jëmën në dhomën tjetër dhe pas pak erdhi e na përshëndeti të gjithëve me dorë me një "Mirupafshim" dhe doli nga shtëpia, i përcjellë nga e ëma.

Ajo u kthye buzagaz në vendin e saj dhe, po buzagaz, na u drejtua:

- Nuk e di a e keni dëgjuar një fjalë të urtë: "Ushtari vdes symbyllur e gojëhapur."

Unë për vete nuk e kisha dëgjuar. Po u kuptua menjëherë prej të gjithëve: "Ushtari nuk ngopet me gjumë e me bukë asnjëherë."

- Do ta falni, im bir e ka lënë ta festojë në qytet me shokët e repartit. U kanë dhënë leje.

Më duhet t'ju them se asokohe, djemtë, si mbaronin shkollën e mesme, nuk vazhdonin drejtpërdrejt studimet e larta. Ata doemos duhet të kryenin një vit shërbim ushtarak e pastaj të jepnin provimet e konkursit për t'u pranuar si studentë në këtë apo atë degë. Ndryshe qe puna me vajzat. Ato konkurronin menjëherë pas marrjes së maturës. Ndërkaq, gjatë vitit në ushtri, djemtë kishin dy të mira: shërbimin ushtarak e kryenin në rrethin ku banonin, kurse në orarin e veprimeve në repart parashiheshin orë studimi për t'u përgatitur për provimet e konkursit.

- Ushtari doli, - vijoi duke qeshur pedagogia. - Ju disa herë ngritët doli për familjen time. Edhe për djalin ushtar. Deri tani unë ju kam uruar shëndet e sukses në studimet tuaja. Tani më lejoni të ngre edhe dy doli të tjera: Njërin, për familjet tuaja kudo që janë. Tjetrën, dua ta pimë për paqen në botë, për një botë pa luftë.

Qenë doli të ngritura në mënyrë solemne, sidomos kjo e dyta për paqen. Zëri i pedagoges na erdhi në veshë, me të dridhura. Unë e mirëkuptova, ishte zë nëne – ajo kishte parasysh edhe djalin e saj.

Mirëpo pashë se Eminin pranë meje e ngriti gotën si me përtesë. Madje, duke vështruar kuptimplotë Gallaballanë dhe ata të kursit tjetër. Më pas, toni i bisedave erdhi duke u ngritur, sidomos nga shumica – ju thashë më parë se shumica rreth tryezave qenë arabë e afrikanë. Jo vetëm toni, por edhe dëshira për të folur në gjuhët e veta. E vetmja gjë, që dukej sheshit për ne të tjerët, qe pakënaqësia e tyre në sy e në gjeste. Më potërxhinj qenë ata që nuk i njihja. Eminin po ziente përbrenda, por nuk fliste. As Gallaballai. Kurse e zonja e shtëpisë po e ndiente veten në siklet. Çka nuk merrej vesh nga gjuhët e panjohura, merrej vesh nga gjestet njerëzore, të njohura për të gjithë.

- Si është puna? - m'u dha ta pyes Eminin.

Po ai as më vështroi në sy dhe as nuk foli.

Nuk e zgjata.

- Duan ta kundërshtojnë pedagogen, - m'u afrua te veshi pas një minuti. - Ajo e don paqen për djalin e saj. Ka të drejtë. Ajo e ndien veten të lirë. Por shumica e atyre, që duan ta kundërshtojnë, nuk e ndiejnë veten të lirë. Duan liri në vendet e tyre. Si ta fitojnë? Me paqen, që kërkon ajo? Me paqen mua më kanë vlarë babain, nënën, motrën. Kudo kolonizatorët kanë lënë litarin jashtë. Mirëpo, i thashë edhe Gallaballait, këtu nuk është vendi dhe koha për të bërë debat. Na ka ftuar për drekë dhe për festë.

Emini qe i mërziur. Protestën e mbante përbrenda. Por përbrenda ajo të mundon më shumë. E mirëkuptova - ai qe aq i pjekur sa të mos e shkelte etikën me pedagogen. Disa të tjerë, sikundër themi ne nga anët tona, qenë gati "të krisnin si pushkë jevgu". Punë temperamenti.

Por jo vetëm temperamenti. Emini i kishin pasë burgosur babain, i cili nuk qe kthyer më dhe i biri as nuk e dinte ku e kishte varrin. I kishin vlarë nënën dhe motrën. Vetë, mbetur jetim qysh në moshën katër vjeç. Para se të vinte këtu, ngaqë merrej me veprimtari ilegale kundër pushtetit, kishte humbur dhe të dashurën. Në shpirt i ziente urrejtja për padrejtësitë dhe për mungesën e lirisë. Për të, paqja e pedagoges nuk qe rruga për ta shuar këtë urrejtje.

Megjithatë, erdhi një çast kur Emini u ngrit.

Atbotë rreth tryezës u nder një heshtje e thellë.

Nuk hapi gojë menjëherë. Dukej sheshit se donte t'i peshonte mirë fjalët.

- Me leje të zonjës së shtëpisë, dua të them edhe unë një fjalë. Jo vetëm për ta falënderuar për mundimin dhe durimin tek na mësonte gjuhën, për çka edhe unë kam respekt të thellë. Por dua të ngre tri dolli.

Dhe iu drejtua pedagoges.

- Të parën ta pimë për djalin tuaj, ta kryejë shërbimin ushtarak me shëndet dhe të ketë sukses në konkursin për pranimin në Universitet.

Dollinë e dytë le ta pimë për këtë grupin e miqve të mi, që bënë kaq zhurmë këtu, me të drejtë e pa të drejtë. Zonjë e nderuar, jam i sigurt se do të na mirëkuptoni. Edhe ne do të donim ta pinim me qejf të madh një dolli për paqen. Por shumica jonë këtu kanë ardhur me plagë të rënda. Të pambyllura disa, dhe të pamundshme për t'u mbyllur disa të tjera. Paqja zor se do të na ndihmojë të zhdukim padrejtësitë dhe të fitojmë lirinë.

Emini bëri një pauzë pasi piu dollinë. U duk se do të vazhdonte. Pa ia ndarë sytë pedagoges.

Foli prapë, duke u munduar që t'i binte shkurt.

- E dashur profesoreshë, të na besoni, ne i kuptojmë mirë ndjenjat tuaja si nënë. Mua nuk më harrohet ajo ditë para një muaji e ca, kur erdhët e përlotur për vdekjen e një artisti francez të shquar. Jam i sigurt se ju do të përloshet edhe për motrën time, për vrasjen e së cilës nga regjimi në vendin tim unë nuk kam patur rastin të qaj, sepse isha vetëm katër vjeç dhe nuk mora vesh gjë.

Dollinë e tretë dhe të fundit dua ta pimë për jetën, në paqe apo në luftë. Edhe ju keni të drejtë me dollinë tuaj. Sikundër edhe këta studentë të rinj, me poteren e tyre, kanë të drejtën e vet. Ne rrojim në botë të ndryshme, e dashur profesoreshë. Kjo është arsyeja...

Emini luajti vendit dhe shkoi në krye të tryezës, atje ku qëndronte më këmbë e zonja e shtëpisë, tashmë e përlotur. Iu afrua, mori një pecetë pranë pjetës së saj, i fshiu lotin, që po i shkiste faqes së bukur rozë, dhe e përqafoi.

Të gjithë e ndien se rronin në botë të ndryshme dhe, njëkohësisht, në të njëjtën botë.



REXHEP POLISI

Klithmë pulëbardhash

Zogjtë e mallit
E braktisën
Folenë,
Flatrat e ajrit
Mbetën
Nëpër pemë...

NGAHERË...

I fshiva të gjitha
Poezitë
Që shkruajta
Për ty,
I fshiva...
Nuk lashë asnjë.
I fshiva,
Por çdo varg
Më mbeti në sy
Dhe ngaherë
Te çdo send,
Të shoh vetëm ty...

Mbrëmjeve
Ajo sodit yjet
Dhe përumbet
Në ëndërrim,
Aty dergjet
Shpirti im...

NJË KARTOLINË PËR TY

Erdh' Viti i Ri nëpër vitrina,
Tirana është stolitur gjithandej,
Në dyqane s'ka më kartolina,
Por unë për ty një do ta gjej.

Dhe do ta nis me pëllumbat e erës,
(Patjetër te ti ajo do të vijë),
Siç vijnë te unë rrahjet e zemrës,
Do të vijë te ti kjo kartolinë...

Ti do zgjohesh nga ëndërr e fjetur
Dhe do dalësh në udhë me nxitim,
Do shkosh vetmuar te parku i gjelbër
Të kërkosh atje portretin tim...

Por unë s'do të jem te stoli i vjetër,
As silueta ime nuk do të jetë aty,
Do të gjes atje veç mallin e tretur
Dhe pemët që lotojnë për ne të dy.

Ta pijmë me fund këtë gotë,
Ta pijmë trishtimin që bren.
E bukur jeta, pa lotë,
Mes kohës që ik, më s'vjen...

PUHIZË E DLIRË

Je përhumbr
Mbi shkresa...
Thua se
Kohë nuk ke
As të marrësh frymë.
Je përqëndruar
Mbi libra
Dhe nuk arrin të shohësh
As mëngjesin kur lind...
Nuk ke kohë, thua,
As për një përqafim,
Ndonëse i ndjen
Rrahjet e zemrës,
Fëshfërimën e erës
Dhe puhizën e dliurë
Në zgjim...

Ti je në udhëtim tani...
Dhe ndjej se hapat e tu
Trokasin njëlloj me
Rrahjet e zemrës sime.

PARADOKS...

I dhunuari
Rrufit kafenë e mëngjesit
Në lokalin buzë Lanës
Përhumbr në dëshpërim!
Barbarët që e dhunuan
Kanë hequr maskat
Dhe festojnë
Përballë tij me "Xhin"...

KLITHMË PULËBARDHASH

Ende e ndjej tik-takun
E rrahjeve të zemrës,
Hapat që nuk mbërritën
Asnjëherë tek unë!

Ndjej perëndimin e diellit
Si shuhet dita në Jug
Dhe këmbët vetvetiu
Më nisen për rrugë...

Një dallgë deti gjëmon
Dhimbshëm tek unë.
Klithmat e pulbardhve
Më lënë pa gjumë...

U fshih
Pasreve
Dielli,
Qielli u nxi...

As në qiell,
As në tokë
Nuk ka
Dritësi.

RE E KUQËRREMTË

Një re e kuqërremtë
Përndrit ballin tënd;
Rrotullohet në ajër
E largohet dhimbshëm
Drejt qiellit tim...
Një re e kuqërremtë
Prej kohësh
Luan lojën mistike
Dhe qesh me fatin tonë
Të ndarë më dysh...

Të pa dielli dhe u zbeh
Nga shkëlqimi që verbon.
Nga çqielet meteori re
Muzgun tim po ndriçon?!

NË PARK

Stolat rënkojnë nga pesha e viteve,
Verdhojnë gjethet e rëna të vjeshtës,
Gjurmët që lamë aty, tash kërkojnë
Ditët e blerta të harresës...

Një bli më tej hesht i vrazhdë,
As zogjtë nuk shkojnë më atje,
Era psherëtim qiellit të acartë
Me dhembje ngarkuar nëpër re.

Ti tash harruar je nëpër vite,
Nuk shkel më në park si atëherë,
Në mendje tjerr të tjera kujtime,
E shkuara s'ka më asnjë vlerë...

Vetmuar në parkun e heshtur,
Qëndroj në stol me nostalgji,
Veç gjethet e rëna në pellgjet
E vjeshtës, më bëjnë shoqëri...

Malli për ty
Shkriu dëborën,
Pritja po më rrudh.
Një tufë manushaqe
Syçkat nxorren,
E unë nxitova t'i puth...

DITA IME...

Kjo është dita ime...
Më lini ta jetoj
Ashtu siç e ndjej,
Ashtu siç më pëlqen...
Më lini në lirinë time,
Në lirinë që me mua
Dëfren.
Kjo është dita ime...
Një ditë e zjarrtë
Në dimrin e acartë,
Më lini ta jetoj
Siç dua vetë,
Pa sundues
Dhe pa heronj...

S'MUND TË HESHT

Edhe mund të mos flisja,
Të heshtja si pemët
Nën brymë
Pas rënies së gjetheve.
Edhe mund,
Por nuk mund të hesht
Kur të gjitha rrugët
M'i kanë zënë...
Furtuna në gotë
S'mund t'i shpërthejë
Mendimet,
Ndjenjat,
Ëndrrat;
As vuajtjet...
Era e marrë fryn
Brenda meje
Ditë e natë
Nga të çarat
E një mali të lartë...

Hyrje

Megjithëse Agut i vinin travaje dhe halle nga qyteti i tij, përsëri e pati marrë malli shumë për të. Jo vetëm që nuk mund të shkante më atje, por as dhe t'i afrohej sado pak. I duhej medoemos të fshihej, mbasi në qytet vazhonte gjyqi për gruan e vrasë. Akuzohej edhe Agu për këtë vrasje. Megjithëse pati mbledhur dëshmi dhe fakte të pafund se, jo vetëm nuk kishte gisht në vrasjen e gruas, por as që e njihje fare atë, madje se as dhe nuk e kishte parë kurrën e kurrës, përsëri emri i tij përmendej lart e poshtë për këtë ngjarje. Kur, një grusht njerëzish përcillnin për në vorre arkivolin e plakës që shiste sytëna, (qysh kur patën ikur gratë e qytetit dhe ajo s'ishiti dot më asgjë, u çmend nga mërzia, vuri kokën në justëk dhe s'u ngrit më nga shtrati), pra, në mortin e plakës, ishte hapur lajmi se e patën vrasë gruan e plazhit, (dhe trupin e saj e kishin gjetur fillikat tek kabinat), menjëherë dikush e kishte lajmëruar Agun që të largohej sa më parë nga qyteti, sa nuk qe vonë. I pati dalë emri si i dyshuar. Agu qe munduar me mish e me shpirt të shpjegonte se nuk dinte asgjë rreth asaj gruaje dhe vdekjes së saj. Por, kur vërtetë e ndjeu rrezikun t'i afrohej, një mesnatë të errët, ai hodhi në shpinë një çantë me libra dhe tesha, një makinë tatuazhesh, dhe i çoi fjalë të dashurës se do ta braktiste qytetin. Qe nisur për sa më larg që të ishte e mundur, atje ku të mos e njihje më askush. Madje, edhe jehona e gjyqit të mos mbërrinte dot kurrë deri atje ku do të zinte vend ai.

Qyteti i Agut qe mes malit të lartë dhe detit. Një rrypinë rrëzë. Pak shtëpi të vogla magjypësh mbledhur në lagjen e tyre. S'bënin gjë tjetër, vetëm skuqnin peshk në oborre dhe bënin muzikë me dajre e gërrnetë, dhe shkar-konin si dokerë ndonjë anije të rrallë që mbërrinte në port.

Më tutje mëhallës qenë tavernat, varkat me ngjyra, pijanecët, peshkatarët e vjetër dhe këngët e detit. Pranë portit ngrihej një bujtinë kabahe e çuditshme me aromë kripe, ku Agu s'kishte marrë vesh asnjëherë se ç'njerëz jetonin në të. Ndërtesa qe shumë e vjetër, e bërë nga një jabanxhi i largët, që pati sjellë fshetash në port një fonderi për të prerë monedha falso. Me varkë, natën, se nga i dërgonte mone-dhat, nuk merrej vesh. Me atë burrë nuk dihej fare se çu bë, nuk u pa më të dukej nëpër qytet, mbase e patën vrasë apo marrë peng. Bujtina mbeti aty, si e mallkuar, golle, e banuar më shumë prej historish të çuditshme se sa prej njerëzish, (edhe këto, po aq të çuditshëm sa vetë historitë).

Dyqanet, pothuaj të gjithë të mbyllur dhe me qepena të ndryshkura, qenë varg, bri për bri, buzë rruge. Dyqani i sendeve të vjetra. Shtësi i pasqyrave. Shtëpia e fallxhores. Shtëpia e sahateve të prishur. Njeriu që shiste medalje. Dugaja e ëndrrave, (ku përgatiteshin ëndrra për t'i parë, ashtu siç bëhen kasetat me filma). Blerësi i ditarëve. Dyqani i syve. Kthina e parjes së vijave të dorës.

Ndërsa në anën tjetër të rrugës vinin varg klubet e peshkatarëve, gjithë peshk e tym, zëra të lartë, verë dhe gënjeshtra. Tek "Klubi i kandilave", që e quanin dhe "Klubi i rrenave", peshkatarët, të dehur e çakërcejfë, megjithëse nuk patën kaluar asnjëherë ndonjë det të madh, flisnin pa pushim për piratë dhe robina. Në një qosh, atje tek arkat e shisheve boshe, krejt në hesap të vet, pinte raki dhe i binte harmonikës një udhëtar i vjetër dettrash. Pati mbetur një ditë të mallkuar me stuhi në bregun e rërës, dhe që atëherë nuk qe kthyer më kurrë në vendin e vet të largët. Bunte në një zyrë të vjetër të portit. Fytyra e tij e rreshkur kishte përherë një vragë vuajtje të madhe në të. Edhe muzika që luante, s'dukej të qe tjetër gjë veçse kjo vuajtje, të cilën e kishte kyçur brenda vetes dhe s'e ndante me askënd.

Ngjitur me portin, tashmë të mbetur krejt shkret, qe "Rruga e Kurvicave", rruga e bordellove të dikurshme, bërë enkas për marinarët që mbërrinin në port. Në ato shtëpi të rrënuara, me kasha dritarësh dhe dyer të lyera me të kuqe, akoma dalloheshin tabelat: "Shtëpia e Bushtrave", "Bordello", "Danaq", "7 Horet", "A don Kev?", "Rruspia Plakë", "Shtrati i kuq i Lavires". Emrat e bordellove thuhej se i patën vënë vetë djemtë që zotronin edhe vajzat, edhe shtëpitë.

Tutje, atje, krejt larg, shtrihej plazhi. Kështu dukej në dimër, i largët, mbasi andej nuk shkelte më asnjë këmbë njeriu. Më përtej, vilat e vogla dhe kabinat, si kuti shkrepeseje. Pak më tutje, në det, qe torra e farit, ku pati ndodhur diçka e çuditshme, e lidhur me një vrasje a magji. Përmendej nën zë një dashuri e fshehtë e rojtarit të farit, por s'dihej se çfarë, dhe nuk u tregua asnjëherë. Teksa nga ana tjetër, rrëzë malit qenë pallatet trekatesh, ku banonin punonjësit të portit dhe kapitenerisë, ndonjë mësues a mjek i transferuar dhe

MARK SIMONI

Qyteti i natës misterioze

tregim

mbetur në këtë skutë të harruar, qysh se nuk mbahej mend, si dhe ca familje të vobegta me shumë kalamaq.

Agut iu kujtua dhe posta me dy telefona. Atje ku flitej me të vdekurit, me botën përtej. Në fund të bulevardit e kishte barakën grua-ja që fliste me to, dhe u sillte porositë e tyre të gjallëve. Qe e fandaksur dhe krejt e lajuar mendsh. Bënte tërë ditën shamatë e potere me të zotin e mejhanes ngjitur me postën, mbasi ai "mblidhte vetëm horra në lokalin e tij, dhe i bënin aq shumë zhurmë asaj, sa nuk e linin të dëgjohej me ato që i pati marrë Zoti!".

Asnjë herë nuk u mor vesh dhe s'u kuptua se, nga pati dalë lajmi, që, në atë qytet buzë detit pati rënë një sëmundje e tmerrshme, që përhapej aq shpejt sa nuk i jepte askujt kohë që të shpëtonte. Kaq u desh që qytetin ta izoloni me një urdhër shteti, bash në ditët më të këqia të tij, taman atëherë kur burrat dhe djemtë patën ikur krejt, disa burgjeve, të tjerë emigrantë në dhera të largëta, ushtarë dhe zabita nën armë të ndryshme, marinarë udhëtimesh nëpër detra të pa fund, trafikantë, kontrabandistë dhe piratë. Patën mbetur në qytet vetëm gratë me fëmijët, djemtë duduma dhe teveçela, burrat e pa zot, që jeta i kishte marrë përpara, ca pleq e plaka shushka, si dhe ndonjë nëpunës i vobegët, që ishte lidhur përjetësisht pas punës, për të sosur ditët e jetës në mënyrën më të murrzëshme.

Askush nuk mund të hynte dhe të dilte dot më prej andej. Nuk mbërrinin kurrë, asnjëherë në qytet më, as posta, as libra, as gazeta, as njerëz. Megjithëse sëmundja nuk pati qenë kurrë, dhe nuk u vërtetua asnjëherë, përsëri qyteti mbeti po ashtu, i kyqyr nga rrethime zgarash hekuri, telash dhe muresh të lartë.

Derisa, krejt papritur, më në fund, për herë të parë qysh nga izolimi, në një buzëmbremje të qetë, në aksham, në molin e vogël dhe në radë, ia behën dhe mbërritën disa anije të mëdha sa gazepi, plot me marinarë, që, zbarkuan pothuajse tërë natën, duke zbritur me shkallaret e tyre të litarëve, dhe duke mbushur rrugët e qytetit. Dhe gjetën aty plot gra të bukura, tërë eph, gjithë nur e hijeshi, plot sharm, ndjellëse, të writura, që vlonin nga dalldia, fërgëllonin pa pushim, si shelgjet mbi pellgje. Anijet qëndruan në qytet tri netë të gjata. Në mëngjesin e katërt, kur doli drita, u mor vesh se gratë i kishin braktisur shtëpitë, dhe patën ikur njëherë e përgjithmonë, pas marinarëve. Qenë parë tek hipnin shkallëve me fëmijët në krahë, dhe nuk u mor vesh kurrë se nga çdetra shkuan, për të mos u kthyer kurrë më, duke lënë pas shpine portin e mjerë dhe qyqman, farin e fikur, si dhe sipërfaqen e ujit, të mbuluar me fustane, sytjena dhe të brendshme, që gratë i patën flakur dhe hedhur në det nga entuziasmi i ikjes.

Tashmë qytetit u duk se i erdhi fundi, qe vetmuar sa më s'ka dhe ishte rrënuar krejt. Pati rënë në heshtje dhe trishtim, si gjithë qytet e mallkuar. Rrugëve silleshin kot së koti ca gjytrym që luanin bixhoz, pleq të fandaksur që ndiqnin filma të kahershëm në kinemanë me sedilie të prishura, dhe që u patën dalë sustat dhe stofin ua patën brejtur minjtë. Ato ditë ca minj të mëdhenj e të çuditshëm, pushtuan portin dhe brejtën pa prà trupat e anijeve, rryjetat me goglat e kuqe, molon me dërrasa dhe bankinat e saj, kiçin, bashin dhe kuvertat, dërrasat dhe flamujtë, cimrat dhe litarët. Qe një furi e tmerrshme dhe e frikshme, me minj të mëdhenj, që shtoheshin vazhdimisht. S'merrej vesh as se nga dilnin ashtu të tërbuar, dhe as se kur do t'i vinte fundi kësaj pune.

Plaka që merrej vesh me të vdekurit thoshte tërë ditën e ditës se, minjtë qenë një mallkim ndaj peshkatarëve, që s'e linin kurrë rehat në bisedat e saj me të përtejmit. Ai grusht njerëzish që patën mbetur iu luten gruas së marrë, që të shkante në postë dhe të merrej vesh me të vdekurit, dhe t'i pyeste se si do t'i shkante falli këtij vendi të nemur dhe të pa fat.

Krejt papritur, pas pak ditësh, tek tuk nëpër qytet, filluan të duken ca shenja të imta jete. Ca truke të vogla si në teatër, që sajo-heshin vetëm e vetëm që qyteti të kishte sado pak shpresë dhe jetë, dhe të mos dukej kaq i vobegët, i heshtur dhe i vdekur. Aty këtu u shfaqën disa nga plakat dhe gratë e mbetura,

që nisën të bëjnë kukulla fëmijësh dhe të luajnë me to. I vishnin si vogëlushet, me fustanet tërë lule e ngjyra, dhe u këndonin ninulla e këngë gjithë farë soji. Rrugëve u dukën gra që patën vënë në shtat jastekë, vetëm e vetëm për tu dukur me barrë, duke i ranë lart e poshtë qytetit tërë ditën e ditës. Pastaj të tjera plaka e gra, (që vinin mbi kokë kurora lulesh dhe misesh, që frynin tollumbace me ngjyra, dhe shetisnin e i binin namazgjasë cep e në cep), filluan të luajnë me litarë dhe të bënin lodra fëmijësh. Madje, për çudi, u dëgjua se, një ditë, dikujtë i ishte bërë sikur pati dëgjuar edhe të qarën e një foshnje, që dilte nga njëra prej shtëpive. Nëpër disa dritare, u duken fustane të nderura nusesh, mbathje fëmijësh, përparëse të zeza shkollë. Siç duket po hapeshin syndyqet. Në fund të rrugës, që të çonte tek rëra e plazhit, dhe rrobaqepia e shpërgajve me të cilët do të mbështilleshin fëmijët që do të lindnin.

Aty këtu u hapën kioskat e fallit, përmbysje filxhani kafeje dhe hedhje letrash, ndërsa kinemaja lajmëroi se tashti e mbrapa do të jepte vetëm filma me pullë të kuqe. Lart e poshtë u dukën ca tavolina të mjera ku shiteshin medaljone, distingtivë. Pleq që luanin tavëll, shullaheshin në diell dhe paguanin bastet me "Mao Ce Dun", "Hero i Punës", "Medalje trimërie".

Por megjithëatë, dera e shkollës vazhdon-te të qe e mbyllur, me një shul të madh, dhe me një dry të ndryshkur, si dhe drejtori i saj, me amzën e shkollës në dorë, sillej si i marrakotur poshtë e përpjetë rrugëve të qytetit. Kurse policin e vetëm të qytetit, (me pranga në brez), e merrte gjumi dhe gërhiste me të madhe, ulur në karriken tek dera e postës, ku dhe telefoni i vetëm që ishte aty, pati vite që s'punonte.

Një paradite, ata rreth pesëdhjetë a gjashtëdhjetë vetë që patën mbetur në këtë zgëq të harruar, krejt në pikëllim e të përveuajtur, të tutluar dhe të mbledhur kruspull, përcollën për në vorreza, burrin e vetëm të qytetit që dinte të lidhte kollare. U tha se kishte plasur nga merazi dhe i pati hyrë veremi, nga që kishte vite që në derën e tij nuk pati trokitur më askush.

Në plazh kishte vite që nuk pati ardhur kush, qysh atëherë që kishte dalë lajmi dhe nami i sëmundjes. Kabinat qenë aty, boshe e të heshtura, si guacka të vogla pa perla brënda, rresht njëra pas tjetër, të lyera me bojë smalto, disa jeshile, të tjerat të kaltra. Qenë të braktisura, dyert rropateshin si xhindët, rezet kuision gjithë lëngatë si qen të sëmurë dhe dëgjoheshin deri atje larg. Kur mbërrinte vjeshta e dimri, (dhe sidomos kur binte nata), kabinat dukeshin krejt të humbura e të tretura, si të ishin në fund të botës.

Një buzë mbremje, fshehtas e nën zë, në qytet u hap fjala se në njërin nga ato kabina, krejt larg, atje në fund, pati mbërritur një grua e bukur. E vetme, fillikate, me një çadër tërë ngjyra në dorë dhe një kapele të madhe. Thuhej madje se ishte parë të lahej krejt lakuriq. Por asnjëherë nuk u mor vesh se si, grua-ja e bukur pati mundur të hyjë fshehurazi në këtë qytet të rrethuar, kësaj vjeshte të butë.

Ardhja e gruas së re jo vetëm e zgjoi nga gjumi qytetin, por edhe e turulloi, i marrakoti dhe i bëri akoma më jerm atë grusht njerëzish që patën mbetur në të. Dolën mendsh krejt. Edhe këtë histori kishin mangut ata.

Nuk iu pritej dhe nuk iu rrihej, pa shkuar ta shihnin. Ndaq që të nesërmen, ditë për ditë, dhe natë për natë, lëshoheshin për andej. Fshehtas, pa bërë zë, vjedhurazi, rrugë e pa rrugë, duke përgjuar nga pas trungjeve të pishave, gjithë ankth, me kandila karbiti në dorë, me fenerë gjithëfarë lloji, me dylbi, aparate të vjetër fotografikë, me varka të vogla nëpër bregdet, të gjithë, secili për hesap të vet, me sy të çakërryer dhe të çakërditur, të hapur jashtë mase, ia mësynin pa rreshtur plazhit dhe kabinave, atje ku mendohej se ishte grua-ja e bukur, që lahej lakuriq.

Aty këtu, qenë parë gjurmë të vogla nëpër rrëzën e lagur, dhe dukej vërtetë se grua-ja e bukur, qysh kur dilte nga deti dhe deri sa mbërrinte në kabinë, ecte vetëm në majë të gishtave. Disa kishin dëgjuar zërin e saj nëpër

natë, që këndonte ca këngë të çuditshme, me një gjuhë të pakuptimtë. Thuhej se mblidhte guacka të bukura gjithë ngjyra, dhe i linte grumbuj grumbuj nëpër plazh, për t'i marrë mbase ditën tjetër. Në breg, po ashtu, qenë parë vizatime kandilash, të bërë me ndonjë shkop, si dhe dikush nga tërë ato djem tha se, kishte gjetur një kurorë koke për femra, (të bërë me yje deti), por që askush tjetër nuk e pati parë kurorën veç atij. Pas mesnate iu bëhej se dëgjoheshin plazhit tingujt e ëmbël të një flauti, por që nuk kuptohej dhe as merrej vesh se, nga çanë vinin ato melodi dhe a ishin të gruas së bukur!? Pas ca ditësh, në mes të plazhit u gjet një balonë tabake e madhe me ngjyra, që kishte rënë dhe ishte rrëzuar siç duket një natë më parë, dhe filli i saj zgjatej pafund e shkante drejt kabinave të vogla.

Por bash atëherë, kur njerëzit po e ndienin se tashmë i qenë afruar krejt, dhe do ta gjenin patjetër kabinën ku rrinte grua-ja e bukur, dhe do të mund të shihnin hiret dhe pashinë e saj, si dhe trupin lakuriq që e lante në detë, tamam atëherë kur plakat e qytetit i patën thurur këngë gruas së hijshme, (duke e quajtur si fat i mirë që pati mbërritur më në fund në këtë qytet), atëherë ndodhi hataja. Nëpër muzg, në fillim pak ngadalë dhe me pezëm, dhe pastaj akoma më shpejt e në vaj, u hap fjala se gruan e bukur, dikush e kishte vrasë, dhe trupin i saj i pa frymë dhe jetë, qe gjetur në një nga kabinat e vetmuara, atje larg, ku dyert e vjetra me rezet e ndryshkura kuisionin si vaje.

Mbi këdo ra dhimbja e pikëllimi. Rrugëve, lart e poshtë flitej me një farë përkorje e përlulesie, me përveuajtje për atë grua, për fatin e saj të zi, për kobin e gjëmën e re që i ra përsëri qytetit. Ndjeheshin të trishtuar dhe si të zënë disi në faj, mbasi ua kishin vrasë në plazhin e tyre, në dorë të tyre. Madje kudo thuhej se, fati apo dikush tjetër, kishte vendosur që t'i trazonte përherë këto njerëz, dhe kurrë të mos i jepte gëzim këtij qyteti të mjerë dhe të vobegët.

Pyetet kudo gjithë habi se, përse duhet ta kishin vrasë, kujtë i duhej vrasja e saj, mos ishte dikush i ardhur nga shumë larg, që e kishte ndjekur, dhe pasi e pati pikasur dhe gjetur në kabinat e vetmuara, kishte shfryrë tërë mllef, gjithë dufin, urrejtjen dhe inatin mbi trupin e saj.

Ato ditë, në nderim të vdekjes së gruas së bukur, u mbyllën njëra pas tjetër; Dugaja e ëndërrave, Shtëpia e fallxhores, Dyqani i syve, Kinemaja e vjetër. Në port, në drekun e një anije, pothuaj të rrënuar dhe të mbytur gjysma me ujë, u pa flamuri i vjetër, që dikush e pati ulur në gjysëm shtizë. Ato pak gra që kishin mbetur në qytet, bënë si bënë dhe thurën ca kurora të vogla, si kurora kukullash.

Asgjë nuk po merrej vesh. Nuk dihej nëse dikush do të vinte dhe ta tërhiqte e merrte trupin e gruas së mjerë, për ta varrosur atje nga kishte ardhur, apo do të ishin pikërisht njerëzit e këtij qyteti që do kujdeseshin për varrimin. E atëherë ajo grua e bukur dhe misterioze, do të mbetej përfundimisht, do të pushonte një herë e përgjithmonë në qytetin e tyre.

Pa humbur fare kohë, u ngrit dhe një grup i vogël që do merrej me ceremoninë nëse do të qe e nevojshme. Do shkonin tek kabinat e plazhit për ta gjetur dhe sjellë në qytet, do i përgatishin një arkë vdekje, do masnin dhe qepnin një palë petka të hijshme dhe serioze për mort, dhe pastaj, nëse s'do të vinte askush nga larg për ta marrë, do e përcillnin të gjithë në vorrezën e vogël të qytetit.

Në komision qenë: drejtori i shkollës, një pensionist që pati shkruar gjithë jetën regjisttrat e gjendjes civile, polici i vetëm i qytetit, si dhe kapterri i harruar i kapitenerisë, që merrte në të rrallë ndonjë fonogram apo radiogram, të ardhur nga larg. Ky grup, në një farë mënyre, do të mblidhte edhe ndonjë shenjë a fjalë e denoncim, si dhe do të hetonte ndonjë akt që kishte të bënte me vrasjen e gruas. Madje për këto të katërt, u vendos nga të gjithë, që, do të ishin dhe juria e gjyqit të vrasësit, nëse vertetohej se gruan e pati vrasë ndonjëri nga banorët e qytetit.

Në qendër të qytetit, (atje ku dikur vendoseshin lajmërimet e rëndësishme si dhe reklamat e kinemasë), komisioni vendosi lajmërimin e vdekjes, por pa emër, pa foto, pa moshë, pa orë dhe datë varrimi. Poshtë, në qosh të lajmërimit qenë me rradhë emrat e anëtarëve të komisionit, që do merrej me çdo shërbim të nevojshëm të funeralit.

Dhe bash atëherë kur po bëheshin të gjitha përpjekjet për ta gjetur trupin e mjerë të gruas, kur po organizoheshin njëri pas tjetrit detajet e ceremonisë së mundëshme, krejt pa prituri dhe pa menduar, në mes të habisë dhe ankthit, në mes të turmës së madhe të njerëzve, njëri prej djemëve të qytetit, tha, pa u dridhur fare, me një zë të fortë e kumbues, me mburrje dhe krenari se, vrasësi i asaj gruaje qe

vetë ai, po, po, ai e kishte vuarë gruan e bukur. Tha, se, pati bërë dashuri gjithë natën e natës me të, atje në plazhin e largët, mbi një velenxë shtrirë në rrëzë, gjithë dalldi, epsh, kënaqësi, tërbim. Dhe, vetëm atëherë kur po afrohej mëngjesi, ai tha se, ajo kishte kërkuar të ikte, të fshihej në kabinën e saj, sa pa e parë njeri. Djali e pati mbajtur me zor sa kishte mundur, por kur ajo i kish shpëtuar dhe pati vrapuar që të fshihej sa më shpejt, ai e kishte qëlluar me thikë, pak nën gjirin e majtë. Tregoi se ajo pas pak, pati dhënë shpirt.

Pas dy ditësh u shpall gjyqi. Do mbahej në kinemanë rrangalle. Juria gjyqësore nuk kishte nevojë fare as për ekspertizë, as për laborator shkencor, as për fotografi të vendit të ngjarjes, madje as dhe për polic që të shokonte vrasësin, mbasi ai jo vetëm që e kishte deklaruar dhe e pati pranuar vetë vrasjen, por po vinte dhe me këmbët e veta drejt e në gjyq, i qetë, dalëngadalë, vetëm fillikat, për tu ulur në bankën e të akuzuarve. Ai djali që një prej djemëve më të shkathët dhe gangsterë të qytetit, që sillej vara vingo tërë kohën rrugëve lart e poshtë, me motorrin e tij Gilera. Askush në qytet nuk e kishte kuptuar asnjëherë se si, pikërisht ky djali kaq hashari dhe i lëvizshëm, nuk e kishte braktisur kurrë qytetin, në një kohë që nuk pati mbetur gjytrym dhe rroskop pa ikur dhe zhdukur prej aty. Përshpërëtejt nën zë, se dikur, mbase ndonjëra nga gratë e bukur, si dhe dashuria për të, e pati mbajtur djalin lidhur me këtë qytet.

Dhe ja tani po vinte, serbes, me një shikim të përgjendur larg, krenar, i veshur bukur, i vetëdijshëm në ardhjen e tij, për të mbërritur drejt e në gjyqin që mund t'i hante kokën. Tek kinemaja ku do të mbahej gjyqi, qysh herët, akoma pa u hapur dyert, patën mbërritur të gjithë.

Djali tregoi shumë gjatë dhe me gjithë detaje se, si kishin bërë dashuri me gruan e bukur, foli për fytyrën e saj të hijshme, gjithë nur dhe sharm, (duke dhënë detaje për portretin e gruas së bukur), dhe pastaj, kur erdhi çasti të rrëfente se si pati ndodhur vrasja, i ra fare shkurt, shpejt e shpejt, me ca fjali si belbëzime, pa ndonjë detaj konkret, në mënyrë krejt të vakët e të turbullt. Dhe e mbylli duke thënë se, kjo qe e gjitha, dhe nuk kishte çfarë të tregonte tjetër. Pastaj, pa u ulur, u kujtua dhe shtoi se, këtë e dinte dhe miku i tij Agu, por që ai s'kishte fare dorë në këtë vrasje.

Trupi gjykues kërkoi dy ditë kohë që të vendoste dënimin. Djali i vunë prangat e ndryshkura të policit dhe e dërguan tek hapsaneja e vjetër me muret krejt lagështirë, përtej "Rrugës së Kurvicave", tek një magazinë e braktisur. Dhe kur i gjithë qyteti priste në ankth dhe me kuriozitet ato dy ditë vendimin e jurisë gjyqësore, nuk u mor vesh se nga erdhi dhe ia behu një lajm krejt i qytitshëm. U tha se njëri prej burrave të qytetit, një qyqman, pati pranuar me të madhe se, "Atë gruan si drita nuk e pati vuarë aspak djali, dhe se ai gën-jente, por e kishte vuarë bash me dorën e vet ky burrë, mbasi pati bërë dashuri gjithë natën me atë grua".

Edhe burri tregoi në gjyq shumë gjatë për natën e dashurisë, por në mënyrë pak të zbehët në detaje, pa shumë elemente dhe entuziasëm. Pastaj tregoi se sa e hijshme ishte ajo grua, duke përshkruar me imtësi tiparet e saj, një e nga një. Dhe në fund tha me pak fjalë që, ai, dora vetë, e pati goditur gruan me një thikë, dhe me kaq e mbylli. Juria e pyeti përsëri për portretin e gruas së bukur, dhe burri bëri pothuaj të njëjtin përshkrim siç e pati treguar dhe djali në gjyqin e parë. Pastaj, disi i nervozuar, duke u dridhur dhe duke tundur gishtin, kërkoi me forcë që, djali i burgosur më parë, së bashkë me shokun i tij Agun nuk kishin fare lidhje me vrasjen. Madje ata të dy donin t'ia përvetsonin dhe merrnin ngjarjen e dashurisë që ky burrë pati bërë me gruan e bukur. Anëtarët e jurisë u panë gjatë sy në sy. Pastaj dhe atë e degdisën në hapsanën e vjetër, tek burgu i magazinave të braktisura dhe gjithë lagështirë.

Kur pastaj, ditë pas dite, një i tretë, më vonë edhe një i katërt, edhe një i pestë, edhe një i gjashtë, kërkuan të njiheshin si vrasësit e gruas së bukur, trupi gjykues u bllokua dhe i vënë në një siklet të pa parë, menjëherë lajmëroi se, do duhej një kohë e gjatë për të gjetur të vërtetën dhe për t'i dhënë dënimin, vetëm dhe vetëm atij që e meritonte.

Kapterri i radjos kishte gati dy vite që jetonte i vetmuar në zyrat e kapitenerisë së portit të rrënuar, ku në tarracë qenë akoma antenat e rrëzuara, të ndryshkura dhe të këputura prej kohësh, që prisnin më kot ndonjë sinjal a lajm me radio për portin, ndonjë radiogram apo fonogram, ndonjë cingrimë taste që shkruante shirita të koduar me alfabetin Mors. Dhe bash atëherë kur kapterri po hiqte dorë nga pritja, dhe po e linte punën njëherë e përgjithmonë,

(mbasi qe lodhur tepër nga ajo heshtje e gjatë e aparaturore, ishte plakur nga braktisja e sinjaleve, qe mërziur prej shkallimit të portit), pra bash në atë ditë, në fillim dalëngadalë, avash dhe me përtesë, pastaj më me ngulm dhe insistim, rruli i letrës së radiogramave me gjilpërën sipër, filluan të sillen dhe të bënin atë gërvimën e zakonshme të shkrimit. Kapterri u afrua dhe u përlot nga malli, teksa letra vazhdonte të mbushej me shenja dhe fjalë. Ndenji në këmbë, para aparatit, krejt gatitu, në formë ceremoniale, i emocionuar sikur ta kishte për herë të parë, dhe priti aty, i heshtur, i mbytur në djersë, solemnisht, deri sa u shkrua dhe fjala e fundit. Mbasi mbaroi e tëra dhe e mori vesh se i drejtohej personalisht Kryetarit të gjyqit, drejtorit të shkollës, kapterri e mbështolli letrën ngadalë, e futi me kujdes në një zarf të vjetër, njollosur me një hartë lagështirë në cep, dhe u nis si në paradë, për tek shtëpia ku do ta dorëzonte.

I dashur profesori im. Jam Agu. Dëshiroj të jeni mirë.

I kam marrë vesh të gjitha, me detaje, se çfarë ka ndodhur atje. Kam mësuar për atë grua që paska ardhur në plazh. Më kanë thënë dhe për njerëzit që shkonin për ta përgjuar dhe gjetur këtë të panjohur, kam dëgjuar dhe për vrasjen e papritur të saj, për gjyqet, si dhe për emrin tim që është përmendur disa herë, madje edhe jam akuzuar.

Nuk po iu shkruaj thjeshtë për vete, aspak sa për të shpëtuar nga ky mëkat, sa për tu liruar nga akuzat që më janë bërë. Jo. Po iu shkruaj me besimin e madh që do të më kuptoni akoma më gjërë, dhe patjetër keni për të më dhënë të drejtë.

Nuk është puna se, a u vra ajo grua e largët, dhe nga kush dhe përse u vra? Jo. Por së pari duhet të mësojmë se, a ka ardhur vërtetë ndonjëherë në plazh kjo grua që në paska qenë edhe e bukur, a ka shëtitur ajo mbrëmjeve nëpër rrëzë, a është larë fare lakuriq në det? Dhe aq më tepër, nëse gruaja e bukur nuk ka qenë askund, asnjë çast, kurrësesi, atëherë ajo gruaja nuk ka patur mundësi as dhe të vritej. Sepse, ua them me bindje se, ajo grua nuk ka ekzistuar, kurrëfare, asnjëherë. Ajo femër është thjeshtë një imazh dhe vegim i prodhuar nga mendjet e debulta të njerëzve, nga nevoja që qyteti të kishte modelin e gruas së bukur, mbasi gratë e tij të hijshme e patën braktisur atë vend, njëherë e përgjithmonë, duke e lënë bosh dhe krejt shkret.

Prandaj mendja e tyre e kapluar nga dëshira, e donte dhe i nevojitej ajo grua, madje iu duhej edhe "të bukur", sepse pikërisht bukuria e saj do të zgjonte tek ata dëshira të forta, do t'i ngrinte nga përgjumja dhe do t'iu tundonte pjesën substanciale të grishjeve shpirtore.

Atyre njerëzve iu duhej patjetër, medeomos ideja fikse se ajo grua ekziston, është në qytet, madje është dhe krejt e bukur, që edhe i tundon me lakuriqsinë e saj, edhe bën naze tek ecën në plazh, edhe është gjithë ledhe dhe tunduese, sepse burrat e atij qyteti janë të frustruar, pa jetë dashurore, me një prej mangësive më të mëdha që mund të provojë njeriu. Dhe kjo turulllojë e njerëzve, atje është fanepsje kolektive, mbasi kanë ikur gjithë gratë e qytetit, dhe burrat kanë mbetur pa to. Ndaj që të gjithë, duke qenë në të njëjtin fat mungese, pushtohen nga sugjestionin dhe hipnoza kolektive, dhe nisin e besojnë të gjithë njëherësh, se ajo grua ekziston, dhe nisen për ta gjetur imazhin që kanë brenda kokave të tyre, atë imazh të prodhuar prej gjendjeve sugjestive dhe nga entuziasmi. Truri i tyre i kapluar dhe i marrakotur, prodhon dëshira dhe realitete të turbullta, impresionohet nga fjalët lart e poshtë, duke u manipuluar në atë masë sa ta besojë si gjënë më të vërtetë ardhjen e gruas në plazh. Ata e hyjnizojnë imazhin e fantazisë së tyre të prodhuar nga sugjestionin, të manipuluar nga dëshira dhe dufet e tyre të brendshme, që janë të kyqyra atje në ndërgjegjen e tyre me-mecë. Gjithë kjo përiuadhe e mbyllyes së qytetit, e ikjes së beftë të grave me marinarët, ka prodhuar tek njerëzit e qytetit tonë pasiguri, frikra, dufe, mllëfe, inate, zemrime, paqartësi, prandaj tek ata njerëz, befasi si shpëtim, janë zgjuar instiktet e mbrojtjes, dhe në kushte të tilla njeriu prodhon idole ku të mbështesë ndërgjegjen, dhe me të krijojë ekuilibra.

Ju profesori im, mbase tashti po mendoni se përse janë gjashtë vetë në qytet, që jo vetëm e pranojnë se e kanë vuarë gruan e bukur, por insistojnë me këmbëngulje se secili prej tyre është vrasësi i vetëm dhe i vërtetë. Pra ata edhe e paskan takuar, dhe paskan bërë dashuri me të, edhe ia kanë ndierë aromën dhe kënaqësinë trupit të saj, madje dhe na e paskan vuarë. Dhe tek e fundit, me atë insistim të përzier me një farë krenarie, ata njerëz po shkojnë ndoshta dhe drejt ndonjë dënimi fatal.

A të mundohemi të kuptojmë mënyrën e ardhjen së tyre në gjyq, dhe se si e kanë deklaruar me aq lehtësi dhe fodullek nëpër qytet protagonizmin e tyre në vrasje, dhe pastaj të analizojmë se si e kanë rrëfyer misterin e asaj nate, kur ata na paskan bërë dashuri me gruan e bukur, se si



qenkan nervozuar me të, dhe në fund mënyrën dhe arsyen se përse na e paskan vuarë?

Në një qytet të mbetur pa gra, është llogjike që, krenaria mashkullore e të bërit dashuri, mendjemadhësia e aventurave me dashnore, krekosja e sukseseve me femra, nuk ekziston më, bie fare, sepse nuk ka më gra, nuk qëndron më si mit. Ata që, tërë jetën e tyre janë mësuar me histori dashurie, me emra vajzash, me takime të fshehta, me tradhëti, me rrëfime dashurishë, tashmë në këtë shkretëtirë femrash e grashë gati sa nuk mbyten dhe asfiksohen. Madje unë mendoj se janë pikërisht këta të gjashtë që ju keni dërguar në burg, që e kanë shpikur të parët imazhin e asaj gruaje të pa qenë.

E gjithë kjo situatë krenarie i bën ata të vijnë në gjyq si gangsterë, të flasin aq gjatë për aktin e të bërit dashuri, të thonë me detaje se si shkoi ajo natë, të flasin për trupin dhe aromën e gruas së bukur, duke e bërë sa më reale aventurën tunduese të dashurisë, (që sa më shumë tregojnë, aq më shumë interesantë e krenarë e ndiejnë veten). Por të bërit dashuri është shumë universale, me detaje të njohur e të përsëritshëm tek kushdo, me detaje të ngjashëm pothuaj tek të gjithë njerëzit, mbasi në një farë mënyre të gjithë bëjnë dashuri një llo. Kurse vrasja është tjetër gjë, është një akt shumë më i rrallë, dhe i pa njohur për këdo. Ndaj ata, kur deponojnë në gjyq, (dhe pikërisht e zgjasin aq shumë të treguarit e dashurisë së asaj nate, me detaje të përgjithshme por dhe të mundshme për tu besuar), atëherë kur vjen puna të rrëfejnë mënyrën se si janë zënë dhe imazhin me gruan e bukur, dhe se si pastaj e kanë vuarë atë, të gjithë ata burra thonë fare pak fjalë, nuk kanë as realitet dhe as fantazi, dhe flasin me gjysma detajesh të montuara keq, dhe bëhen krejt të paqartë se çfarë po tregojnë. Kjo ndodh se ata nuk e njohin vrasjen siç njohin dashurinë, ndaj dhe dallohen menjëherë se, jo vetëm që nuk janë vrasës, por kuptohet në çast se dëshmia e tyre është e rrejshme.

Dhe diçka tjetër. Po të ndiqen me kujdes dhe vemendje rrëfimet e tyre, tek dëshmojnë për portretin dhe imazhin e gruas, për tiparet dhe hijeshinë së saj, ata përshkruan pothuaj janë të gjitha të njëjllotja, me karakteristika shumë të përafërta dhe të ngjashme. Kjo nuk vjen as se ata të gjashtë kanë takuar të njëjtin grua të bukur dhe dëshmojnë vertetësinë e nurit të saj. Por edhe aspak se ato kanë dëgjuar njëri pas tjetrit dëshmitë e gjyqeve të mëparshme dhe kanë mbajtur mend se çfarë është deponuar për pamjen e gruas, dhe pastaj për të qenë të besueshëm i kanë qendruar imazhit tip të saj. Jo. Portreti i gruas që ata përshkruajnë me shumë siguri, detaj pas detaji, imtësi pas imtësie, na e çon vemendjen të gjithëve tek një fytyrë shumë e njohur dhe e admiruar në qytetin tonë, dhe që na del menjëherë para syve. Ata në të vërtetë përshkruajnë modelin ideal që kanë në kokë, dhe që është pamja e mësueses së letërsisë, asaj gruas së bukur, për të cilën gjithë burrat e qytetit patën ëndërruar ta kishin të paktën një natë në shtratin e tyre, "dhe pastaj të vdisnin!". Nuri dhe hijeshia e mësueses, pamja e mrekullushme e saj, për ata të gjashtë, (dhe për tërë burrat e qytetit), është modeli tip i bukurisë, është portreti i përkryer që kanë të pikturuar në kokat e tyre.

Dhe të gjitha këto mallkime, tërë këto ngjarje tronditëse dhe të shfytëruara, e gjithë kjo çmenduri kolektive, këto patologji dhe sëmundje i kanë ardhur qytetit tonë nga izolimi, nga telat dhe muret që e rrethuan, si dhe pastaj nga braktisja dhe lënia vetëm e tij, fare bosh, pa jetë.

Ndaj ata fatkëqinj, që ju prisni të dënoni, janë fajtorë të vetes së vet, por asnjëherë as vrasës dhe as të ligj, por vetëm produkt i rrethave ku i hodhi dhe i përplasi jeta.

Këto kisha merak që tua shkruaja. Me shumë mirënjohje!

Agu

Të nesërmen, akoma pa dalë drita, njerëzit gjeten në tabelën e madhe, lajmërimin e

Gjykatës, që njoftonte se Seanca e fundit për të akuzuarit për vrasjen e gruas së bukur, do të mbahej pas dy ditësh, dhe, për të gjithë së bashku, (dhe jo veç e veç).

Salla e kinemasë së vogël qe mbushur plot. Në rradhë të parë, brij për brij me njëri tjetrin qenë gjashtë të burgosurit. Jo vetëm që atje në burgun e tyre qenë dëgjuar të ziheshin dhe të bënin sherr e shamatë, me zë të lartë, me të shara dhe gjithë britma, por edhe rrugës për në sallë, që nga magazina e vjetër gërdallë e plot lagështirë ku i patën futur, erdhën duke iu inatusur dhe duke kërcënuar njëri tjetrin. Qenë pa pranga, të vënë dy nga dy, në rresht.

Sipër, atje ku dikur kishte qenë skena me kuintat dhe me ekranin e pistë pas, qe akoma tavolina e jurisë gjyqësore. Drejtori, si kryetar gjyqi që ishte, u ngrit dhe me një letër të madhe në dorë, që i ngjante më shumë letrave rrul të fonogrameve se sa atyre zyrtare format, e nisi fjalën e jurisë gjyqësore. Drejtori, si kryetar Agu, për izolimin e qytetit, për patologjitë që ndodhin në të tilla raste, për fiksimit që iu krijohet njerëzve. Fliste me ton, krejt i qartë dhe i sigurtë, ku herë pas here i hidhte ndonjë sy letër që mbante në dorë. Deri sa e mbylli duke thënë që, mbasi asnjëherë askush nuk e pa realisht atë grua, nuk u gjet asnjë gjurmë e saj në rrëzë, asnjë rrobë a fustan a kapele në ndonjërat nga kabinat, nuk kishte në bregdet fare grumbuj guackash të mbledhura siç thonin disa, as balonë me ngjyra që përshpërëtejt nga ndonjëri se gruaja e ngrinte mbi plazhë çdo mëngjes, duke luajtur me të, nuk kemi askund as trupin e saj dhe aq më pak ndonjë thikë që e ka qëlluar atë. Atëherë pra, nga e gjithë kjo situatë, trupi gjykues nuk mund të fajsojë asnjërin nga këta burrat, ndaj dhe i shpall të gjithë të lirë dhe të pa fajshëm. Salla duartrokiti.

Në çast e kërkoi fjalën djali i motorrit, që kishte thënë i pari se qe vrasësi i gruas së bukur. Ai kundërshtoi çdo gjë të kryetarit, madje duke thënë se të gjitha ato që mohonte zotërija i gjyqit, ai i kishte të fotografuara. Dhe nxori menjëherë nga xhepi i brendshëm i xhakaventos një tufë fotografishë, duke ia sjell trupit gjykues. Dhe pasi i hapi mbi tavolinë, siç hapen letrat e bixhozit, nisi t'iu vinte gishtin secilës dhe duke treguar me zë të lartë, me rradhë, të fotografuara gjurmët e gruas, kapelën e madhe, balonën, grumbujt e guackave, madje dhe një pamje nga gjoksi i saj gjysëm i çveshur. Tek tregonte, dihaste dhe i merrej fryma nga emocioni.

Fotot aty qenë krejt bosh, pa asnjëfarë objekti në to, shkret dhe pa asnjë shenj, letra të bardha fotografie të pa stampuara fare. Drejtori i mori ngadalë dhe krejt i qetë, i bindur dhe i sigurtë që ato që pati thënë djali qenë vetëm kotësi dhe sajesa, dhe ua tregoi njëra pas tjetrës me rradhë gjithë sallës. Turma gumzhiu dhe u afrua për të parë akoma më mirë. Disa picëronin sytë, të tjerët vunë syzet për të dalluar akoma më qartë. Nga përshpërëmat e tyre u mor vesh se, ata nëpër fotografi po dallonin vërtetë diçka, trupin e gruas, rërën me guacka, ngjyrat e balonës së vogël rrëzuar në plazhin e largët, gjurmë këmbësh të vogla femrash, kapelën e madhe të saj.

Djali, kur vuri re se turma po shikonte vërtetë në foto gjërat e gruas së bukur, u mrekullua, dhe me gëzimim e tërbuar të një të çmenduri, ashtu si fituesit dhe kampionët, nisi të rrahë me pëllëmbën e madhe, me forcë gjoksin e tij.

Seanca u ndërpre. Drejtori lajmëroi dorëheqjen e tij, dhe pas një jave u mor vesh se krejt i lodhur dhe i drobitur, mrrrolur e tutluar, i përqartur dhe i dalë mendsh, i mërziur sa s'ka më, pati vënë kokën në jastek dhe pati vdekur, duke u mbunduar të shpjegonte përqart disa herë, ca gjëra që nuk u kuptuan dot, dhe që ai i mori me vete për në varr.

n'odeonin e fshehur...

thuaje dyqind palë sy e patën parë
odeonin e fshehur
në pjesën e djathtë të muzeut që shihte
nga hëna

...dhe ajo qe jetë pa frymë
se mbrëmjeve
sytë përqendroheshin diku tjetër

thuaje dymijë palë sy u hodhën nga
bronzi i pafrymë
por në logjikën e shkrepjes ajo kish mbetur
ende një vajzushkë në pije e zhveshur

vargjet e një moti që kullon lot...
(gjeneza)

mbetur kemi ç'ka patëm qenë e shkuar - e
tashme tani
me një pakuptimësi plot arsye
u kthym përditshmëri e re

gjaku na e lidhën ditën e parë
në këmbën e djathtë
me vete do ish me ne ai - veç
gjaku i detit
dhe ky ishte himni i parë që kënduam
duke mësuar se
valën do e shihnim mbi krye dita ditës
mëmësi dhembshuri

atëherë me të ecurën e rënduar në të
djathtën e paçalë
mbërritën në breg se fjala e tillë kishte
qenë kishte mbetur

prej vetes shqyem eshtrat tronditëm
gjumin nënë
nga rropullimat e barkave që mbanin erë
kockash të njoma
dhe bregu bëhej se takohej me gishtërinjtë
tanë i ftohtë
se lindja sa qe ngjizur

me kokat e zbathura të paformuara mirë
udhëtimin e pamë
të zërë gojën nga të qarat se fundi është
dhimbje

kish mbërritur bregu

gatitëm lindjen e dytë se qielli na bekoj me
lotin e hyjnie
e me të lundruam shpirtin nga udha
n'udhë se e përjetshmja
mbetet udhëtaria

në portat e njeriut trokitëm furishëm dhe
në kutinë postare
lamë një pusullë të vetme
prej gjakut që rrodhi kur vetes i shqyem
kockat

dhe ky ishte himni i dytë që kënduam se
udha për t'u nisur
qe filluar

atëherë kur era na puthi velat e virgjëra
pamë se në qytet zbardhonin
forma të pakuptimit të arsyeshme
dhe vështirë s'e patëm të kuptonim se
poezia qe lindur

dhe ky qe himni i tretë që kënduam
ndërsa mbyllim përjetësinë tonë në
majmash të ujshme

e atëherë dritë do ndriçohej...

fryma dimëake krahët m'i ka pushtuar e
atyre netëve
që dalldisem nduhmën e duhanit që
plagoset n'vete
rrekem të t'marr n'andërr përdore e n'një

REI F. HODO

Vargjet e një moti që kullon lot

Cikël me poezi



lug poezie
me t'krehë një lëmsnajë flokësh që
lëkundet prej flladit
si të ishte një foshnje e pabindur që ngji
amtar mjaltohet
ambël

e atëherë kur t'çelësh pupilat e syve e
ndoshta fare pak
turbulluar t'jesh prej një drite t'përthyer e
pabindur
ashtin e qenies tënde flatroje n'lirinë e një
melodie
që prej s'largu bie si marsh i themeluar
ndhimbe
si t'ishte një foshnje e pabindur
që ngji tëndin burrërohet duke u bërë i
bukur
edhe më duke derdhur lotët e atëherë dritë
do të ndriçohej
se përdore n'lirinë e një flladi kam një tufë
flokësh prej tuat
që bëhen pamundësi

melankoli e Adriatikut...
(në një natë me hënë të përskuqur)

qenë gjësimet e dallgëve - fizarmonikë e
pakuptimtë
duke u zhytur në përhumbjen e zisë së
natës
ato që zgjuan mërinë e gjumit të
Poseidonit

s'rreshtin as velat si jetë oktapodësh
të lumturojnë mbrëmjen e padronit të tyre
por mëkati mbi dallgën është një plagë që
plaket me njeriun
dhe ndoshta edhe pasi të vdekur vetë
njeriu
ajo ende pikon dhimbje

ranishtat supebardha zbuluar nga
pëlhurat e algave
zvetënohen në kokërriza edhe më të vogla
se frika nga zbulësia është një lindje e re
më e dhimbshme se lindja në vajzërinë e
parë
puls i gurëve rend revan në brinjën e
betontë të qytetit
njerëzit ngrënë mbi qafa mbulesat e
pendesës

heshtja e udhëve bën që i ftohti të duket i
acartë
ndonëse në motin e vjeshtës dhembja
është më e ëmbël

asgjë nuk dinë iriqët asgjë nuk dinë
gjinkallat
dhe as kënga e tyre bezdisëse asgjë nuk di
se mëkati mbi dallgën është një zemëratë
hyjnie
që e ftoh pëllëmbën e nxehtë në faqen e
shkëmbinjeve
nën molin që mban aromën e ndryshkut të
spirancave

deti është një kujtesë e pamoshë
një shembull i kujtesës së kaltër
që rrëmben nga kjo hënë e mbrëmjes
madhëstinë
dhe njerëzve u rri ballazi si një pasqyrë
ndërgjegjje
që mbrëmjeve që do të vijin
mbi qafat e zbathura të mos ngrënë jakat
e pendesës

puls i shkëmbinjeve rend revan në brinjët e
drunjta të barkave
që lartohen frikurazi mbi dallgët e mërisë
së gjumit të Poseidonit
se ushtritë e dhimbjes janë të tilla
si kjo mërzi e valëve ballë meje
këtë mbrëmje të vetmuar nëntori
melankoli e Adriatikut ti lëndesë e bukur
që fshihesh në mbretërinë e njomë të
qytetit
mbanë në duart e tua
se vargjet në stinë të tilla burrërohen

kam lindur me detin...

mot i rrënuar nga dhimbja qe ato ditë
loti i detit lëngatë e perëndisë
rëra shtrat i arlekinëve të botës përtej
nuk ngjiz një varg të ri - bëhet vjeshtake
dhe sytë e kokrrizave i pleqëron pluhuri i
hënës

loti i detit është trembje fëmije në
mesnatën e qetë
që s'lëkundet nga dëshira për të gjetur
gjirin e humbur

dhe qielli i bëhet një hapësirë e ngushtë pa
ëndrra
se ëndrrat burrërohen nëpër tallaze

me detin lindëm në një ditë
qe mbarsur moti i vjeshtës së parë
ndërsa retë ekstazën e lirisë përtypnin
njëherësh
ushtritë e guackave kërkonin udhëheqësit
e tyre
dhe vraga e daljes sime
i la një thepisje të madhe
si të ish shuar malli i Akrokerauneve

loti i detit është një ishull i mbërthyer nga
darët e erës
shtrëngon shallin në qafën hollake si nyje
gordiane
dhe lë aty brenda si testament
një fat anonim
se vetë ai është një përtej-qenie që në
gjoksën e saj
ka frymën e padeshifrueshme nga alfabeti
ynë

dhimbja e daljes sime i mbetet plagomë
varur në krahoshë tek lundron detërave
velëbardhë e ngjyer me melhem që kullon
gjak
po peshë të rëndë ka gjaku pikuar nga
ashti i detit
se në damarët e tij lundrojnë frymëzime
të rinisë
dhe në parkun e fshehur diku pas aorte
mblidhen nën ombrellën e poezisë

loti i detit është lëngatë e perëndisë

requiem i të premtës mbrëma...

ç'është të blasfemosh me ty det në mos
mëkat
u shigjetofshin mëkatet drejt meje
njomur në palcën tënde prej përjetësie
bekuar në të ardhmen tënde prej ëndrre

një kuisje katërputroshi të zgjon qepallën
e syrit
mbi nënkresën prej batllash çajnë retë
gladiatorët e qiellit
ndërsa poetët mërdhijnë në vjeshtën e
vetmisë së tyre
me duhmën e flladit të hidhur të tetorit në
një qytet
që s'bën vjeshtë të trazuar

më bëj dhe mua dhembjen tënde det
atë të pashpjegueshmen dënësë të
Penelopës
më të pambërritshmin vendtakim
të ftohtin e gurëve që gdhihen
si dëshmitarë të pakorruptueshëm
më bëj dhe mua kureshtjen tënde
foshnjërake
atë të përrallës me piratë që luftojnë mbi
barkun tënd

ç'qenka të blasfemosh për ty det
aty në katakombin që fle mbi gishtërinjtë
e tu
fle dhe dhembja e një ylli që fiket shumë
larg prej këtej
dremit mbi pentagram
një requiem për amforën eshtërthyer

një orkestër kanë ngritur guralecët në
skenën me rërë
diku derdh lot një violinë
më tutje buzëqesh trupi i kitarës që ngjan
të jetë bota
e ndarë veç me paralele tejbotoërake

më bëj dhe mua det dhembjen tënde
trishtimin e një shtëpize detarësh
lotin e një zonje që mban në shpirt një
zezonë
dhe shuan mallin me këngën e valës në
prag

bëmë dhe mua ti përjetësi
një yll që fikjen ta kem mbi supin tënd
dhe atëherë kur të kem dhënë frymën e
fundit
me gishtërinjtë e tu do të më qasësh pranë
vetes
dhe rrasa e arkëmortit do peshojë dallgë
që nuk teshtit në breg

sheshim shtatori...

drithmën e vargut me se ta mbështjell
se moti nis të krisë mendjet
dhe syri i atij korbi -që s'është veç i Alenit-
mjegullon si jeta
në molin që mban peshën e moshës së
drurëve

mban varur në sqeposhkë një shami të
zezë
ndërsa me zezozën e gëzofit të tij
mban zi për një vjeshtë
që lë pas shpine
-të ndalet kjo drithmë dalldingjizëse e të
shkundet
qielli nga një baladë që peshon lot nëne-

s'e njoh imazhin tënd korb i stisur
i dalë nga çmenduria e frymëzimit
vallë ç'udhë ngave që bun në çatinë e
qytetit tim
parashutën tënde varur ke një shami prej
rejze
në ç'mote do të flitet veç për lavdinë tënde
se zezona na ngjau përditshmëri plakushe
me një protezë të lëvizshme

korbavegjëlit ku janë fshehur -tek ç'pendë
e jotja-
po duket se dhembshuria e amës nuk
qenka
për revolucionarët që hanë vetet të parët

me se ta mbështjell korb i nëmur çatinën e
qytetit tim
që ti në syrin tënd e ke prehë të
pashmangshme
me urinë e një të pangopuri si kurrkush
-korb-

ç'të këputet shpirtit ty si jehonë paskajore
-me mund ti me ba me qenë-

ajme të ndalet kjo turmë kujisjesh
frikamadhe
ç'që thënë të jetëzohet në hunjtë e
parastatujave
u bë bronz e rri heshturak barabar kryeve
tona
ç'që fshehur në rrethin e kujtesës është e
shkuar
u bë mirazh në celuloid të djegur

s'e njoh portretin tënd korb i dalldisur
por druaj vdekjen time
që në at' mot një këngë mund të rrojë në
buzën tënde

hënë e kafshuar që fle në qiell...

veç klithmë bulkthi troket tek portat Skee
sytë që përpeliten janë të tutë
pa u zgjuar nga bota
prej lëkurë ëndrrash
fjetur bashkë me ty në një masë
pentagrami
që përtyptet papritur nga uria e violonçelit
bërë prej dhimbjes së poetëve

në qytetin tim s'gjallojnë portat Skee
s'gjallojnë as sibilat
por do gresh rezervate të trishtilave edhe
më të bukur
që në lëkurën e mollëzave i vjeshtohet
fladi i shtatorit
në buzën e poshtme kullon ende plagë
puthja e ikjes
e nderur në telin e tretë në oborrin që sheh

nga deti
në dy gjinjte e tu që s'kanë njohur tjetër
betim të huaj
përpos atij se për atme edhe mund të
biesh
përpos atij se për atme edhe mund të
bëhet qenia jote

në qytetin tim gjallojnë dallgët e plakura
rini e dallgëve është fshehur mes trupit
tënd frymëzues
për t'u bërë poeti kokëkrisur në botë
ngase qyteti s'ka rritur portat Skee
për të shkruar një lavdi me bardhësinë
virgjëri

në qytetin tim gjallon kjo hënë e kafshuar
nga Zeusi
i pangopur sillet rrotull poezisë fhe rrotull
teje
por qyteti im nuk është Olimpi i kohëve të
reja
është qyteti që dallgën mëri e fsheh tek
luspa e sirenës
dhe dhimbjen e ngujon në gurin e brigjeve
që loti yt të mos mbërrijë kurrë atje

(pa titull...)

në këtë shi rrëmbak ti nuk je
ka mbet' një hije e mjegullt nga portreti yt

një grimëz trishtim prej syve
prej shpirtit
prej eshtrave
se fitoret nuk kremtohen mbi lëngata

mbetesh një hap i lodhur i ngadaltë e i
pashkëputun
nga truni i mekanizmit të jetës së
këtushme
se në përtej-botë thonë ndryshe është
edhe alfabeti i një qeni t'lëshuem rrugësh

në këtë shi obskur ti mbetesh mendim i
vyer
një metaforë e rrëmbyer në krahët e
mëmësisë së re

në dritaren e detit...

nga dhomëza e vogël me trupin rrethor
krahu i një pulëbardhe bëhet edhe më
bardhosh
si portreti yt me hënë të plotë ndër pupila
që vozit mbi armatën e historisë

nga dritarja e detit shoh qytetin ashtu të
urtë
duke dhënë shpirt në prehërin e
perëndimit
dhe vijën ikonike të trupit tënd që
përvidhet
si shenjtëri në jastëkun e dallgës

në rërë kanë mbetur gjurmë
kudo gjurmë gishtërinjsh të një të ecure
zbathurazi
sepse vetëm kështu mund ta ndiejmë
dhimbjen e tokës

ajo vijë ikonike e lakimit të trupit tënd
nget sa mijëra jetë të mbërrijnë në portën
e ëndrrës
dhe nga dritarja e detit
unë shoh se si zvetënohen rrugët
si falen njëzëit
si tranden pulëbardhat
si shuhen dritat e qytetit
se në ëndërr...

“ALBUMI I THASHETHEMEVE” TË STEFAN ÇAPALIKUT

nga Anxhela Pashaj

“Albumi i thashethemeve” është një nga shumë romanet e shkrimtarit Stefan Çapaliku. Një përzierje e disa teksteve artistike duke nisur nga ai letrar, bërë nga shkronjat, fjalët, frazat, paragrafet te ai muzikor dhe dramatik, i cili shpërfaqet përmes titujve emërtues të kapitujve, por edhe tensionit të brendshëm të ngjarjeve të rrëfyera, të cilat të lënë të përjetosh njëfarë emocioni që ta përcjell skena e teatrit dhe ajo e shfaqjeve muzikore operistike, të lidhura të gjitha këto me imazhet fotografike.

Një varg rrëfimesh e thashethemesh që e kanë zanafillën te kujtesa, te memoria si dhe te disa fotografi emblematishtë bardhë e zi të familjes Çapaliku, të personave me histori “turbulluese”, që kanë pasur marrëdhënie familjare ose miqësie me Çapalikut. Rrëfimi bëhet nga një prej personazheve, i cili e nis rrëfimin qyshse kujtesa e tij ka fuqi për të kujtuar. Janë rrëfimet e një djaloshi që rritet. Rrëfimet a thashethemet sikurse dikton edhe titulli duket se asnjëherë nuk pasurohen me trillime të reja, ato trashëgohen e përcillen me besnikëri nga njëri rrëfimtari i një breznie te rrëfimtari i breznisë tjetër. Këto thashetheme për personazhe familjarë, të qytetit apo edhe të historisë ruajnë një lloj dashamirësie për ta, nuk janë me qëllim përdhosjen e figurës së tyre, por për të shkundur pluhurin e identitetit të familjes që bën rrëfimet (thashethemet). Nga ana tjetër këto thashetheme gjallërojnë dëgjuesin, bashkëshorten e Doktorit e cila sa ka kureshtje për peronazhet e fotografuara aq edhe përjeton shokim nga zbulimet që bën për familjen, qytetin dhe sistemin.

Përpos rrëfimeve a thashethemeve që vijnë nga goja e Neni Ages, narratori kujdeset të rrëfej edhe një histori tjetër të tij që fillimisht nuk duket se lidhet drejtpërdrejtë me albumin e thashethemeve, por me botën e brishtë të emocionit të dashurisë së parë, si dhe të tashmen e jetuar të disa personazheve që sillen rrotull albumit të vjetër të thashethemeve (Silvia një prej tyre). Një varg rrëfimesh që krijojnë një tablo të plotë të ngjarjeve të së shkuarës së largët në qytetin e Shkodrës, të ngjarjeve në fëmijërinë e rrëfyesit, në adoleshencën e tij që duket qartazi se jetohej përgjatë viteve të diktaturës komuniste si dhe të kohës së pjekurisë që jetohej në ditët e tranzicionit politikë që duket se zverdh faqet bardhë e zi të albumit të thashethemeve.

Kjo linjë e dytë rrëfimi a thashethemi vendos në qendër narratorsin e paemër dhe dashurinë me ngjyrimet herë platonike, herë fizike e herë intime të tij për vajzën me emrin Silvia. Silvia bëhet më shumë se një dashuri e fëmijërisë, ajo bëhet shtypa e tij drej artit, muza e tij poetike. Është për shkak të saj që Ai nis edhe i futet shkrimit, poezisë, letërsisë. Me sa duket e bukura te Silvia zgjon sesnsin e tij për të madhërishtmen. Kjo linjë e dytë rrëfimi gjen shteg për t'u kryqëzuar me të parën po përmes Silvias, e cila zbulohet prej narratorsit të ketë një lidhje romantike me Doktorin. Ky zbulim duket se shkud me shumë lexuesin se sa të dashuruarin, madje mund të konsiderohet si kulminacioni i gjithë narrativës. Pas këtij zbulimi ngjarjet e tjera duket sikur vrapojnë me një shpejtësi murlani për kah zgjidhja. Në këtë fazë lexuesit i ofrohen shumë ndodhi të shpejta, të cilat lëvizin tagend me albumin e thashethemeve. Ky album rikthehet me vdekjen e Neni Ages, e cila në letrën e saj kërkon t'i bëhet një foto bardhë e zi sikurse fotot e tjera të albumit. Duket se në një farë mënyre ajo kërkon të bëhet pjesë e albumit, atij albumi me figura revolucionare. Pra, kërkon të bëhet histori jo vetëm e familjes, por edhe e qytetit (në ditën e saj të vdekjes i erdhën të gjithë jetimët që pati nën kujdes).

Mbyllja e romanit nuk i përfundon thashethemet, ato do të vazhdojnë jetën e tyre në Shkodër duke u arkivuar në albume bardhë e zi a forma të tjera. Ajo që mbyllet me të vërtetë në këtë roman është një gjysmë shekulli frike e thashethemesh që patën ngrirë zemrat e një shoqërie të tërë.



Japin shfaqje trishtilat e mi të puthjes

Me gjethe si sqepa zarigogash ,gakosur
Ketrat e mjegullave ngjiejnë gëzofët..
Pa ty, brenda meje,në trekëndësh të brinjëve,
janë varur gjithë dhimbjet e botës.

Në trojet e zemrës,si grumbuj thënjijsh
japin shfaqje trishtilat e mi të puthjes.
Si nuk mësova tu bie fyejve te shirave,
të tremb zarigogat e humbjes.

Për ty e shkul zemrekun e tokës

Sa herë mbjell imazhin tend,
në fushë të padurimit,
zëri yt, bëhet
aroma e këtij dimri.
Kur Ti, harron,
të bujtësh, në haurin e kokës,
gati jam,të shkul
zembrekun e tokës.
Rrotullohen zjarret
në futën e ditës,
ku fshehur rri Ti.
Në turrë të abetares,
thëngjijtë e shkronjave,
kthejnë mëzat e tymit,
në Xhordano Bruno të ri.
Unë, humb fillin
S'bind dot gishtat
të qep currilat
e fëshfërimës tënde
si një bisht loti,
me vetminë e një rime.
Fatmirësisht
kjo fantazi
kullot ,në psherëtimën time.

Ftesë për koncertin Jaz të Zotit

Të panjohura janë retë, në këtë ditë pa njerëz
të huaja, pa atdhe,dhe kumbullat e kuqe.
100 vjet vetmi, që ia bleva dikur verës,
Dhjetori i ktheu shollë i ngrënë këpuce.

Një zog prej loti ,bëhet Kopernik
në sytë e një gjyshi,mat orbita jugu.
Si Dreri i dimrit,përzënë nga përrallat
barit truri im, në çairet e muzgut.

Të panjohura janë retë, në këtë ditë pa njerëz
Askujt si shkon ndër mend, Koperniku i lotit.
Veç gjethet si ftesa të çuditshme vjeshte
ftojnë gjyshërit në koncertin jaz të Zotit.

Një ëndërr, në gjendjen civile

Aromën tënde
gergujt e durimit, kthejnë në nuskë.
Si fatsjellëse,
me gjilpërën e shirave,
ma qepin në trup.

Ditët janë të shkurtra.
Të mbarsura me ikje
,nën frikën e abortit.
Pa Ty,
jam një ëndërr,
në gjendjen civile të
mot motit!

Dy pëllëmbë dimër.

Dy pëllëmbë i gjatë dimri,
përhumbur qytetit,
ndjek shkollën e erës,
mes kangjellash ngjyrë zverdhur.
Me kembët e mpira,
Vitesh pa palëvizur
si kafe makiato,
pinë zili njërezish, pemët.

Nëpër shpresë, bri tyre,
nën kangjella përralle,
disa të moshuar,
përzënë nga mundësitë,
Si para bilardos,
ku mbyllur është qepeni,
në karrike mjegulle,
tymosin përditë.



ARBEN VELO

Ftesë për koncertin Jaz të Zotit

Dy pëllëmbë Dimri,
ca urdheresa të shenjta,
profeci të lashta,
si prift, lexon nën zë.
Bëj kryq e mërmëris:-
Ndodhtë një mrekulli!
Dy pëllëmbë ngeltë dimri,
mos u rritë më!

Dimërojnë puthjet në trëndafila

Kur fluturat trëndafilat
I veshin si fustanë,
Bishtalecat e gjëmbave,
kthehen në shandanë.

Të çuditshëm, trëndafilat
më ngjajnë si kokë çupe.
Në bishtalecat e gjëmbave
I dimërojnë puthjet.

Një fener gjaku, më ndez guguftuja në zemër .

Bletët kthejnë në hoje,pagjumin e embël
Një fener gjaku,ndez guguftuja në zemër .

Nga t'ja mbaj,se di,këtë natë të panatë,
braktisën pemët dherat,ikën qiejve të verbër.
Ca kuaj ekzistence,prej frerësh, si t'i kap,
hingëllin nata e lidhur pas pemës.

Mëngjesi më godet me bishtat e vesës,
dherave kthehen pemët,për njerëz të përgjumur.
Po shuhet ngadalë gjaku, në fenerin e zemrës
Iu hedh tërshërë fjalësh, kuajve të zbutur.

Vellëzërit e erës

Si një përrua tretur në Vjosë
me ujë dhe shira mbështjellë,
U tret dhe kjo verë,(se kuptoi askush
Si iku dhe këtë herë.)

Ikën shqiptarët,vëllëzërit e erës
përqafimet i ngarkuan patjetër.
Në molin e lotëve,ankoruan hijet,
në radë, deri Gushtin tjetër.

Kuturu...vetmie.

Se di, unë a vera, iku kuturu,
me ide të çuditshme, i vetëm rri në lagje
Një guguftu, kthen sqepin në ekspres
Dhe "gu gu"- në e saj, ma servir si kafe

Kafen e çuditshme,sdi me kë ta ndaj
As miqtë nuk i kam, ti qeras të paktën.
Një flutur shiu, me veshje kamariere,
më fton të paguaj dhe tvsh e natës...

Në supermarketin e erërave,ka mbaruar puhiza
dhe çmimet e vetmisë,rritur janë dyfish.

Lëviz nëpër rrugë, marr për dore veten
dhe një askush si unë,duhet të shëtis.

Në vendet ku vera harroi gjurmët e saj
si kurthe që vjeshtrat ti zënë në lak,
ca njerëz më ngjajnë kishëza të rrënuara
dhe nesër besoj, kështu do më ngjajnë prapë...

Astar shtatori, i qepur qiejve

Kaq ishte shtatori.Iku.
Unë, nuk di çtë bëj tani.
Me pak ngjyroshje depressive,
koha duarkryq rri.

Flladet,astarë të qepur qiejve,
të shqepen, duan lejen tënde.
Pa rrebeshin e një të qeshure
dhe truri im, pret të çmendet.

Unë gjerb rrëfenja për çka ndodh,
përgjatë ditënetëve, në këtë qytet.
Këtu dhe humori ndryshon si moti
dhe dashuria nuk ka adresë.

Njerëzit, si varka në det të hapur.
Kur ecin, prapë në vend rrijnë.
Pa ditur gjë për njëri tjetrin,
iu mburren rrugëve, se gjithçka dijnë.

Ta shpall të ikur, apo ende jo?
Për ikjen tënde, nuk thashë atëherë...
Veç di, tetorët tani i pi,
si kafe të forta pa sheqer.

Mos mi zgjo shirat

Nën qiejt veshur me rroba murgu
mbaj gjallë një kujtim që mbyt.
Retë si gërshet, lidhje pas belit
violinqel shirash floku yt.

E diela ime ishte e hëna jote.
S'duhemi më,ta marrin vesh.
Mos mi zgjo shirat,se violinqeli,
luan veç simfoni prej resh.

Nën qiejt e Vjeshtës,si rroba murgu,
jam kasafortë,asnjë dryn se hap.
Kur zgjuhen shirat,Ti kthehesh çelës,
hap zemrën dhe më freskon pak.

Të tillë vjeshtë dhe fluturat se mbajnë mend.

Ditëve nuk ka lajme, ka vetëm erë.
Të tillë vjeshtë,as fluturat s'mbajnë mend
Një dardhë e vetmuar,dremit nëpër degë,
me trungun prerë cung, mbetur si një mëngë.

Mbi hije shtëpish,çapitet erë e vjetër
kur ike Ti e kyçe ndër avlli.
"përdore,- i the vjeshtës, -mua,nuk më duhet,
supeve ta hedh,kam frikë se mbërdhij".

Nën dihatje muzgu,strukur rri një dardhë Erërat fut në trung,ta mbaj frymën gjallë.

Pa ty, jam si kjo dardhë,pemë e mbetur cung me një këmbë në tokë e një mëngë në mall.

Kur gënjejnë mjellmat e mjegullave.

Pemë kumbulle, u bë pritja për ty. Si vathë varur degëve,zogjtë e dimrit. mund të ishim takuar të dy te i njëjti alfabet i shpirtit.

Ngelëm as në qiej dhe as në tokë. Vjeshtra na janë kthyer dhe emrat. Çdo gërmë, është shndërruar në zog, me sqepin në sy, kthetrat,te zemrat.

54 vjeshtra e një pranverë pa një dimër

Dua të jem,54 vjeshtra e një pranverë,pa një dimër. Një thëngjill i vdekshëm, varur në gjethet e Panjës. Sa herë gergujt më qepin kostumin e dimrit, trëndafilat e ankthit, mbajnë aromë karafili perëndimesh. Ende nuk mësova, të qep dhe shqep,një zemër shtesë për kafkën e vetmisë time. Ti jap besë gurgullimës së lumit, ta kurdis,të përmyt pyllin,që Ti, e shpike për lejlekët e syve të mi.

Tani, Ti je dhimbja ime , kolla nga refluksi i gjërave të bukura, mallëngjimi i pyllit që e harrove si karficë, kur ike prej meje . Duhet të shpik, një tokë dhe një hënë tjetër të mos humb më asnjë ikje, qoftë dhe e zbutur, e bukur, si një instrument muzikor ende i pashpikur. Dua të jem 54 vjeshtra e një pranverë,pa një dimër. thëngjill i vdekshëm, varur në gjethet e Panjës.

Kronikë Nëntori

Po ikën dhe Nëntori,larg vrasësve të vet. Bie erë dherash dhe ditët janë ndryshe. As era smë do më, një krah të saj s'ma fal, "Kam merak për ty- thotë, si stina mos ndryshkesh "

Mërzitur me veten, skam kohë të di më shumë. Më merr mendtë fati i dimrave,lavditë. “Shtëngomë në grushtin tënd” -.më dih në vesh era “Të mos humbësh fitoret, si kokrrat ullinjtë...

Po ikën dhe Nëntori, larg vrasësve të vet Unë, var në diell, si hudhër, emrin tënd. Një njerk prej dimri je kthyer, o zot, stë dhemb vrasja e vjeshhtës, ikja e Asaj stë dhemb?

Etyd

Kur trëndafilat,fluturat i veshin si fustanë, bishtrat e dënesjeve kthehen në shandanë.

Thëngjij të çuditshëm, faniten si kokë çupe. Në bishtalecat e gjëmbave më dimërojnë puthjet.

Tango dimri

Hingëllin i çartur një mëz i hazdisur mërzie. Në patkonjtë e ajrit, ngecën lidhëset e këpucës time.

Ska këmbë njëriu në rrugë. Koha kalon,nuk ndalet. Nën këmbanore të bredhit, një mëllenjë ulet,të falet.

Mijra gjurmë këmbësh, mbetur në tokë nga njëriu. I piu dhe s'u deh dimri, me shoje këpucësh prej shiu...

Mbledh veten brenda vetes, nën minaretë e pemëve. O Mëllenja të dimrit, faleni,Asgjenë e njerëzve!

Lojë dimri

Me litar ngricash, nga koha e erës, kërcen e enjtja e një dimri, pa njerëz. Sa mirë ishte atëherë kur qemë bashkë. Çmalljet, kthenim në sythe drurësh, mbjellë buzë kalldrëmëve të hënës. Si shoje të gjelbër, i qepnin pemët, për nallanet e verës. Patkoj kuajsh janë tani gjethet, për postierët e vëllezërve Grim, vërtiten rruzullit, të na gjejnë adresat. Poshtë,dhera të kaftë, lart qielli. Nga torba e Dantes i rënë në det dielli. Dëshira, që falin namazin. të pathënat e mia të ditëve. Të luaj me kujtimet, e Enjtja shpik litarin e ngricave...

Pa asnjë Hënë kjo mbrëmje

Pa asnjë Hënë kjo mbrëmje astar errësirash i shqep, qiejve të jugut. Ngeli pa komça uniforma e muzgut. Një i dehur e rrëmben. Së prapthi e vesh sa shumë piu me xhindet në lokalin e lagjes. I ngritën doli, të ardhmes së përrallës. Në koshat me mbetje urbane, varfanjakët rrëmojnë të gjejnë domethënien e gjërave

Luajnë dopiogjashtën e vdekjes Pensionistët

I ndezën edhe sot pensionistët llullat me duhan elegjish. Në shtigjet e rrudhave ende presin puthjet e braktisura, nga e bukura e vjetër. Korijes së bardhë të filxhanit të kafesë, Qan e spushon fëminia e hënës së prillit. Teksa vetmia. luan me ata që para erës së shkuar, këngë zogjsh iu premton kjo ditë e mrekullive. Te bastunët në duar këmbanore të çuditshme, falen mungesat e mbesave dhe nipërve. Kapelet ngjeshur mbi koka si ngastra malli vendlindjeje. Domino bëjnë dopio fushën, bosh nga përqafigmet. Derisa të rrëzohet gjethja e fundit e dritës luajnë dopiogjashtën e vdekjes në stola përrallash, Pensionistët

VANGJUSH SARO

pa celular..

Tregim

Flitet se do të na i heqin celularët. Disa thonë që na i zhdukërkan vetëm për një kohë; po ashtu, edhe disa rrjete. Unë edhe e kuptoj, edhe s'e kuptoj pse-në. Kjo është një gjë kaq e habitshme; ne s'mund të bëjmë dot pa to. Urdhërin e ka dhënë drejtori; të tjerë thonë se ka ardhur nga lart, nga Bashkia. Jo? Nga Drejtoria e Arsimit. Nga Ministria. Ç'rëndësi ka! Por thuhet se kanë lajmëruar edhe prindërit; të jenë 'brenda' edhe ata. Epo, doemos; furtuna do t'i trazojë të gjithë. Ehë, erdhi kohë e keqe për celularët tanë. Të paktën për ca muaj, them me mendjen time, i qamë. Dhe unë, që vetëm pardje më ra në dorë një gjë e tillë...

Vetë e kini fajin, na 'ngushëlloi' larg e larg zysha e Gjuhës, Ana, që e kemi edhe kujdestare klase dhe është si shpirt. *Ka një kufi kur shikon dhe kur dëgjon. Tani ju s'dëgjoni më, ju vetëm shikoni*. Ka të drejtë; se edhe ne, çërr çërr gjithë ditën e ditës. E marr me mend që të gjitha zyshat janë mërzitur pak. E çfarë nuk bëjmë me ata të uruar celularë; është gallatë: Zile. Kopje. Mesazhe. U bë celulari si radio policie; kanal televiziv. Më e bukura është se shumica prej nesh vijmë nga krahina të ndryshme. Dhe veç të dëgjosh se si këndojnë dialektet: “Ère, Loshi!” bërtet njëri. “Ce, bre lalkë?” ia pret tjetri. “Qashtu, qashtu!” i treti...

Ani. Me kohë, do të ndreqen të gjitha, të thirrurat dhe dialektet. Kështu thotë edhe zyshë Ana. Por me sa duket, ne s'kemi durim, po lajthisim. Dhe punët në shkollë nuk shkojnë aq mirë. Ndonjëherë, ndodhin zënka e sherre dhe tani të gjithë thonë se një nga arsytet ka të bëjë me këto dreq celularë; dhe një tjetër shkak gjithaq, është ngaqë ne kemi ardhur vonë në Tiranë (!) Po pastaj? (“Mos ua dëgjoј më këtë fjalën ‘malok!’” na qortoi njëherë drejtori. “Jemi të gjithë qytetarë të Shqipërisë, një pëllëmbë vend; nuk e kemi luksin të ndahemi coprash...”) Ai e ka mirë. Po kujt i thua! Ej, mbase për disa, edhe unë jam një ‘maloke’. A është kjo ndonjë turp?

Siç po ua tregoja pra, vetëm pardje, për herë të parë, më ra në dorë një celular. Nga të paktat që nuk e kisha një aso. Në klasë kemi edhe tallavecë: “Ha haaa, asistencialistja!” Domethënë që e kam babin me asistencë; nuk punon asgjëkundi dhe shteti i jep një ndihmë. Punë koti; mirëpo ecë e mbaji lotët. Pooo, atë mbasdite, vërtet s'i mbajta dot; ia mbërrita në shtëpi furtunë. Apo nuk ishte edhe një mot i vrenjtur. Në dritare trokiste e këndonte shiu; këtej ia ktheja edhe unë me të qarë. Një ditë si kjo nuk ishte parë qyshkur në shtëpinë tonë.

-Ilira! Ç'të ka ndodhur, zemër? - m'u qas e para mami. - Mos ke marrë ndonjë notë të keqe?

-Jooo! - iu përgjigja sakaq.

Dhe pastaj ëëë, ia dhashë prapë me të qarë. Po si? Gërrr lotët. Më keq se shiu përjashta.

-Mos të ka ngacmuar ndonjë çun? - më pyeti vëllai. Ai është pa punë dhe sillet rrotull nëpër Tiranë e nëpër Bathore. Dhe babi i thotë herë pas here: “Mos ban sherr! S'të ndjeki dot burxheve...” (Po unë ç'mund t'i them vëllait? Quhet ngacmim kur sytë e një djali, të Denit në këtë rast, nuk të ndahen?)

-Jo! - thashë prerë. Pastaj prapë si kalama - Èëë!

-Po atëherë, pse qan? - i përmblodhi të gjitha pyetjet në një babi. (Ai i asistencës.)

Dhe unë, pa e ndaluar dot 'shiu' tim për asnjë çast (me siguri do t'ua kem hequr mendjen me atë që thashë, por s'mundesha ndryshe) e plasa ç'kisha:

-Më tallin shokët dhe shoqet, ëëë!... Më thonë asistencialiste. Më thonë pabukse, ëëë!...

Nga këndi i tij i rehatisë dhe i gjumit, një kolltuk që rri gjithnjë përpara televizorit, gjyshi mërmëriti plot trishtim:

-Gjithfarë gjanash jan' tu shpik tani! - Dhe pas pak. - N'at kohën teme, jo, nuk bajshin kështuna kalamoјt'.

Dale dale, se pyetjet sapo kishin filluar. Mami kërkoi të dinte tani shpjegimin dhe ngarkesat e asaj fjalës ‘*asistencialiste*'. Babit i bëri përshtypje ajo tjetra: ‘pabukse’. Ç'do të thotë kjo fjalë? Ai pyeste, mua më vinte keq t'ia hidhja sytë. Le që ohu, këto s'ishin gjë fare; hajde ta kuptosh e ta shpjgosh fjalorin që kemi ne atje në shkollë. Ani. Nuk kisha se si, ua dhashë përgjigjen dorë me një, kuptohet gjithë duke qarë:

-Këto fjalë duan të thonë... duan të thonë *fukara*...

Dhe pastaj, nga e para: “Èëë!” Mirë mirë, por tani do të mizëronin pyetjet dhe nuk kishte më kohë për t'u qaravitur.

-Moj vajzë - tha babi - a t'i kemi blerë ne librat?

-M'i kini blerë, - vendosa të mos qaja më për një hop.

-I ke gjë të çara atletet? - u hodh vëllai.

Tunda kokën gjithë inat, si për të thënë: “Mos i ke vetë aso...”

-A ke shkue ndoiherë n'shkoll' pa ngranë? - vërviti në këtë vorbull pyetjen e tij edhe gjyshi. Pastaj, si përherë, e shoqëroi me një koment - Ehë. N' atë kohën teme, ku me e gjet ni gorricë...

Pas kësaj, përmbledhjen e bëri mami. Prapë me një breshëri pyetjesh që shtynin e vërtisnin tutje njëra-tjetrën:

-Epo, atëherë përse qan, o shpirt? Kush të tall, moj zemër? I di zysha këto gjëra?

E lodhur nga ky gjyq, vendosa ta zbuloja arsyen e trishtimit tim. (“Hapeni zemrën, na thotë edhe zyshë Ana. “Flisni. Mos i mbani për vete trazimet e ditës.”) Kështu, edhe unë e hapa zemrën, ua thashë më në fund arsyen e vërtetë pse ishin derdhur gjithë ato lotë:

-Unë nuk kam celular. Ja përse. Èëë!...

Papritur, njerëzit e shtëpisë e mbyllën gojën. Të gjithë. U bë aq qetësi. Dhe vetëm shiu vazhdonte të trokëllinte në dritare si ndonjë budalla. Pas një copë here, gjyshi theu heshtjen i pari, duke thënë se në kohën e tij as që bëheј fjalë për *ktona, si ju thojn'*... Dhe pastaj, një tjetër koment, as që viheј në dyshim: “Opo kanë roit, të mëdhonј e të vogjë!... N'atë kohën teme, kokën qeros, çantën pi leckë në kurriz, ene ho...”

Ani, lotët e mi nuk shkuan fare kot. Mami dhe babi u shtrënguan ca edhe ma blenë celularin. Lanë mangut një gjë tjetër. Tani, e gjithë klasa jonë është e pajisur si jo më mirë me celularë. Disa madje kanë *ajfone* nga të fundit, çfarë nuk bëjnë me to. Por ç'i do! Do të na i ndalojë drejtori. *S'ka*, tha ai. *O fikini, o fikuni vetë!* Dhe atje më lart, në Bashki, në Drejtorinë Arsimore, në Ministri, ku ta di unë, kanë mendje edhe më të keqe, me na i zhduk edhe ca rrjete.

Sot në mëngjes, e lashë celularin në xhepin e vogël të çantës dhe i dhashë mirë stilolapsit. Gjithsesi, mendja ma do që kjo është një gjë e përkohshme. Por edhe ne duhet të mbledhim pakëz mendjen; se thotë mirë zyshë Ana: “Na mbeti koka mbi ekrane. Harruam të shikojmë njëri-tjetrin a të vështrojmë lart, qiellin...”

Autori i horrorit mbi Dr Seuss, radikalizmin e Earl Thompson, dhe librin e përsosur me vrasje të mistershme

Kujtimi më i hershëm i leximit

Isha pesë vjeç, në apartamentin tonë në katin e tretë në Stratford, Connecticut. Libri ishte "The 500 hats of Bartholomew Cubbins" nga Dr Seuss.

Libri im i parapëlqyer tek rritesha

Ndoshta "Dhe nuk mbeti më askush" e Agatha Christie. Është misteri i përsosur me vrasje.

Libri që më ndryshoi si adoleshent

"Perëndia e mizave" nga William Golding. Isha tërësisht i investuar në të, tërësisht *aty*. E ke parasysh mënyrën si ishin fëmijët në kulmin e "Harry Potter"-it? Ashtu isha unë me Ralph dhe Jack.

Autori që më ndryshoi mendjen

Isha dymbëdhjetë vjeç kur lexova "Studs Lonigan", nga James T Farrell. Bënte atë që bënin romanet rinore por me shqetësime të rriturish. E kuptova "Studs" që në fillim. Është një triologji, e cila ndjek një adoleshent optimist nga Chicago gjatë Depresionit të Madh deri sa në volumin e tretë bëhet një i alkoolizuar i shpëlarë e i hidhët. Ma ndezi cinizmin prej adoleshenti dhe më ofroi një portret fiktiv të forcave shoqërore që po shtypnin amerikanët. Një apo dy vjet më vonë u zëvendësua nga "Vilet e zemërimit" e Steinbeck-ut, si libri im i preferuar mbi Depresionin.

Libri që më bëri të doja të isha shkrimtar

Perëndia e mizave: ishte për fëmijët, dhe unë isha fëmijë. Subjekti ishte i thjeshtë dhe zbritja drejt egërsisë ishte e besueshme. E lexova në moshën dymbëdhjetë vjeçare – vetëm më vonë e kuptova simbolin e kokës së prerë të dërrit dhe nënteksin seksual. Mendova se nëse do të mund të bëja diçka të tillë, do të isha i lumtur. Dhe gjeje çfarë? Kisha të drejtë.

Libri të cilit iu ktheva

"A garden of sand" nga Earl Thompson. Doja të dija nëse ishte aq radikal sa e mbaja mend. Ishte. Gjithash-tu, "Last Exit to Brooklyn" nga Hubert Selby Jr. Ishtë *më i mirë* nga sa mbaja mend, por jo aq radikal.

Libri që nuk do të mund ta lexoja sërish

Ndoshta "The Robe" nga Lloyd C Douglas.

Libri që e zbulova vonë në jetë

"The Heart is a Lonely Hunter" nga Carson McCullers. Shkruar nga një grua e re e cila ishte thujse fëmijë, fokusohet në rëndësinë e John Singer, një "shurdh-memeci", dhe ka tri personazhe. Singer nuk do t'ia dijë vërtet për asnjërin prej tyre, ka punët e veta, por ata *mendojnë* se ai di gjithçka. Pakashumë siç ndihen njerëzit për Zotin.


Libri që po lexoj tani

"After Midnight", tregime të shkurtra nga Daphne du Maurier, që do të botohet në tetor 2025.

(Përktheu E. H.)

STEPHEN KING:

"E kam dashur
"Perëndinë e Mizave"
si fëmijët e sotëm
"Harry Potterin"



Një kafene në prapavijën e qytetit. Dyshemeja e mbuluar me baltë. Mjegull nga tymi i duhanit. Tavolina të pista e ngjithëse. Ca ushtarë, ca zonja dhe shumë civilë. Në skenë pianoja, violonçeli dhe violina luajnë fort diçka. Kaloj përmes tavolinave dhe ulem. Një zonjë e re me përparëse të bardhë vjen tek tavolina dhe më shikon në mënyrë pyetëse.

“Do keni mirësinë të më jepni një gotë me çaj dhe dy kekë?”

Zonja e re zhduket, pastaj kthehet dhe, sikur të më bënte një favor, më vendos përpara një gotë me një lëng të verdhë dhe një pjatë me dy kekë të thatë. Shikoj gotën. Lëngu nga pamja zor se të kujton çajin. I verdhë, i turbullt. E provoj me lugë. I ngrohtë, pak i ëmbël, i pakëndshëm. Ndez një cigare dhe shikoj publikun.

Te tavolina fqinjë vjen një grup i zhurmshëm: dy zotërinj civilë dhe një zonjë. Zonja e veshur mirë, me mëndafsh fëshfëritës. Civilët më bëjnë përshtypje më të mirë: të gjatë, faqekuq, të ushqyer mirë. Mesoburra. Janë të veshur bukur. Një pjatë me kekë dhe tri gota me kafe Varshave duken përpara tyre. Fillojnë të bisedojnë. Deri tek unë mbërrijnë fjalët e civilit me këpucë lëkure lustrafina që është ulur më afër meje. Zëri është i shqetësuar.

Dëgjoj: “Rostov... mund ta imagjinosh...gjermanë, kinezë, panik... ata me helmeta...njëqind mijë kalorës...”

Përsëri: “Rostov... panik... Rostov... kalvaleri...”

“Kjo është e tmerrshme,” - flet dama me zë të ulët. Por duket që nuk është e tronditur nga njëqind mijë kalorësit e fuqishëm ose nga helmetat. Ajo pi duhan duke vërshëlyer dhe shikon rreth e rrotull kafenesë me sytë që i shkëlqojnë. Dhe ndërsa këpucët lustrafina prej lëkure vazhdojnë të pëshpërisin, imagjinata ime fillon të punojë.

Ç’do të ndodhte sikur befas, si në përralla, të fitoj pushtet mbi zotërinjtë civilë? Oh, Zot, kjo do të ishte e shkëlqyer! Atëherë këtu në kafene do të ngrihesha dhe duke shkuar tek zotëria me këpucë lustrafina do t’i thoja:

“Eja me mua!”

“Ku?” – do të pyeste me habi zotëria.

“Të dëgjova që je i shqetësuar për Rostovin, dëgjova që je i shqetësuar për invazionin bolshevik.”

“Të bëri përshtypje?”

“Eja me mua. Do të të jap mundësi të regjistrohesh menjëherë. Atje të japin sakaq një pushkë dhe mundësi të plotë për të udhëtuar drejt frontit me shpenzimet e shtetit. Atje ku do të marrësh pjesë në zbrapsjen e bolshevikëve të urreyer.”

E imagjinoj se ç’do të ndodhte pas këyre fjalëve me këpucët lustrafina. Do ta humbisnin menjëherë shkëlqimin e mrekullueshëm dhe një copë kek mund t’i ngecte në fyt. Pasi ta merrte pak veten do të fillonte të dërdëlliste. Nga ky shpërthim i paqëndrueshëm, por i nxehtë do të dukej qartë se fillimi i gjithë kësaj paraqitje mund të ishte hipokrizi. Duket që ky njeri në lulëzim, faqekuq është i sëmure... dëshpërimisht i sëmure, i pariparueshëm, i pakurueshëm! Ai ka defekt në zemër, hernie dhe



MIHAIL BULGAKOV

Në kafene

tregim

Përktheu nga rusishtja Kosta Nake

një nevrasteni të tmerrshme. Vetëm një mrekulli mund ta shpjegojë faktin se si ulet në një kafene, duke mbllaçitur kek dhe nuk shtrihet në varreza i brejtur nga krimbat..

Fundja, ai ka raport mjekësor!

“Kjo s’është asgjë, - do të thoja unë. – Unë kam dëshmi, dhe jo një, por tri. Megjithatë, siç e sheh, kam veshur një pallto angleze (e cila, me që ra fjala, nuk më ngroh aspak) dhe jam gati në çdo moment ta gjej veten në tren ose për surpriza të tjera të natyrës ushtarake. Grise raportin! Nuk ka kohë për të tani! Ti e përcaktove gjendjen e punëve kaq të zymtë.”

Në këtë pikë, zotëria do të fillonte të fliste me zjarr se në fakt ai ishte regjistruar dhe ishte duke punuar për mbrojtjen aty-këtu.

“Ia vlen, vallë, ta thuash, - do të përgjigjesha unë, – që është e vështirë të përfshihesh, por të dalësh dhe të hysh në shërbim në front është një moment! Përsa i përket punën së mbrojtjes, ti... do të thoja...gabohesh! Nga ana e jashtme, nga gjithë sjellja jote, është e qartë se ti po punon vetëm për të mbushur xhepat me kartat e carit dhe Donit. Kjo është e para dhe, e dyta, ti je duke punuar për shkatërrimin e prapavijës, duke u endur kafeneve dhe kinemave dhe duke mbjellë konfuzion e frikë me rrëfimet e tua, me të cilat infekton cilindo rreth teje.

Ti do të jesh dakord me mua se asgjë përveç mashtrimeve të pista nuk mund të dalë nga një punë e tillë për mbrojtjen! Jo, ti, padyshim, nuk je për këtë punë. E vetmja gjë që ka mbetur për ty është të shkosh në front!”

Në këtë pikë zotëria do të kapej pas fijos së kashtës dhe do të deklaronte se kishte rrethana lehtësuese (djali i vetëm i nënës së ndjerë, ose diçka e tillë) dhe më në fund do të thonte, madje, se nuk dinte si mbahet pushka.

“Për hir të Zotit, - do t’i thoja unë, - mos më fol për lehtësira. Po ta përsërit, nuk ka më kohë për to tani! Sa për pushkën, është gjëja më e lehtë! Të siguroj që nuk asgjë më të thjeshtë në botë se sa të mësosh të qëllosh me pushkë. Ta them këtë nga përvoja ime. Sa për shërbimin ushtarak, ç’të bësh! Unë, po ashtu, nuk kam shërbyer, por ja vjen. Të siguroj që edhe mua nuk më tërheq lufta me shqetësimet dhe fatkeqësitë që lidhen me të. Po ç’të bësh! Unë nuk ndjehem mirë, por duhet! Unë e dua jetën e qetë paqësore, kinematë, divanet e butë, kafen e Varshavës, jo më pak, ndoshta më shumë se ty! Por, ja, nuk mund të shfrytëzoj asgjë nga pushteti i tyre! As ti, as unë nuk kemi zgjedhje tjetër përveçse të marrim pjesë në luftë në një mënyrë a në një tjetër, përndryshe një re e kuqe do të derdhet mbi ne dhe ti do ta kuptosh ç’do të ndodhë...”

Kështu do të thoja unë, por ndoshta, nuk do ta bindja zotërinjë me këpucë lustrafina. Ai do të fillonte të murruriste ose më në fund do ta kuptonte se ai nuk donte... nuk mundej...

“E po atëherë nuk mund të bëhet asgjë, - do të thoja unë me psherëtimë. – Nëse unë nuk mund të të bind, atëherë duhet t’u nënshtrohesh rrethanave!”

Duke u kthyer me shpejtësi nga ata që na rrethonin (në ëndrrat e mia, sigurisht, i përfytyroja si një elementë thelbësorë) do të thoja, duke treguar zotërinë tërësisht të vradë:

“Shoqëroje zotërinë te komanda ushtarake!”

Pasi të mbaroja punë me zotërinë me këpucë lustrafina, do të drejtohesha tek tjetri...

Por, ah, dukej që kaq isha përfshirë me bisedën sa që civilët e ndjeshëm, me të dëgjuar vetëm fillimin e saj, në heshtje, një nga një, u larguan nga kafeneja. Të gjithë, deri tek i fundit, me vendosmëri!

Trioja e skenës pas pushimit fillon me tango. Dal nga meditimimi. Fantazia mbaroi. Dera e kafenesë përplasit e përplasit. Njerëzit po vijnë. Një zotëri me këpucë lëkure lustrafina troket me lugë dhe kërkon kekë të tjerë...

Paguaj njëzet e shtatë rubla dhe, duke kaluar përmes tavolinave plot me klientë, dal në rrugë...

ATJONI, QË SOLLI ADONISIN
- kujtesë në 10 vjetor -

...jo vetëm që ishte takuar me Adonisin, por dhe ishin miqësuar, madje më solli një nga librat e tij me poezi, të përkthyer në gjuhën italiane, "I'llusione dei miei passi", me një autograf nga autori në gjuhën arabe.

Im bir, Atjoni më mrekulloi. Po më tregonte se Adonis kishte ardhur në Milano në shtëpinë e mikut të vet, poetit Italian Sebastiano Grasso, president i PEN Clubit Italian, mik dhe yni... Atjoni shkante dhe e vizitonte shpesh, sepse ishte student po në Milano, për filozofi në Universitetin Katolik "Sacro Cuore", - në atë degë që ishte lauruar dikur, larg, në Damask dhe Adonisi, - kështu më tha.

Shfletoja librin, në italisht e kishte përkthyer profesoresha Hadam Oudghiri, "princesha arabe, pasardhëse e Muhamedit", e njihja, jetonte në Milano dhe Atjoni ishte miqësuar me vjazën e saj më shumë.

- Ata do të donin që ta përktheje ti në shqip, - m'u drejtua Atjoni serioz dhe buzagaz, - Sebastiano po se po, por dhe vetë Adonisi. Dhe po më tregonte bisedëm me atë. Interesimi i Adonisit për Shqipërinë ishte i ndjeshëm, e kishte pyetur për lirinë në Shqipëri, gjendjen e gruas, gjuhën, fetë, Zoti im është e panjohura, kishte thënë ai, tekta shkante nëpër gishtrinjtë. Si të gjyshit tim, i kishte thënë studentit. Janë tespie erotike, kishte buzëqeshur Adonisi. Habitej si një fëmijë, - e përfundon rrëfimin e tij Atjoni. -

Fillojmë nga puna, - thashë unë. Do më duhej Atjoni, se pas pas ca ditësh do të ikte nga Tirana. Italishten e dinte si shqipen, ai mbante librin në dorë dhe m'i përkthente poezitë, unë shkruaja. Nën mbikqyrjen e tij të rreptë përfundova të gjitha poezitë.

U qetësova kur s'kishin as ndryshime me origjinalin arabisht, që botimi italisht e kishte në anë, në çdo faqe. I krahasuan Dr. Ramiz Zekaj dhe Alban Kodra, që kishin kryer universitetin andej.

Shtëpia botuese "Uegen" nxori librin, po me atë titull "Ilizioni i hapave të mi", me kopertinë një kolazh të vetë Adonisit, po emër përkthyesi u vu vetëm njëri, imi, se Atjoni, nismëtari, ishte ende student dhe para autoritetit të Adonisit ashtu do të duhej, menduam gabim...

Atjoni do merrte një sasi kopjesh të librit për në Milano, ndërsa miku i përbashkët, Sebastiano Grasso, që kishte bërë dhe parathënien, do t'ia postonte për në Paris.

E përcollëm Atjonin në aeroportin "Nënë Tereza" në Tiranë... Ah, ai së shpejti do merrte qiellin përgjithmonë...

DASHURIA, MESDHEU DHE POEZIA...

Ndërsa pasthënien e librit e kisha shkruar unë. Ndër të tjera thosha se Adonis ndihet i Mesdheut - aty ku bota përqëndroi bukuri dhe kulturë, poezi dhe mirëkuptim, kështu duket se është.

Mesdheu në epokën pagane, shpjegon jo pa qortim Adonis, ishte më i mirë në krahasim me sot: në epokën e fanikasve, grekërvë kishte një shkëmbim kulturor shumë më të madh.

Kurse Jeruzalemin e sheh si një qytet të shenjtë për të gjithë, hebrej, kristianë, muslimanë.

Ja ç'ka vënë re Adonis, kur ishte në Napoli: varri i Virgilit pranë atij të Leopardit janë shenjë e një vazhdimësie që është dhe shenjë dialogu nëpërmjet hapësirës dhe kohës...

Adonis beson në rolin e madh që mund të ketë poezia në ndryshimet shoqërore, jo si një rol praktik i saj, në sensin që nuk është poezia që ndryshon botën, por ajo mund ta ndihmojë qënien njerëzore të gjejë rrugën e drejtë.

Poezia për Adonisin është si dashuria. Por ç'bën dashuria? - pyet ai. Dhe përgjigjet: rinovon vazhdimisht ndjenjat e personave, jep energji të reja dhe hap horizonte drejt bukurisë së jetës. Ngjan me një dritë që na ndriçon ecjen drejt së panjohurës. Dashuria është si poezia, është si një hapësirë e hapur, dora dorës duke e zbuluar rritet, piqet, ngazëlletet, provon lumturinë. Kjo ndodh në nivelin vetanak, por nga ana tjetër, përkundrazi, poezia bëhet e domosdoshme kur shkenca o filozofia nuk japin përgjigje për misteret e jetës. Në këtë çast poezia, si dashuria, shndërrohet në mjetin e vetëm, i aftë të të flasë, të dialogojë me shpirtin tënd.

Deri sa të jetë dashuria do të jetë dhe poezia e deri sa të jetë poezia do të jetë dëshira për paqe, mendon Adonis: *Të dua sikur jeta/ të ishte shpikje e dashurisë time.*

Sipas një përgjigje të atëhershme të Adonisit në "New York Times", bota arabe nuk ka më aq shumë kulturë të sajën, e ka mbaruar aspektin e vet kulturor duke u bërë pjesë e kulturës perëndimore, por vetëm si konsumator, jo si krijues.

Adonis vetë është krijues i madh i bashkimit të kulturave. Konkretisht poezia e Adonisit përqafon sa nga tradita perëndimore e lirizmit

ADONIS, POETI SIRIAN NË PARIS DHE STUDENTI SHQIPTAR ME EMRIN ATJON...

Nga Visar Zhiti

NË KONFERENCËN PËR SHTYP

Poeti me njohje botërore, Adonis, këto ditë në Paris në një konferencë për shtyp, tekta merrte një çmim tjetër letrar, do të bënte thirrjen: "Duhet të ndryshojë shoqëria".

Në vendin nga ai kishte ikur, në Siri, regjimi diktatorial "Bashar-Assad" u përmbys dhe grupimet e armatosura të opozitës hynë në Damask në agimin e një të diele të vonë.

Adonis tha se gjithmonë kishte qenë kundërshtar i atij regjimi... "Bisha që ishte në krye, u arratis në Moskë dhe vitet e sundimit të tij përfunduan..."

Disa po e quanin fjalën e Adonisit si "reluksion për të mbështetur revolucionin", ndërkaq në konferencën për shtyp ai pyeti dhe vetë: "Ata që e zëvendësuan atë (Bashar -Assad), çfarë do të bëjnë? - dhe vazhdoi: - Çështja nuk është të ndryshojmë vetëm sistemin, por të ndryshojmë shoqërinë... ndryshe zëvendësimi i një sistemi tjetër është thjesht sipërfaqësor" - theksoi dhe shtoi se është e nevojshme "çlirimi i grave. Shoqëria është themeluar mbi të drejtat dhe liritë, mbi hapjen dhe mbi pavarësinë e brendshme. ", etj, etj.

Poeti 94 vjeçar, Adonis, tregoi se nga shkaku i diktaturës së gjatë ishte larguar nga vendi i tij që në vitin 1956, pra, për më shumë se gjysmë shekulli, "...kështu që nuk e di Sirinë, nëse do të dua të flas në thellësi..." - tha.

Ndërkaq atje po bëhen përpjekje të mëdha që të shmanget kaosi, të qetësohet gjendja, sa komplekse po aq e paqëndrueshme dhe që të krijohet siguria sa më parë është dhe një prani e forcave të huaja, përfshirë ato amerikane.

Po Adonis është poeti, atdheun e ka gjithmonë me vete dhe dramën e popullit të tij janë dhe dramën e poezisë së tij. Ai, do të thosha, është vetë thellësia dhe e ardhmja...

të lartë dhe filozofik i Hölderlin-it, Baudelaire, Rilke, sa nga ajo orientale e autorëve si Niffari e Abu Nuwas.

Është përkthyer në shumë gjuhë dhe është vlerësuar me shumë çmime nëpër botë, Francë, Itali, Gjermani, në SHBA e Kinë vitin që shkoi, etj, me motivacione nga më të goditurit si: Vargjet e tij me karakter social dhe politik janë të dashur, mbi të gjitha nga të rinjtë...


Që atëherë, jo pasi ra, Adonis i kishte bërë thirrje presidentit sirian Bashar al-Asad të jepte dorëheqjen nga shkaku i diktaturës dhe i luftës civile, kurse opozitës që të shmangë dhunën dhe të hyjë në dialog me regjimin.

Vërtet ishte Siria që shpiku alfabetin arab, - thoshte, - dhe ishte Siria që krijoi fjalën

Europë, - ngrinte zërin Adonis, - por lufta nuk ka sens. Duhet t'i jepet hapësirë dialogut. Njeriu duhet të flasë e jo të vrasë.

Një pjesë e çmimeve që ka marrë, mbajnë dhe emra poetësh, të kolegëve në kohë e vende të ndryshme si "Nazim Hikmet", "Bjornson", "Gëte", etj. Pritej dhe Nobeli...

Gjithashtu përballë bregut tonë në Liqenin e Pogradecit, ka ardhur në Strugë dhe ka marrë Kurorën e Artë në festivalin e poezisë. Ishte viti 1997, kur tek ne kishte pllakosur kaosi, ishin rrëmbyer armët dhe e kaluara hakmerrej për të tashmen, ndërsa e tashmja kërcënonte të ardhmen, qielli dukej se u mbush i gjithi, jo me yje, por me vrma plumbash, e megjithatë ne shkruanim poezi.



Adonis dhe Atjon



LAGJJA E SHQIPTARËVE
NË ATDHEUN E ADONISIT

Në pasthënien time kisha dhe një pjesë për shqiptarët në Siri. Po në lagjen e shqiptarëve atje, a do ketë vajtur Adonis, - pyesja me vete, - se sigurisht e di...

Që në kohën e shtetit Osman, nga fundi i shekullit XIX e në fillim e shekullit XX në Siri ikën familje nga Shkodra, Peja, Podujeva, Vu-shtria, etj, dhe shumica sot mbajnë mbiemrin "Arnauti". Institucionet gjegjëse japin statistika që janë nga 5 deri në 10 mijë shqiptarë. Prej tyre kanë dalë dhe personalitete të letrave në botën arabe. Ndihmesa e arnautëve është e ndjeshme, madje janë nismëtare në lëvrimin e romanit, dramës dhe tregimit. Por janë shquar dhe në poezi.

Romani i parë në Siri është i shqiptarit Maruf Arnauti, i vitit 1929, me tre volume "Sejid Kurejsh" (Zotëria i Kurejshit).

Sigurisht Adonis do ta ketë lexuar. Pritja e mirë që ju bë romanit nga lexuesi, interesi i tyre, bënë që autori të vijonte dhe me romane të tjera epokalë. Po atij i pëlqente teatri, për të cilin dhe studioi. Drama e tij e parë është "Xhemal Pashë Gjakatari", që u shfaq qysh në kohën e pavarësisë së parë të Sirisë dhe është i pari që futi temën aktuale në dramë, të nxjerrë nga realiteti jashtë skenës. Po u shquan dhe aktorë shqiptarë si Ekrem Huluki, djalë shkrimtari dhe Ajshe Arnauti, që e nisi karrierën qysh në moshën 10 vjeçe, e njohur në Damask dhe Bejrut.

Shquhen dhe poetët Mustafa Huluki (1850-1915), liriku i brengave të mërgimit dhe të vetmisë, i cili vdiq i verbër si dhe Thabit Niman Ferizaj (1860-1950), që shkruante shqip me alfabet arab poezi fetare e mistike, por ishte astronom dhe studiues i shkencave të natyrës.

Pastaj mori hov poezia shqiptare në Siri me Shevket Gavoçin, i lindur në Shkodër, i ndikuar nga Rilindja shqiptare, sidomos nga Filip Shiroka. Edhe nxënësi i tij, Abdulatif Arnautin, e nisi me pseudonimin letrar "Ibn Kosova", që do të thotë "I biri i Kosovës". Më pas botoi romanin "Al-Hatabun" (Druvarët), ku tregon për shpërnguljen e shqiptarëve dhe jetën në mërgim. Ai ka përkthyer në arabisht dhe dy romane të Kadarese. Pastaj nisi të shkruajë shqip dhe të botojë në Shqipëri e Kosovë. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve në Damask dhe duhet të jenë njohur me Adonisin. Kurse vëllai i tij Abdylkader Arnauti është piktor i njohur.

Janë të njohura dhe poezitë e Hatixhe Arnautit. Ajo botoi përmbledhjen e saj të parë "Rebiu Kalben" (Pranvera e një zemre) në vitin 1954, kur Adonisi përfundoi studimet universitare.

Një vit më vonë, në 1955, Adonisin e burgosin "për ide politike subversive" dhe nga që "adheroi në një parti politike nacionaliste"... "Gjithë kohën e kalova në një qeli të vogël mes të marrëve, trafikantëve dhe hajdutëve", tregon Adonis.

Në këtë kohë në Damask shkëlqeu poetja Aisha Arnauti, studioi për gjuhë dhe letërsi frënge. 11 vjeçe botoi poezinë e parë, 14 vjeçe ishte në qendër të shtypit arab, e quajten Saganin e Sirisë. U botua në Angli e SHBA duke e shpallur si "Mrekullia e vitit". Mbase Adonis e ka lexuar në burg.



Edhe inxhinieri i hekurudhave Barakat Arnauti nga Kosova, që shkoi të punonte në Gjermani, shkruante poezi dhe është konsideruar si fenomen në letërsinë siriane.

Tregimi në Siri është lëvruar vonë. Përsëri nismëtarë shqiptarë, nga ata që e nisën me poezinë. Mustafa Haluki e filloi në vitin 1880 me "Vezaif el-Inath" (Detyrat e fëmijëve), etj, etj.

Adonis patjetër duhet ta ketë njohur këtë botë shqiptare aty, në mes të botës arabe.

SI NJË KTHIM PAS 1001 NETËVE

عندما ولد / رُفيع للمرأة / آتون
 ائدوى في بيت / الصدوق
 الشب من / سيبا سينا نو
 فزا سو
 كان ينزل / بالشمع
 كان حوئفسه / قصيدة ساعة



Ali Ahmad Said Esber është emri i tij i vërtetë. Ka lindur më 1 janar 1930 në Al Qassabin, Latakia, në pjesën veriore të Sirisë, në një familje fshatarësh.

Në vendet arabe poezia ende mban lidhje të forta me shoqërinë dhe popullin. Aliu qysh fëmijë kishte punuar në fushë, por i ati i kishte mësuar përmendësh mjaft poezi dhe ai nisi të shkruajë dhe vetë.

Kur Aliu i vogël ishte 12 vjeç, ikën nga fshati në qytetin më të afërt se kishte marrë vesh që do të vinte Presidenti i parë i Sirisë, Shukri al-Kuwatli. Sipas zakonit, gjatë ceremonisë së pritjes, poetët vendas do të lexonin poezi në nderim të vizitorit më të lartë. Pikërisht për këtë kishte ikur nga shtëpia pa leje Aliu i vogël, donte të merrte pjesë, ashtu i zbathur, me rrobat gjithë pluhur nga rruga. Mbatësit e rendit nuk e lejuan të kalonte, por ai ngulte këmbë dhe ata e shtynë tej. Por thërret e çirret dhe presidenti kthehet nga ai. Dhe lejohet të recitojë poezinë e vet duke i mahnitur të gjithë. Si shpërblim e regjistruan në Liceun francez në Tartus.

17 vjeç boton poezitë e para...

Adonis del nga burgu më 1956 dhe dy vjet më vonë vendoset në Bejrut, në Liban dhe bëhet bashkëthemelues në revista të njohura letrare, ku botohen poezi eksperimentale, etj.

Dalja e poetëve arabë nëpër botë ka patur ndikim dhe në poezinë botërore, në Europë dhe Amerikë veçanërisht. Poeti libanez Kahlil Gibran përbën një përfaqësim të shkëlqyer të letërsisë arabe në egzil. I ndikuar prej tij, po kështu dhe Adonis, metaforat e të cilit sollën një lloj surrealizmi, me më pak intelektualitet, por me më shumë vizion dhe imagjinacion. Poetët arabë, ashtu si dhe poeti i madh Indian Rabintrabth Tagora, sollën në poezinë bashkëkohore profecinë, vegimin, ëndrrën, magjinë, mrekullinë, pafundësinë.

Tashmë poezia moderne arabe është padrone e vetvetes, e gjuhës së saj.

Në vitet '60 Adonis studion në Paris. Shkon në Nju Jork në vitin 1971 dhe boton poemën uitmaniane "Varr për Nju-Jorkun"...

Në vitin 1984 emërohet "Oficer i Arteve dhe i Letërsisë" nga Ministria e Kulturës Franceze dhe një vit më vonë vendoset përfundimisht në Francën ku kish mërguar dhe fillon punë si profesor i arabishtes në Universitetin e Sorbonës në Paris. Është zgjedhur dhe anëtar i Akademisë "Stephen Mallarmé" atje. Adonis është vetë poezia moderne arabe, ndërkohë dhe rebeli i saj.

TAKIMI IM...

Adonisin unë e takova po në Strugë pas vitit më tragjik të jetës time, të para 10 vjetëve. Nuk doja të dilja nga shtëpia, por poeti Italian Sebastiano Grasso, me të cilin më mik u bë Atjoni im, ngulmoi të shkoja me të, se do të vinte dhe Adonisi, që befasi u miqësua aq shumë me Atjoni në Milano. Unë ashtu e përfytyroj poetin, më kishte thënë im bir. Dhe Eda ime më tha: shko, duket se është dëshirë e Atjonit.

Në mbrëmje isha vetëm me Adonisin në njërën nga tryezat në taracën e hotelit. Më ftoi të ishim vetëm dhe pak mënjane, më shikonte me shumë dhembshuri. Po ashtu e shikoja dhe unë, ai kishte parë tim bir, e kishte në kujtesë, mund të më thoshte diçka, vetëm me njerëz të tillë mund të rrija tani.



Dy gotat e mëdha të verës mbi tryezë më dukeshin si dy habira. Adonis ishte mbështjellë me një shall të kuq. Zërin e kishte të ngrohtë si kadife. Fliste ngadalë, shkak s'ishte gjuha e huaj për të dy, besoj, por s'donte t'më lëndonte me asgjë. Kur i tregova në celular foton, ku ai kishte dalë me Atjoni tim, më tha se vetë kishte më shumë foto. Buzëqeshi paksa...

Ndezi një puro të madhe. Më dha dhe një mua. Janë kubane, prodhoheshin për Fidel Kastron, - po më tregonte, - por kur ai, diktatori, u sëmura a s'kishte nevojë të tymoste më, ja, i nxorën për të tjerë... kontrabandë? Përfitojnë dhe poetët? Fola apo desha të flisja? Janë shumë të shtrenjta, 60 \$ njëra a 80 \$, më kishte thënë Sebastiano, s'kishte rëndësi për mua dhe s'doja t'ja merrja puron. Adonis u prek, merre, më tha. E kuptova pse ma jepte.

"Atjoni, - po më thoshte Adonis, sikur vazhdonte një bisedë të dikurshme a që do të vazhdonte në të ardhmen, - e njoha në shtëpinë e Sebastianos... Atjoni shkëlqente prej poezisë. Dhe vetë është një poezi e magjishme."

Dhe atë që tha, e shkruajti arabisht mbi një copëz flete që e ruaj ende. Puron e Adonisit e mbarova në Tiranë. Tymi ribënte arabeska të kaltra.

Dhe do të kishim një telefonatë nga Adonis, na uronte nga Parisi një vit të ri. Dhe u përgjigjej mesazheve tona. Në njërin na shkruante: "Shpresoj të jeni shume mirë dhe vazhdoni të shkruani poezi për të dhënë një domethënie për botën tonë... Në një tjetër: Ju kam në mendje dhe në zemër. Me dashuri..."

Para ca ditësh i shkruaja dhe për paqe, liri dhe prosperitet të popullit sirian dhe më përgjigjej duke falenderuar, me shprese që gjithçka të jetë e mrekullueshme për ne, dhe përfundonte: Ju lutem pranoni urimet dhe ndjenjat e mia më të mira. Adonis.

FUNDI I PASTHËNIES

A ia tregoi Atjoni këtë: "Një herë, kur pashë që isha fare vetëm, unë dhe deti, nxora nga xhepi librin me poezi të Adonist... dhe vendosa t'u lexoj dallgëve me zë të lartë."

Shkonin mirë, u pranuan, ishin në harmoni. Teksa lexoja, stërkala të njelmëta hovnin brenda poezive dhe m'u bë sikur dallgë të tjera po dilnin nga poezitë, bashkoheshin me ato të detit për të kënduar së bashku përjetësinë e tyre, të detit dhe poezisë së jetës."

Adonis u gëzua dhe i pëlqeu shumë ky lloj leximi. 10 vjet më parë, kur im bir... kaq! Tani desha të thosha që na bëri të njohim një poet. Dhuratë e tij.

10 POEZI NGA ADONIS

SHKRUAJ

Shkruaj, jam i tmerruar e çmëndem e më trëmben dhe boja me fletët dhe pyes veten: po shkruaj vërtet a digjem?

UDHËTIMI

Njoh udhëtimin e hidhët, këtë velë të shqyer në humnerë, këtë palmë me degët e copërluara që vdesin të përungjuara mbi trungun e tyre. Njoh shtëpinë, zjarrin e ekstazës së saj dhe ngohtësinë e qosheve të saj. Por ç'kuptim ka një qëndrim i gjatë, një bujtje që shpërfill nisjen?

MEDINA-GRUA

Po si të të lexoj, qytet, si të dal nga pellgorja jote e blertë grafulluese murtajash me shijen e kundërhelmit dhe me pafajsinë e jaseminit? Është e vërtetë! Ti je kërthiza dhe mbyll amën e botës. Si të të lexoj, o Medinë-grua? Me hijeshi, ther trupin tim venë për venë aq sa s'më ngelet çfarë të jap veçse pak ngazëllim e trishtim shumë. Por dhuroji bijve të tu fuqinë time, tërbimin tim të gjithë ngaqë i mësoj jetës time një rrugë: trupin dhe i them gjuhës time të përmblihet në një fjalë: liri.

ZANAFILLA E FJALËS

Ai fëmija që isha mbërriti tek mua një ditë, fytyrë e huaj. Nuk thoshte asgjë. Ecnim dhe vëzhgoheshim në heshtje. Hapat tanë ishin një lumë që vraponte humbues. Rrënjët na ribashkuan si gjethnjatë lëvizëse në erë dhe, si një pyll i shkruar nga toka dhe i rrëfyer nga stinët, u ndamë. O fëmijë që isha, përpara! Ç'gjë na bashkon tani? Ç'do të themi?

PYET ORIENTIN

Gjërat flakin emrat e tyre. Prandaj nuk i emëroj. Pyetni Orientin: a nuk do të jetë lodhur së përzieri me hapat e tij aq gjak të fëmijëve të vet, nga të fjeturit mbi mbetjet e tyre dhe pothuaj pa u trallisur? Shtati i historisë është palosur mes duarve të mia: është njeriu i therur që dergjet mbi zemrën e një profeti. Lexoj rrëën, bëhem aleat i erës që ngrihet dhe largohet dhe them: ëndrra është dritë dhe farë, mbi ëndrrat kam ndërtuar ekzistencën time. O realitet, kush të ka emëruar? Nga vini? Për brezat e plagëve të pastajme që s'duan t'ja dinë nëse duhet të qajnë a të qeshin gjaku im është bir pyetjeje.

MES MEJE E SYVE TË TU

Kur në sytë e tu fundos të mitë, gjej agun e thellë shoh antiken e djeshme, shoh atë që nuk e njoh dhe mes meje e syve të tu ndjej të vrapojë kozmosi.

ANIJE PACIONESH

Ka ditur si t'i pllakosë ngushticat e plagëve tona, istmet e dëshirës së tij delirante. Ka ditur si të tiranizojë e të përgatisë pjesë tonat për t'na lënë në këmbë para derës për të hyrë në gjinencën e saj ku shpërthehet. Quaje, oh shtrat, anijen e pasioneve tona sovraane.

ZJARR I VETMUAR

Zjarr i vetmuar, ka filluar jeta e saj dhe hiret e saj nuk kanë të krahasuar. Dashuria është formë e së shkuarës që bisedon vetëm me të ardhmen. Drita është drithëruar mureve të shtëpisë së saj kur më ka përplasur: është e vërtetë, nuk është shpirti që kujton, por trupi.

ZINXHIRE

Jeta na ka gllabëruar, na ka hedhur në rrjetat e shqotave të veta dhe ka dhuruar gjoksin e vet dritareve të ditëve tona. Kur pyes se ç'gjë kemi patur shoh vetëm rrjetat në dritare. Kemi patur iluzione si të parët tanë se jemi jashtë rrjetave? Jemi dashuruar si të parët tanë me një jetë që i do zinxhirët e vet?

DARKA E FUNDIT

Pashë fytyrën tënde, ishte si një plak grabitur nga ditë dhe trishtime. Erdhi duke shtrënguar shishka të blerta duke nxituar darkën e tij të fundit. Çdo shishe ishte një gji dhe dasmë gjiri dhe një barkë ku mbyten ditë dhe brigje, ku pulëbardhat frushullojnë të kaluarën dhe ku barkëtari gjen me intuitë të nesërmen. Mbërrin i uritur, i shtroj dashurinë time, një bukë, një kanë dhe një shtrat. Hap dyert në erë dhe diell dhe ndaj me atë darkën e fundit.

Përkthyen nga italishtja Atjon & Visar Zhiti

1 vendi i grave në shtëpitë e vjetra, te grekërit antike, etj. (Shën. i përkthb.)



Karikaturë nga Arben Mexsi